



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 12 E 26 SHTATOR DHE 10 E 30 TETOR 2024**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 12. I 26. SEPTEMBRA I 10. I 30. OKTOBRA 2024. GODINE**

**SHTATOR/TETOR - SEPTEMBAR/OKTOBAR  
2024**

## **Rendi i ditës**

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit shqiptar,
5. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,
6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes të Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore,
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale,
9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,
10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,
14. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile,
15. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore,
18. Shqyrtimi i Projekt-kodit të sjelljes për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës,
19. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028,
20. Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH,
21. Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
22. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës,

23. Shqyrtimi Projekt-rezolutës për tërheqjen e tri (3) projektligjeve nga shqyrtimi në Kuvend,
24. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për arratisjen e personave të dënuar - degradimi i institucioneve të sigurisë,
25. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116,
26. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022,
27. Shqyrtimi i Raportit të Performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022,
28. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare,
29. Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb.

## Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Poslanička pitanja,
4. Izbor jednog (1) člana Odbora Radio-televizije Kosova, iz redova albanske zajednice,
5. Imenovanje sedam (7) članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe,
6. Glasanje o Nacrtu Zakona br. 08/L-309 za ratifikaciju Sporazuma o finansiranju, za prvi program za “Finansiranje razvojnih politika za fiskalnu efikasnost, konkurentnost i zeleni rast”, u sredini Republike Kosovo, predstavljeno je od strane Ministarstva finansija, rada i transfera i Međunarodnog udruženja za razvoj,
7. Razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-313 za ratifikaciju izmena i dopuna Sporazuma o članstvu Republike Kosova u Međunarodnom monetarnom fondu i organizacijama Svetske banke,
8. Razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-314 za ratifikaciju Sporazuma o zajmu između Republike Kosovo i Evropske investicione banke za projekat solarne foto naponske energije u KEK-u - Porta Globale,
9. Glasanje u drugom čitanju Predloga zakona br. 08/L-212 o reproduktivnom zdravlju i medicinski potpomognutoj oplodnji,
10. Glasanje u drugom čitanju Nacrta zakona br. 08/L-294 o izmenama i dopunama Zakona br. 08/L-197 za javne službenike,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-287 za Savet bezbednosti Republike Kosovo,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-275 o putevima,
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-290 o izmenama i dopunama Zakona br. 08/L-013 o imovinskim pravima stranih državljana u Republici Kosova,
14. Načelno glasanje o Nacrtu zakona br. 08/L-266 o civilnom statusu,
15. Načelno glasanje o Nacrtu Zakona br. 08/L-300 ispita za državnu maturu,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-306 o izmeni i dopuni Zakona nr. 05/L-132 o vozilima.
17. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-311 o upravljanju vodnim resursima,
18. Razmatranje Nacrta kodeksa ponašanja poslanika Skupštine Republike Kosovo,
19. Razmatranje Nacionalnog programa za evropske integracije 2024-2028,
20. Glasanje o nacrtu rezolucije koja se bavi nalazima Izveštaja američkog Stejt departmenta- ASD,
21. Razmatranje Nacrta Deklaracije o odnosima Republike Kosovo sa Sjedinjenim Američkim Državama,
22. Razmatranje Nacrta rezolucije koja se bavi pitanjem iseljavanja građana iz Republike Kosovo,
23. Razmatranje Nacrta rezolucije za povlačenje tri (3) nacrta zakona sa razmatranja u Skupštini,

24. Razmatranje Nacrta rezolucije o bekstvu osuđenih lica - degradacija institucija sigurnosti,
25. Razmatranje Izveštaja sa preporukama za nadzor nad sprovođenjem Zakona br. 05/L-090 o sponzorstvima u oblasti kulture, omladine i sporta, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 06/L-116,
26. Razmatranje Predloga rešenja za ocenu rada Agencije za informacije i privatnost za 2022. godinu,
27. Razmatranje Izveštaja o učinku rada javnih preduzeća za 2022. godinu,
28. Izveštavanje Vlade Republike Kosovo o napretku u implementaciji Ciljeva održivog razvoja i odrazu Transformativne agende Kosova u budžetu i vladinim politikama,
29. Osnivanje ad hoc komisije za izbor kandidata za dva (2) člana Odbora Radiotelevizije Kosova, jednog iz albanske i jednog iz srpske zajednice.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Mirë se erdhët në këtë seancë, e cila e shënon fillimin e sesionit të vjeshtës për Kuvendin e Republikës. Ju dëshiroj mirëseardhje dhe së bashku suksese në këtë sesion!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Sot në këtë seancë që po e fillojmë e kemi një mysafir special, e kemi të pranishëm ambasadorin e Luksemburgut, Ambasadorin Dits, së bashku me përfaqësueset e Agjencisë së Luksemburgut për Zhvillim që na e ka mundësuar këtë teknologji të shkëlqyeshme në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ashtu që ta kemi një Kuvend vërtet funksional. Në bashkëpunim me Kuvendin tonë, Ambasada e Luksemburgut e mundësoi këtë investim, i cili ka qenë shumë i rëndësishëm për Kuvendin tonë që ta kemi transparencën e nevojshme dhe demokracinë në Kuvend ashtu siç duhet. Faleminderit, ambasador, faleminderit edhe agjencisë tuaj që po bën një punë të shkëlqyeshme në Republikën e Kosovës.

Tash ju kisha lutur që ta bëjmë një votim elektronik për praninë tuaj, ta shohim nëse jemi 61 deputetë. Atëherë, regjia të përgatitemi për votim, votojmë tash!

I kemi mbi 70 deputetë të pranishëm, kështu që fillojmë seancën.

Ne të nderuar deputetë, në mbledhjen e fundit të Kryesisë kemi biseduar edhe për një çështje që në këtë pikën e Projekt-kodit të sjelljes të deputetit ta tërheqim nga rendi i ditës për sot që ajo t'i kthehet komisionit për punë të mëtutjeshme. Përfundimi i Kryesisë ishte që ka nevojë të punohet edhe më tutje në atë dokument, mirëpo nuk e kemi këtu të pranishëm, me sa po e shoh, kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri. Jemi marrë vesh ta bëjë këtë tërheqje, por ndoshta edhe ndonjëri prej kolegëve aty të komisionit.

Ia japim fjalën kryetarit të Grupit të LDK-së, Arben Gashi, që ta shtrojë këtë kërkesë.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Me propozim të kryetarit të grupit punues, deputetit Besnik Tahiri dhe në mungesë të tij, me autorizimin e tij verbal kërkoj që Projekt-Kodi i sjelljes së deputetëve të kthehet në komision dhe si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim të deputetit Besnik Tahiri. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo ishte edhe një lloj pajtueshmërie që e patëm aty në Kryesi, kështu që vazhdojmë, po e qes në votim. Votojmë për tërheqjen e kësaj pike, pra kërkesa është që t'i kthehet komisionit që kjo të vazhdojë komisioni të punojë, sepse ka edhe disa mospajtme sa u përket disa prej klauzolave aty, e qesim në votim.

Kush është për këtë propozim? Pra, që t'i kthehet komisionit edhe një herë ky dokument? Përgatituni për votim, votojmë tash!

Rezultati është ky: 73 vota për, kundër 2, abstenime 1, kështu që konstatoj që kjo kërkesë miratohet. Atëherë, Projekt Kodi i sjelljes së deputetit i kthehet edhe një herë komisionit përkatës, pastaj ata na lajmërojnë kurdo që ta përfundojnë punën e tyre në trajtimin e kësaj pike.

## **1. Deklarime jashtë rendit të ditës**

Tash, po ju lus që këtë aparaturën në aparaturë të lajmërohen vetëm ata që do të bëjnë fjalime në emër të grupeve parlamentare fillimisht, pastaj në ndërkohë paraqiten edhe të tjerët, por fillimisht kisha pasur qejf të kem pasqyrën e atyre që...

Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, Armend Muja.

**ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit!**

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Fjalimin e parë dëshiroj t'ua përkushtoj ca zhvillimeve të rëndësishme, të cilat për shkak të situatave politike jo rrallë edhe kanë qenë nën hije ose nuk janë diskutuar shumë, por një anë e fortë e kësaj qeverie është gjithsesi ka qenë performansa ekonomike.

Në tremujorin e parë..., a ka mundësi pak qetësi?

Në tremujorin e parë të vitit 2024, në bazë të ASK-së rritja e raportuar ishte 5.6% në terma realë dhe marrë në përgjegjësi që nga ardhja e kësaj qeverie, nëse bëhet analizimi i thjeshtë, rritja mesatare që nga viti 2021 vazhdon të jetë mbi 6%, lart përtej krahasimisht rritjeve që kanë ndodhur paraprakisht. E veçanta e kësaj rritjeje ekonomike në 2-3 vjetët e fundit është se është rritje ekonomike pa borxh, nuk është e bazuar në borxh. Po, Kosova është rritur ekonomikisht vazhdimisht në dekadën e kaluar, pro duhet ta keni parasysh që rritja ekonomike ka ndodhur për shkak të shpenzimeve qeveritare, të cilat kanë qenë të mbështetura në borxh publik ose nga financimet e jashtme.

Në rast se ekonomia e Kosovës ndërmjet vitit 2009 dhe 2012 është rritur 3, 4 ose 5%, kjo ka ardhur, duhet t'ju rikujtoj, për shkak të 500 milionë euro dividendë, të cilat i kanë marrë të PTK-së, të Telekomit, të cilat Qeveria i ka marrë për t'ju financuar shpenzimet e veta publike. Ka pasur rritje ekonomike, por duhet ta rikujtojmë, me shkatërrimin e Telekomit, po ashtu. Pas vitit 2014, ka pasur po ashtu rritje ekonomike, të mbështetur në borxh publik, derisa kemi ardhur ne, duhet t'ju rikujtoj, 1,6 miliard euro borxh publik janë huazuar për ta mbështetur këtë rritje ekonomike me strategjinë e financimeve publike, por edhe shterja e fondit të privatizimit.

500 milionë euro janë shterur nga Fondi i Privatizimit ndërmjet 2015 deri në vitin 2019. Po, shpenzimet qeveritare, po duke e shterur gjithë fondin e privatizimit, kjo është e vërtetë, dhe tani kjo rritje e tre vjetëve të fundit është e pastër dhe pa borxh, pa u mbështetur në financime të tjera dhe kjo duhet të jetë analizë.

Tjetra, është folur që pas liberalizimit të vizave mund të ndodhë ajo, mund të ndodhë kjo, mirëpo ajo çfarë unë e vërej, në bazë të statistikave, është që qarkullimi i bizneseve vazhdon të rritet, madje deri në fund të këtij viti do të jetë 22 miliardë, që është dyfishi i krahasuar me vitin 2019, po vazhdon të rritet. Numri i bizneseve që po hapen, për shembull, deri në korrik 7 100, është rekordi i numrit të bizneseve që po themelohen në Kosovë. Mbaj mend që gjatë 3-4 vjetëve të fundit kemi folur shumë për taksat dhe buxhetin shtetëror. Ka pasur diskutime, mohime, sidomos në krahun tim të majtë sa u përket të hyrave. Është e vërtetë që buxheti shtetëror i Kosovës vazhdimisht në 10 vjetët e fundit është rritur natyrshëm, diku rreth 22 deri 23% në raport me të hyrat tatimore, në raport me GDP nominale. Kështu ka qenë çdoherë, çdo vit, është rritur GDP-ja nominale, por ka qenë 22% buxheti, të hyrat tatimore kanë qenë 22-23%, derisa kemi ardhur ne, ka shkuar në 26% në raport me GDP-në nominale. Pra, kjo e faktorizon ose e inkorporon edhe efektin e rritjes së çmimeve dhe prapë me këtë logjikë ka shkuar në 26 dhe mbase këtë vit do të jetë 27%.

Me këtë dua të them që po të mos ishim ne, ju them me përgjegjësi të plotë, që 1 miliard euro në buxhetin e shtetit nuk do të ishin dhe rrjedhimisht, i gjithë financimi i shtesave për fëmijë, për ushtrinë do të mungonte. Pra, kjo është origjina e financimit të programeve qeveritare. Nuk kemi pasur ne mundësi ndryshe t'i financojmë përpos administrimit të mirë të politikës fiskale dhe formalizimit. Një indikator 250 milionë kuponë fiskalë janë lëshuar në vitin 2019, besoni këtë vit shkon në 500 milionë euro kuponë fiskalë, si indikatorë i formalizimit të ekonomisë. Dhe, në fund, rritja...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Urdhëro, një minutë zotit Muja!

**ARMEND MUJA:** Janë dy, shtesat për fëmijë se ka pas një pyetje se ku po i financoni dhe financimi i shtesave për fëmijë që realizohet 400 mijë përfitues për shkak të administrimit të mirë të politikës fiskale dhe tjetra që është e rëndësishme, paga minimale. Dhjetë vjet debat për pagën minimale, është dashur të vijmë ne për ta rritur pagën minimale. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash, në emër të Partisë Demokratike flet deputetja Eliza Hoxha.

**ELIZA HOXHA:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,



Të dashur ministra,

Media,

Qytetarë të dashur,

Fillimisht urime për pajisjet e reja, më në fund mund të adresohemi në mënyrë elektronike dhe të kuptohet se kush për çka qëndron dhe çfarë voton.

Po e nis këtë fjalim timin dhe këtë adresim timin, meqë jemi në fillim shtatori, viti i ri shkollor sapo ka filluar dhe është interesant të theksojmë apo të ritheksojmë që në katër vjet mandat të Lëvizjes Vendvendosje viti i ri shkollor asnjëherë nuk ka nisur me normalitet. Edhe këtë vit, sikurse vitin që shkoi, dështimi për të siguruar mjetet apo tekstet shkollore përmbi 250 mijë nxënës u përsërit për këtë vit, me dashje dhe me plot vetëdije. Sot kur po flasim një pjesë e madhe e nxënësve nga klasa e parë deri në klasën e nëntë ende nuk i ka tekstet shkollore në banka dhe në shtëpitë e tyre. Hiç më pak se 20 milionë euro është kostoja e planifikuar për blerjen e teksteve shkollore nga rreth 5 milionë sa ka qenë oferta zyrtare e ofruar fillimisht nga shtëpitë botuese. Pra, të blihen sipas procedurës ligjore dhe standardit mbi disavjeçar për ofrimin e teksteve shkollore falas për të gjithë nxënësit pa dallim.

Por sot qytetarët duhet ta dinë se kjo mënyrë e pabazë dhe e paligjshme subvencionimit të teksteve shkollore vetëm se ka shumëfishuar fitimet e shtëpive botuese dhe, në këtë mënyrë, edhe të librarive, sepse të njëjtat tekste shkollore në procedurë ligjore do të bliheshin shumë më lirë nga ministria, ndërsa sot qytetarëve u shiten shumë më shtrenjtë, sepse kështu ka vendosur qeveria. Pra, në këtë mënyrë ka vendosur t'u ofroj, ju rikujtoj, oligarkëve që i quanit ju dikur, duke u mundësuar në mënyrë indirekte fitime milionëshe, sepse tekstet shkollore shiten nga të njëjtat shtëpi botuese, si ato që kanë ofruar dikur në procedura të rregullta ligjore të prokurimit, sikur këto sot që janë bërë përmes blerjes nga vetë prindërit, të njëjtat shtëpi botuese i prodhojnë këto libra.

Por, sot kjo bëhet me 15 milionë euro më shumë përmes këtij eksperimenti të paligjshëm. Ndërkaq, prindërit dhe mësimitdhënësit janë dëshmitarët më të besueshëm të pasojave të këtij eksperimenti.

Nga njëra anë, mjetet financiare të subvencionimit janë të pamjaftueshme për të blerë të gjitha tekstet shkollore, sepse tekstet janë shumë më të shtrenjta në treg se sa ato që do të bliheshin me tender nga ministria, si dhe mësimitdhënësit ende nuk janë duke e zhvilluar plan programin e tyre, sepse një pjesë e madhe e nxënësve nuk i ka siguruar tekstet e nevojshme dhe këto janë fakte. Nga ana tjetër, ky Kuvend me kërkesën tonë ka themeluar Komisionin Hetimor Parlamentar mbi hetimin e procesit të subvencionimit të teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për nxënësit e nivelit të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm e të ulët për vitin shkollor 2023-2024. Dhe ky komision ende nuk ka përfunduar punën.

Pra, edhe ne si Kuvend jemi në pritje të rezultateve të punës dhe raportimit të këtij komisioni, në mënyrë që të zbardhen të gjitha çështjet që janë shtruar për hetim.

Ministrja Nagavci, sikur vitin e kaluar, edhe këtë vit do të duhej të ishte e vetëdijshme se ligji në fuqi për arsimin parauniversitar ka përcaktuar se shkollimi fillor është i detyrueshëm dhe i njëjti ofrohet falas dhe ky përcaktim në bazë të neneve 26 dhe 27 shprehimisht parasheh detyrimin që MASHT përmes procedurave të prokurimit, po ritheksoj, neni thotë “përmes procedurave të prokurimit të ofrojë tekstet shkollore falas”, kështu thotë ligji. Një obligim të tillë ligjor MASHT dhe ministrja me dashje dhe me vetëdije nuk e ka përmbushur. Në fund të fundit, është buxheti i shpenzuar treguesi kryesor i menaxhimit të procesit të teksteve shkollore. Në vend se t’i blejnë tekstet shkollore me 5 milionë euro, sot janë shpenzuar 20 milionë euro për të njëjtat tekste shkollore dhe kanë shkuar tek të njëjtat shtëpi botuese.

Po jap vetëm një ilustrim, nëse një libër i cili në fund e ka të shkruar çmimin 7 euro, qytetari e blen të njëjtin libër në librari me 12 euro. Nëse shumën e shtuar prej 5 eurove më tepër që blihet libri në librari e shumëzoni me numrin e nxënësve, mbi 200 mijë, i bie që vetëm për një libër të shpenzohen 1 milion euro më shumë, vetëm për një libër ka shpenzuar Ministria e Arsimit.

Prandaj, kjo duhet të hetohet sa më parë edhe nga prokuroria kompetente, sepse konsiderojmë se është në interes të publikut dhe të zbatimit të ligjit që të hetohen të gjitha rrethanat në radhë të parë që kanë çuar në zgjedhjen e kësaj alternative për subvencionimin e teksteve dhe e dyta të hetohen të gjitha pasojat financiare administrative dhe ligjore që kanë rezultuar si pasojë e një vendimmarrje të tillë, sepse çështja është fare e thjeshtë. Tekstet e ofruara falas nga shteti nxënësit do të duhej t’i kishin tashmë në bankat e tyre, më 1 shtator, paaftësinë e menaxhimit dhe të udhëheqjes së arsimit nuk mund ta shitni për risi, sepse keni shkelur ligjin.

Prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit nuk ia kanë borxh...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Po, ia shtojmë një minutë!

**ELIZA HOXHA:** Faleminderit, kryetar!

Prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit nuk ia kanë borxh një maltretim të tillë, i cili krijon kosto të shumëfishta për ta, mundëson fitime të shumëfishta për shtëpitë botuese dhe mundëson humbje milionëshe të buxhetit të shtetit. Prandaj, hetimi penal është më i nevojshëm se kurrë dhe ky hetim herët a vonë do të ndodhë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash, për Lidhjen Demokratike flet kryetari Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Zonja e zotërinj,

Po e nisim seancën e parë të sesionit vjeshtor fatmirësisht dhe të fundit të kësaj legjislature, fatkeqësisht në gjendje të pandryshueshme si katër vjet më parë, për më tepër në gjendje të sfidave të paprecedent për vendin tonë dhe të ardhmen që e kemi ëndërruar gjithmonë.

Po e nisim këtë seancë në ndjenjën e vazhdueshme të ndasive të mëdha shoqërore brenda nesh, ku akuzat e tradhtisë e Serbisë janë veçse gjuhë e rëndomtë, sikurse edhe në ndjenjën e thellë të izolimit tonë ndërkombëtar, ku ne, ndonëse të vetëm, mbesim megjithatë krenarë. Në pabesinë më të madhe historike kemi zënë vendin e ankuesve ndaj aleatëve tanë, i sulmojmë ata, i godasim ata për të marrë në fund asnjë rezultat veçse vulën e fajtorit dhe njollën e një shteti të vetmuar, me të cilin nuk do të merret asnjë vend evropian. Prandaj, për katër vjet nuk kemi as edhe një njohje, nuk kemi asnjë anëtarësim. Prandaj, ne Republika e Kosovës jemi nën masa e nën sanksione.

Një politikë të tillë disfatiste e njohim shumë qartë, e kemi mundur 25 vjet më parë, ne njerëzit e lirë të Republikës së Kosovës. Veçse ne ishim vetë dhe u bëmë me aleatë, ne ishim në të drejtën tonë edhe në sytë e të tjerëve, ne ishim të suksesshëm në rrugën e vështirë të njohjeve e anëtarësimeve e kundërshtarët tanë i lamë në sanksione, të mbyllur e pa mbështetje euroatlantike. Duket se koha ka rrotulluar tavolinat, kështu ndodh kur në momente të rëndësishme historike udhëhiqesh nga politika të papërgjegjshme, populliste e në kriza, përplot mllef e urrejtje ndaj gjithsecilit. Katër vjet janë të mëdha për të bërë ndryshim të madh mbrapsht, ne veçse kemi kaluar përtej pikës së kthimit e rikuperimit të shpejtë. Prandaj, në këtë rrotullim tavolinash shtetësia jonë u godit gjatë kësaj vere nga vendimi i Bashkimit Evropian i njohjes së pasaportave serbe të lëshuara për territorin e Kosovës.

Ta kuptojmë për pak këtë gjendje fatale për Republikën. BE njeh autoritetin shtetar serb mbi shtetin e pavarur të Kosovës 17 vjet pas pavarësisë, 25 vjet pas lirisë. Si mund të mburremi ne me një përfundim të tillë? Ku qenka sukcesi i sjelljes sonë diplomatike e sovrane? Dhe, në këtë rrotullim tavolinash jemi në prag të përjashtimit edhe nga Procesi i Berlinit, për të humbur kështu përfundimisht barabarësinë e trajtimit mes gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor. Ta kuptoni mirë, qytetarë të Republikës, këto janë pasoja serioze të kësaj politike populliste. Kjo politikë nuk shpie askund, përveç në favorizimin e kundërshtarëve tanë historikë e rrezikimin e shtetësisë sonë ende të pakonsoliduar mirë. Ta kuptoni mirë se përtej fitoreve të vogla momentale për pak vota, qëndrojnë humbjet e mëdha të vetë shtetit e të vetë republikës.

Natyrisht se popullizmi nuk e kupton këtë brengë, përkundrazi popullizmi e popullistët kanë nevojë për polarizim të mëtutjeshëm, për ndarje sa më të thellë ne dhe ju sa më larg, sa më të ndarë, siç ishte rasti me urën. Askush nuk ishte kundër, të gjithë ishin për, në fund disi ngrihet pyetja a je për apo kundër, këndeje apo andej urës. Jam dhe jemi kundër përplasjes me NATO-n,

për ta thënë shkurt, shqip, qartë, sepse ka një vijë që s'e kalojmë dot, NATO dhe Kosova janë bashkë, asnjëherë përballë. Ky është orientimi popullor i Kosovës dhe qytetarëve tanë dhe ju garantoj se në asnjë dëshirë, sado e errët e ekstremiste që është, nuk mund e as s'do ta testojë e më pak ta ndryshojë këtë orientim properëndimor të Kosovës. Por, ja që, përveç Urës së Ibrit, ka edhe një urë tjetër këtu në Badovc. Aty nuk ka NATO, nuk ka media, e aty nuk ka asnjë pengesë të vetme që kjo urë të përfundojë. Tash e sa vjet mijëra vetura në ditë kapërcejnë nëpër rrugën që s'ka urë, por qeverinë nuk e ke aty, as duke lyer, as testuar, e aq më pak duke e ndërtuar atë. Dhe, kjo është zgjedhja jonë sot, qytetarë të nderuar, zgjedhja mes një politike që krijon temë të brendshme elektorale pa asnjë rezultat, përkundrazi, me ngufatje të subjektivitetit tonë ndërkombëtar, apo një politike që ndërton, krijon që pas katër vjetëve me 51% e 12 miliardë euro buxhet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia shtoni një pjesë të kohës zotit Abdixhiku.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit!

Së paku tri projekte kapitale në vend që mbahen mend, një politikë që nuk ngrihet në mëngjes për t'i hartuar plot 10 ligje kundërkushtetuese, për ta atakuar më pas secilin mendimtar më ndryshe, për t'i sulmuar gjyqtarët që kundërshtojnë tendencat autokratike e për t'i mbrojtur të korruptuarit e një mafie të paprecedent energjetike.

Nuk kemi nevojë për një politikë që jeton për të sulmuar mediat, bizneset e gjithë korpusin jopartiak të tyre, por njerëz që donë një spital të ri, u jep ushqim fëmijëve në shkolla, përfundon rruga autostrada disakilometërshe, ndërton centrale me gaz, siguron energji, zbut deficitin e lartë tregtar prej 5 miliardësh e krijon paga të larta, punë të denja, jetë të mirë për secilin qytetar. Lajmi i mirë është që ky legjislacion po përfundon, me të dhe një politikë e zymtë, përplasëse e ndarëse brendashqiptare. Një që na ka mbytur e na ka mbyllur në mes vete. Jemi vetëm pesë muaj larg nga qëllimi ynë i mbarë me zgjedhje të reja, me qeveri të re, me ide të reja, e ardhmja që kemi kërkuar gjithherë është thjesht e ndritshme dhe e mundshme. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash është radha e AAK-së, deputetja Albana Bytyqi flet në emër të grupit.

**ALBANA BYTYQI:** I nderuar kryetar,

Të nderur kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës.

Sot është një seancë e re në Kuvendin tonë, megjithatë adresimet tuaja mbeten ende të njëjta. Shqetësimet, të cilat i keni bartur që nga fillimi i kësaj qeverie janë valide akoma edhe sot, sepse gjendja juaj ekonomike e sociale po vazhdon të vështirësohet. E kjo është një periudhë sfiduese

jo vetëm për ju, por edhe për të rinjtë tanë, sepse premtimet e bëra nga qeveria aktuale kanë mbetur vetëm fjalë, pra pa veprime konkrete.

Prandaj të mos çuditemi që çdo shtëpi nga fshatrat e thella të Kosovës e deri këtu në zemër të Prishtinës po zbrazet nga rinia jonë. Të dhënat tregojnë se papunësia mes tyre vazhdon të jetë në nivele alarmante. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës shkalla e papunësisë është mbi 25% dhe kjo është një krizë që kërkon veprime urgjente. Nga ana tjetër, inflacioni po godet fuqishëm xhepat e qytetarëve tanë, e si të mos kërkojmë zgjidhje tjetër larg atdheut, teksa çmimet e produkteve bazike janë rritur ndjeshëm, duke vështirësuar sigurimin e ushqimit dhe shërbimeve thelbësore. Kjo situatë pa dyshim është rezultat i menaxhimit të dobët ekonomik dhe mungesës së strategjive afatgjata nga ana e qeverisë. Asnjë politikë sociale të miratuar nga kjo qeveri nuk arriti të japë zgjidhje problemit të varfërisë, sepse shumica e programeve janë më shumë simbolike se sa efektive, duke mos ofruar mbështetje reale pikërisht për ata që më së shumti kanë nevojë.

Dështimi i Qeverisë Kurti në këtë drejtim është evident, pavarësisht premtimeve për reforma dhe zhvillim ekonomik, ne kemi parë një stagnim në sektorët kyçë, siç janë arsimi, shëndetësia dhe infrastruktura. Andaj, qytetarët meritojnë një qeveri që punon për ta, jo të tillë sa për t'u paraqitur me slogane boshe. Kjo krizë ekonomike sociale duhet të marrë fund, investimi në infrastrukturën dhe zhvillimi i sistemit shëndetësor duhet të shihet dita-ditës.

Por, gjithsesi se në fund qytetari do të ndëshkojë për këtë ritëm dështimesh dhe mungesash veprimi. Politikat populiste të Lëvizjes në pushtet, shpeshherë të papërgjegjshme, nuk do të pinë ujë më. Andaj, po vjen koha që do të refuzohet kjo qasje e do t'u jepet fund politikave që minojnë stabilitetin dhe zhvillimin e Kosovës dhe ne padrejtësisht dhe gjithashtu do të ngremë zërin lart për të kërkuar përgjegjësi, e pa dyshim se qytetari do të japë verdiktin final në zgjedhjet që po vijnë, jo me pretime boshe, jo politikë populiste.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)*

**KRYESUESJA:** Tani në radhë është deputeti Enis Kervan nga Grupi Multietnik.

**ENIS KERVNA:** Faleminderit, nënkryetare!

Saygıdeğer vatandaşlarım, çok değerli öğrenciler, öğretmenlerimiz, saygıdeğer velilerimiz Bugün sizin için konuşmayı uygun gördüm. Yeni başlayan bir eğitim yılımız var ve maalesef okulda, okul sıralarımızda siz değerli çocuklarımızın hala bazılarının kitapları eksik. Ders kitaplarının eksik olmasının sebebi de fiyatların aşırı yüksek olmasıdır. Biz de bugün hakkımızı aramak için bu kürsüden düşüncelerimizi ve yapılması gerekenleri dile getireceğiz.

Përshëndetje të gjithëve,

Unë sot dëshiroj të flas për vitin e ri shkollor, uroj vitin e ri shkollor dhe u dëshiroj sukses të gjithë nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve. Dëshiroj që të jetë një vit pa probleme, por kur flasim për problemet, komuniteti turk e ka filluar vitin shkollor me probleme. Unë sot nuk do të ndalem të flas për problemet e tjera që kemi mungesë të teksteve shkollore, e tjera, ani që në bashkëpunim me ministren kemi arritur shumë gjëra të rregullojmë, kemi edhe do mangësi të tjera. Por, do të flasim për tekstet shkollore, të cilat ende nuk janë në shumicën e nxënësve para bankave të tyre dhe shpresoj që ky problem do të zgjidhet.

Problemi është që çmimet e teksteve shkollore në gjuhën turke janë tepër të shtrenjta. Ligji është i qartë, prindërit nuk duhet t'i blejnë tekstet shkollore, po me këto çmime shumicën e rasteve nxënësit ende nuk kanë mundur të sigurojnë tekstet shkollore për shkak që çmimet kur krahasojmë me gjuhën shqipe janë trefish, katërfish dhe pesëfish më të shtrenjta. Si shembull e kam marrë, matematikën, fletore punë në gjuhën shqipe për klasën 1B, çmimi është 3 euro e 45 centë. I njëjti libër teksti shkollor matematikë 1 në gjuhën turke, edhe në gjuhën boshnjake, në fakt, 8 euro e 25 centë, 8 euro e 25 centë dhe 4 euro. Tri tekste shkollore të cilat nevojiten të blihen komplet kushtojnë 20 euro e 50 centë, por në gjuhën shqipe janë diku 8-9 euro. Njëjtë vlen edhe për gjuhën boshnjake.

Ke edhe raste të tjera, Shoqëria dhe Mjedisi 4 në gjuhën shqipe, çmimi është 4 euro e 50 centë. Shoqëria dhe Mjedisi në gjuhën turke, 16 euro. Shoqëria dhe Mjedisi, Fletore pune në gjuhën shqipe 2 euro e 70 centë. Shoqëria dhe Mjedisi në gjuhën turke, 10 euro. Këto janë çmimet më të lira, kemi tekstet shkollore: Kimia në gjuhën turke 25 euro, 20 euro, 18 euro, 17 euro e 50 centë e kështu me radhë. Këtu e dimë që problemi është te tirazhi, te sasia e vogël. Ne nuk mund të fajësojmë shtëpitë botuese, sepse ata e kryejnë punën e vet në mënyrë profesionale, teknike dhe kur është sasia e vogël, edhe një fotokopje kur e bëjmë 1 edhe 10 mijë, ndryshon çmimi. Bilebile ata na kanë ndihmuar vjet e kemi shpërndarë tekstet shkollore pa pagesë edhe një herë shfrytëzoi rastin t'i falënderoj ata.

Por, mendoj që ligji është i qartë, Kushtetuta është e qartë, krejt jemi të barabartë para ligjit. Nuk është në rregull komuniteti turk t'i ketë pesëfish më shtrenjtë tekstet shkollore prej komuniteteve të tjera. Prandaj, shpresoj që sikur gjithmonë që na kanë dhënë mbështetje Qeveria dhe ministria e Arsimit, kisha pasur dëshirë ajo të ishte sot këtu, edhe në këtë aspekt bashkëpunojmë dhe na ndihmojnë. Mendoj që mënyra më e mirë është, kjo është kërkesa e prindërve, nxënësve dhe mësimitdhënësve, por edhe yni që subvencionimi të bëhet shtesë për komunitetet turk dhe boshnjak, pasi që çmimet janë tepër të larta. Ne i kuptojmë teknikalitetet, por taksapaguesit, qytetarët tanë nuk i kuptojnë teknikalitetet. Ne kërkojmë të drejta të barabarta. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Jahja Kokaj.

JAHJA KOKAJ: Faleminderit, zonja kryesuese!

Ministra të nderuar,

Kolegë të nderuar,

Qytetarë të dashur.

Dola sot për të përshëndetur fëmijët, pra ardhmërinë tonë fatlume, për të përshëndetur prindërit dhe të gjithë ata, të cilët janë arsimdashës, për të përshëndetur për fillimin e vitit të ri shkollor, fillim i cili ka ndodhur edhe në Kosovën e lirë, por edhe shumë më herët dhe me siguri asocion me fillimin shumë të hershëm kur Pandeli Sotiri në Korçë në vitin 1887 formoi shkollën e parë në gjuhën shqipe.

Pastaj, duhet të përmend faktin që rilindësit tonë, iluministët tonë, ata që bartën në supet e tyre, kush me pendë e kush me pushkë, ardhmërinë tonë fatlume, pra rilindësit tonë kokë më kokë në nëntor të vitit 1905 shkruan Alfabetin e gjuhës shqipe. Që atëherë kultura jonë është e shkruar dhe identiteti, komuniteti, kohezioni kombëtar u rrit në mënyrë të hatashme, përkundër faktit që kombi ynë i ndarë në 5 pjesë, sidomos Kosova martire, vendi amë u përkujdes për mirëqenien, pra mbreti i parë i shqiptarëve para Luftës së Dytë Botërore, pastaj kryetari pas Luftës së Dytë Botërore, qindra mësues dërguan në Kosovë dhe pastaj edhe shtypshkronjën e parë dhe filloi me të mbarë aktiviteti i arsimit të shqiptarëve këtë Shqipërisë.

Por, e dhimbshme është fakti se jo vetëm Milosheviqi, por edhe paraprijësit e tij edhe më famëkeq shkaktuan lumenj gjaku në Kosovën martire, por mbi të gjitha ndrydhën mendjen, kulturën, identitetin tonë arsimor. Duhet të përmend faktin që në vitin 1969, pra pikërisht në këtë ndërtesë ku momentalisht gjendemi u shpall universiteti i parë i Kosovës dhe pastaj pason në fror të vitit 1970 në mënyrë solemne ky universitet u formalizua, ku isha prezent edhe unë dhe, si duket, për këtë arsye jam sot para jush për të përshëndetur fëmijët, prindërit dhe të gjithë arsimdashësit për fillimin e mbarë të vitit shkollor.

Natyrisht të dy probleme janë kyçe për të cilat duhet t'i përmendi: e para...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni edhe një minutë!

JAHJA KOKAJ: I pari është shkollat, domethënë veprimi nënshtrues i Milosheviqit, të cilit ne akoma e bartim. Dhe, e dyta është tranzicioni, këto të dyja kanë shkaktuar që PISA të na tregojë jo vetëm këtë kufirit, por edhe andej kufirit që jemi në fund të pusit.

Fatkeqësisht, ne po mundohemi, po përpëlitemi, po mos mendoni që për tre vjet kjo punë mund të rregullohet. Kjo ministri ka kontribuar në mënyrë shumë efikase dhe ka rezultate të prekshme, duke përmend këtu mësimin dual dhe në fund përmend dhe përshëndes edhe mësimin tërëditor,

ndonëse ka filluar edhe më herët, por tash është tendenca e dytë dhe kam rezerva, meqenëse ka edhe pengesa të fillimit logjistik, pedagogjik-ditaktik, por që duhet të përshëndesim dhe, në fund, edhe një herë nga zemra u uroj të gjithë fëmijëve tonë, ardhmërisë tonë fatlume, prindërve dhe mësimdhënësve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Tani në radhë është Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Deri më 1 qershor 2024, për tre vjet e gjysmë, mbi 3 860 profesionistë shëndetësorë, mjekë, stomatologë, infermierë, fizioterapeutë dhe teknikë të tjerë mjekësorë kanë ikur nga Kosova dhe shumë të tjerë nga sektori publik në atë privat dhe kjo është shumë alarmante.

Ikja e profesionistëve shëndetësorë nga Kosova është shndërruar në dukuri shqetësuese për sistemin tonë shëndetësor, sepse ne nuk mund të prodhojmë profesionistë shëndetësorë aq sa po na ikin nga Kosova dhe kjo shumë shpejt do ta dërgojë në kolaps sistemin tonë shëndetësor. Kjo është pasojë e keqeverisjes, ku edhe me statutin e SHSKUK-së parashihet mbyllja e disa prej shërbimeve në spitalet regjionale.

Paaftësia e Qeverisë, keqeverisja në shëndetësi, korrupsioni në këtë sektor kanë rënduar edhe më shumë gjendjen në shëndetësinë tonë dhe ka dekurajuar profesionistët shëndetësorë. Listat e gjata të pritjes për operacione dhe procedura diagnostikuese, buxheti për trajtim jashtë vendit i pamjaftueshëm për kërkesat të cilat janë, mungesa e barnave dhe materialit mjekësor më nuk përbën lajm për këtë Qeveri dhe për këtë menaxhim të shëndetësisë.

Çfarë kemi parë deri më tani, në këtë Qeveri është që rritja e buxhetit të barnave është në sinkron me rritjen e hajnisë dhe korrupsionit në shëndetësi. Ndryshe, nuk ka sesi të justifikohet, edhe të rritet buxheti për shëndetësi dhe për barna dhe të vazhdojë të ketë mungesa të njëjta, përveçse këto përfundojnë në xhepat e hajnave e të korruptuarve në sistemin e shëndetësisë.

Duke dështuar kështu në të gjitha sferat në shëndetësi, Qeveria ka bërë përpjekje që në muajt e fundit të promovojë disa renovime dhe fasadime në shëndetësi, e të cilat buxhetit të shtetit i kushtuan shumë shtrenjtë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Renovimi në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Urologjisë, metri katror i një renovimi kushton prej 1900 euro deri 2 300 euro. Me këto para mund ta blesh ku të duash metrin katror në mes të



Prishtinës, objekt të gatshëm. Po kështu e paguan Qeveria metrin katror të renovimeve në shëndetësi.

Për më keq, për të bërë disa promovime të tilla, kur inaugurohet Klinika e Emergjencës, shtretërit merren nga Spitali pediatrik për një promovim të Kryeministrit Kurti. Nga traumatologjia e fëmijëve merren...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Regjia, ia mundësoni edhe një minutë!

**BEKIM HAXHIU:** Pra, kjo është edhe fatkeqësi, edhe tragjedi, edhe paaftësi që në momentin e inaugurimit të emergjencës të merren shtretërit nga Spitali pediatrik, nga traumatologjia e fëmijëve për një promovim, për një inaugurim. Pse, a nuk kishte buxhet mjaftueshëm që të blihen shtretërit e rinj në emergjencë? A duhet të bëhen vetëm fasada lysterje? A mendon dikush që duhet rritur kapacitetin e emergjencës? Ku është rritja e kapacitetit të emergjencës?

Tenderi për emergjencën, për Spitalin e madh të Emergjencës, për Klinikën Emergjente, tash e një vit është në OSHP, për shkak të dallaveve e hajnive brenda Ministrisë së Shëndetësisë.

**KRYESUESJA:** Tani në radhë është deputetja Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit,

Nuk e pata në plan të flas, por më nxitën shifrat dhe manipulimi me shifra i deputetit Armend Muja. Tre vjet e gjysmë, gati katër mandat u kanë shkuar duke manipuluar me shifra. Thua se, qytetarët e vendit nuk e dinë se çfarë ka ndodhur me ekonominë e këtij vendi.

Të nderuar qytetarë të këtij vendi, të gjithë ju e dini që në vitin 2021 inflacioni në Kosovë ka qenë 3.4 për qind dhe 230 milionë euro, meqenëse po flasim në terma nominalë, z. Muja, më 2021 kanë ardhur pikërisht nga rritja e çmimeve.

Nëse doni të flisni me terma nominalë dhe na thoni se rritja ekonomike në vitin 2022 është 1 miliard e 186 milionë, për shkak se kjo është diferenca mes GDP të vitit 2021 dhe 2022, unë të tregoj se e ka pasur inflacionin 11,6 për qind dhe 923 milionë prej atyre 1,1 miliardëve vijnë prej inflacionit. 923 milionë vijnë prej inflacionit. A e dini çfarë do të thotë kjo? Në vitin 2023 i ke rrafsh 430 milionë rritje prej inflacionit. Inflacioni gjatë qeverisjes suaj i ka kushtuar ekonomisë së këtij vendi 1,6 miliardë euro. Sot, ju thoni që ju i keni sjellë miliarda buxhetit të Republikës së Kosovës. Po, zotëri, po qysh i ke marrë këto miliarda? I ke marrë prej xhepave të qytetarëve. Prej

xhepave të prindërve, fëmijët e të cilëve deri sot u ke dhënë nga dhjetë euro, e tash në kohë fushate po ju jep nga njëzet, respektivisht tridhjetë euro. Po, dhjetë euro, njëzet euro dhe tridhjetë euro assesi nuk e mbulojnë normën e inflacionit që ka ndodhur gjatë këtyre viteve. Çka me premtimin tuaj për qumësht më të lirë, për bukë më të lirë, për vaj më të lirë, për sheqer më të lirë? Çka ka ndodhur me çmimet e këtyre produkteve? Këtyre produkteve u është dyfishuar çmimi, e juve ju është dyfishuar tatimi, duke mundësuar rritjen e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Të lutem shumë, mos fol për politikën fiskale! Për cilat politika fiskale po flet? Cilën politikë fiskale? Cilën reformë fiskale? A e dini që ministri i Financave që është këtu, ende e ka drejtor të Administratës Tatimore drejtorin që ia ka caktuar Bedri Hamza në qeverisjen PAN, jashtë kritereve ligjore, jashtë rregullave, përmes një konkursi komplet të manipuluar. Ende, katër vjet.

**KRYESUESJA:** Edhe një minutë!

**HYKMETE BAJRAMI:** Të nderuar votues të Lëvizjes Vetëvendosje, Administrata Tatimore e Kosovës udhëhiqet edhe sot prej njeriut të Bedri Hamzës, për shkak të paaftësisë së Qeverisë së Lëvizjes Vetëvendosje.

A e di çka ka ndodhur me deficitin tregtar? Pesë miliardë. Kur e ke marrë qeverisjen, 2,8 miliardë ka qenë deficitin tregtar. Ti sot më flet se sa biznese qenkan hapur. A e di cila është pengesa kryesore sot e bizneseve? Pengesa kryesore është mungesa e fuqisë punëtore, sepse ata kanë ikur në Perëndim, sepse ua ke humbur shpresën. Sot më flet që e ke rritur pagën minimale. Cilën pagë e ke rritur? Askush në institucione publike nuk e ka pasur pagën më të ulët se 350 euro. Në institucione private u kanë ikur njerëzve punëtorët, kanë shkuar jashtë shtetit për shkak të qeverisjes suaj. A e dini çka keni rritur ju? Tenderët njëburimorë, 273 milionë euro në qeverisjen tuaj janë tenderë për dosta.

**KRYETARI:** Replikë, Armend Muja!

**ARMEND MUJA:** Qytetarë të nderuar, Në rast se thua GDP-ja nominale, ajo e inkorporon efektin e rritjes së çmimeve. Ndërmjet vitit 2008 dhe vitit 2020, po ashtu ka pasur rritje të çmimeve. Unë po them që shteti i Kosovës nga të hyrat tatimore i ka mbledhur 22 për qind në raport me GDP-në nominale.

Kur ne kemi ardhur, ka shkuar në 26 për qind të hyrat tatimore në raport me GDP-në nominale. Kjo është. Nga 1.7 miliardë të hyrat tatimore, sivjet shkoi në 3 miliardë, vitin e ardhshëm 3.2 miliardë. Dyfish kemi të hyra tatimore. Kjo nuk bëhet assesi ndryshe, përpos me ndershmëri e profesionalizëm.

Në lidhje me importet. Ju shpeshherë po u referoheni importeve, jo eksporteve. E vërtetë është. Në rast se importet e Kosovës më 2008 mund të kenë qenë 1,3 miliardë, deri në vitin 2019 kanë shkuar 3.2 miliardë. Është dyfishuar për dhjetë vjet. Kur ju thoni që janë dyfishuar importet, ju nënkuptoni që kanë pasur njerëzit më shumë para të blejnë.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputetja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Deputet,

Nuk ka pasur rritje të çmimeve, sepse më 2015 ka pasur deflacion, minus 0,5 për qind. Në vitin 2016, 2,3 për qind inflacioni, në 2017: 1,5 për qind, në 2019: 2,7 për qind edhe në 2020: 0,2 për qind. S'ka pasur rritje të çmimeve. Kështu që kur flasim për rritje të çmimeve, referoju të dhënave zyrtare të Agjencisë që punon në Zyrën e Kryeministrit.

Kur po i referohemi deficitit tregtar, deficitit tregtar është deficit tregtar. 815 milionë e ke pasur vitin e kaluar eksportin, 5,7 miliardë e ke pasur importin. Ti u lavdërove për ekonomi. Po të kishim prodhim, i kishim zëvendësuar ato. Nuk e kishe rritur ti për dy miliardë importin e mallrave. Janë rritur çmimet, nuk është rritur fuqia blerëse e qytetarëve. Dil pyeti qytetarët, atë që dikur...

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: Faleminderit, kryesuese!

Ju përhëndes të gjithëve, shpresoj që keni pasur pushime të mira. Po më gëzon një fakt që Kuvendi i Kosovës i paska ndrequr mikrofonët. Pas urës së Saradranit kanë arritur pas katër vjetësh, mikrofonët e teknikën këtu ta ndreqin. Tash do të kemi mundësi të flasim edhe për arritjet e tjera që i keni bërë ju. Unë veç ju përgëzoj për këto punë të mira që po i bëni, d.m.th. me mikrofonin, me urë të Saradranit, krejt i keni bërë. Bravo, ju qoftë!

KRYESUESJA: Për fund, është deputetja Duda Balje për fjalë.

DUDA BALJE: Faleminderit, kryesuese!

Poštovane kolege!

Poštovani ministri,

Naročito mi je drago što vidim ministarku za Obrazovanje i ministra za Finansije. Htela bi sam da vam prenesem pozdrave roditelja koje imaju decu na nastavi na bosanskom jeziku, a naročito one koji imaju jedno, dve ili troje dece, i da vam prenesem da su u velikoj finansijskoj krizi s obzirom na to da novac koji su dobili od subvencija ne mogu da kupuju ni polovinu knjiga zbog cena koja su na bosanskom jeziku. Čisto da vam kažem, recimo Matematika za osmi razred na albanskom jeziku je 5 evra, a na bosanskom 18. Geografija na albanskom jeziku je 5,5 evra, na bosanskom jeziku je 16 evra.

Ja ne znam da li ste vi prošetali po knjižarama, i ne znam kakvu ste Matematiku u stvari pravili i kako ste mislili da ispoštujete zakon i Ustav o besplatnom obrazovanju učenika na bosanskom jeziku, kad je to besplatno sada više daleko, mnogo daleko od toga. Iskreno bez ikakvih nekih loših namera, hoću da vam kažem da roditelji ne mogu da novcima koje se dobili od države kupe te knjige. Nemoguće je! Ja se nadam da znate, ovi su fakti. Znači, ovi su fakti! Evo da odete po knjižarama, možete sami da se uverite. Ja sam otišla u Prizrenu, recimo u knjižaru koja je bila jedina koja prodavala te knjige, cene su bile te.

Možete vi uopšte da zamislite kako je roditeljima koji imaju troje dece? Znači apsolutno nemaju besplatno obrazovanje i apsolutno imaju jako veliki problem. Pored toga što su knjige skupe, njih i nema u prodaji, i verujte mi da postoje jedan određenih broj roditelja koji svojim deci nisu kupili knjige zbog cena koja su jako velike, pa su sada krenuli da kupuju ili stare knjige, ili kopiraju one is prošlih godina. Znači mislim da ne delujemo motivirajući. Za naš Bošnjake, obrazovanje centar i baza svega što se dešava u našoj zajednici. Stvorili smo problem roditeljima i stvorili smo problem nastavnicima i učiteljima. A najveći problem stvorili smo u stvari u samoj deci.

Ministar Finansije je tu, ja vas molim da izađite na teren da vidite samo fakte. Ove su fakti. Ove cifre su fakti. Ja ove cifre ne izmišljam. Da odete u bilo kojoj knjižari, i da vidite knjige koštaju toliko. Imam naravno i ceo spisak, imam naravno i knjige, koje naravno nemaju cene iza, pa smo ostavili mogućnost i da se manipuliše i na taj način. Ja vas stvarno molim na nađete neki način i da ovakvo grešku na sledećoj godini ne ponavljate.

**KRYESUESJA:** Kaq kemi kohë për deklarime jashtë rendit të ditës nga pjesa e deputetëve. Deputeti Xhavit Haliti e ka kërkuar fjalën për procedurën.

**XHAVIT HALITI:** Zonja kryetare!

Më vjen keq, por rregullorja vlen për të gjithë, edhe për ty. Me leje tënden, z. Muja e uzurpoi foltoren e Kuvendit pa pasur të drejtë, replikë në pikën në fjalë. Ju kisha lutur që ta respektoni Rregulloren për të gjithë. Rregullorja nuk është kur një diskutues i një partie tjetër që ka fuqi votash më shumë e diskutuesit e tjerë të mos kenë të drejtë.

Pika është në të ndryshme, të gjithë kanë të drejtë të flasin dhe ta shprehin mendimin e tyre lidhur me çështjet që u interesojnë edhe deputetëve, edhe elektoratit. Andaj, nuk ka nevojë as për hidhërim, as për tolerim të askujt në këtë pikë.

Mendoj që kjo duhet të jetë hera e fundit që shkelet kështu. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** I nderuar, më duhet të jap edhe unë një sqarim. Nuk e kam shkelur Rregulloren e Kuvendit. Përderisa një person i referohet një fjalimi të deputetit, që e bazon gjithë fjalimin në

kuadër të fjalimit të tij, kam të drejtë edhe unë të flas, edhe i jepet e drejta e replikës. Në fakt, mund ta shihni edhe në raste të tjera, kur u është dhënë e drejta dhe mund ta shihni në të gjitha seancat që i kam udhëhequr. Nëse mund të gjesh diku ku unë kam favorizuar dikë apo tjetër, mund të vish me fakte. Përndryshe, ajo nuk qëndron, i nderuar.

Tash fillojmë me deklarinimin nga ana e Qeverisë. Fjalën e ka ministrja Nagavci.

**MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit!

Unë po përgjigjem në lidhje me adresimet e dy deputetëve në lidhje me tekstet e komuniteteve, të deputetit Kervan dhe të deputetes Balje.

Për informatën tuaj, ne e kemi analizuar me kujdes të gjitha shqetësimet që kanë ardhur dhe e kemi përcjellë situatën se si qëndron në lidhje me çmimet e teksteve, sepse pas rezultatit shumë të mirë që e kemi pasur, e për të cilin besoj që ju jeni të vetëdijshëm që për herë të parë në Qeverinë Kurti ne kemi tekste për fëmijët e komuniteteve në gjuhën e tyre, tashmë duhet të kujdesemi që ata të mos diskriminohen edhe në lidhje me çmimet, respektivisht familjet e tyre.

Për këtë arsye, në bashkëpunim edhe me MINT, me inspektorët dhe po ashtu me autoritetin mbikëqyrës, kemi pasur vizita në librari dhe kemi identifikuar shkeljet. E di që në disa raste tashmë janë shqiptuar dënime ndaj shtëpive botuese, të cilat nuk kanë respektuar legjislacionin në fuqi dhe do të merren veprime edhe më tutje për secilin rast individual, qoftë kur ka pasur kushtëzime për prindërit, qoftë kur ka pasur shkelje të legjislacionit tjetër në lidhje me furnizimin me tekstet dhe me mjetet mësimore.

Po ashtu, ju njoftoj se zyrtarët nga Ministria e Arsimit, zyrtarët përgjegjës për komunitete kanë kontaktuar me shtëpitë botuese, sepse sivjet nuk ka asnjë arsye që çmimi për këto tekste të jetë më i lartë. Derisa, në vitin e parë kur janë botuar këto tekste, ata kanë pasur një arsyetim se çmimet mund të jenë më të shtrenjta edhe për shkak të përktimeve që kanë qenë të obliguar t'i bëjnë dhe për shkak të ekzemplarit më të vogël. Sivjet janë të njëjtat tekste që kanë qenë edhe vitin paraprak, kështu që nuk ka arsye për rritje të çmimit.

Gjithsesi, jemi në bashkëpunim edhe me ministrin dhe me ministrinë e linjës, në mënyrë që çdo shkelje e identifikuar të marrë masa sipas legjislacionit në fuqi. Qëndrojmë të hapur për bashkëpunim, në mënyrë që asnjë nxënës nga asnjë komunë dhe asnjë shkollë të mos mbetet pa u pajisur me tekste.

E shfrytëzoj edhe këtë mundësi që t'ju njoftoj që ne e kemi përcjellë me vëmendje gjithë procesin e furnizimit të fëmijëve me tekste dhe mjete mësimore dhe përkundër diskutimeve që mund të bëhen për arsye që unë nuk mund t'i paragjykoj këtu, nuk kemi asnjë komunë, sikurse

nuk kemi pasur as vitin e kaluar, nga asnjë drejtor komunal i asnjë komune, asnjë adresim në lidhje me mospajisje të fëmijëve me tekste dhe mjete mësimore.

KRYESUESJA: Ministri Vitia e ka fjalën.

ARBEN VITIA: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ndjesë për vonesën, por rrugës e pashë fjalën e z. Haxhiu, i cili tha disa të pavërteta që më duhet t'u përgjigjem menjëherë dhe të tregoj se me gjysmë informacioni ose me informacione të pasakta të dalësh e të vjellësh vret e të thuhen të pavërteta këtu, nuk është korrekte.

Në shtatë vjetët e fundit, hera e parë sivjet që trendi i ikjes së mjekëve nga Republika e Kosovës është ulur. D.m.th. vetëm shikon shifrat, nuk ka nevojë unë të flas këtu a të sqaroj. Besoj që këto shifra i ka edhe deputeti Haxhiu, mirëpo del edhe thotë të pavërteta.

Për dallim, vetëm një analogji, në shtetet e rajonit, p.sh. në Maqedoninë e Veriut dyfish ky numër është më i madh në raport sesa me Republikën e Kosovës. Mirëpo, e rëndësishme është që në këtë vit ka trend të uljes, e kjo mendoj që vjen ekskluzivisht për shkak të rritjes së pagave dhe përmirësimit të kushteve për profesionistët shëndetësorë.

Deputeti Haxhiu tha se statuti i SHSKUK-së po i mbyll disa shërbime. Ne, deputetë e qytetarë të nderuar, çdo ditë po hapim shërbime të reja në spitalet regjionale dhe është absolutisht e pavërtetë se statuti i SHSKUK-së parashikon mbyllje të shërbimeve. Kjo është një e pavërtetë e radhës, e cila duhet të adresohet, sepse do të forcohen dhe do të forcohen edhe më shumë spitalet regjionale, në mënyrë që fluksi i pacientëve nga spitalet regjionale të ulet në QKUK, shtuar këtu edhe shërbimet atje.

Thatë për mungesën e barnave që s'ka qenë kurrë më keq. Një e pavërtetë tjetër. E ftoj edhe deputetin Haxhiu dhe të gjithë ata që janë të interesuar t'i marrin shifrat nga barnatorja qendrore në SHSKUK dhe të shohin se në Kosovën e pasluftës kurrë më shumë QKUK dhe spitalet regjionale nuk kanë qenë më shumë të furnizuar me barna.

Përmendi fasadimet dhe renovimet në shëndetësi.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në një të ardhme shumë të afërt do të tregoj se si janë bërë fasadimet e renovimet në të kaluarën, e çfarë problemesh kemi gjetur ne kur janë bërë këto renovime dhe mënyrën qysh e kemi bërë ne, sepse ne nuk bëjmë pa plan dhe nuk bëjmë vetëm për fasada.

Në fund, tjetër, e përmendi Klinikën Emergjente me disa shtretër, të cilët i kemi marrë nga Klinika e Pediatriisë. Një e pavërtetë tjetër. Ne i shfrytëzojmë të gjitha kapacitetet që nuk shfrytëzohen brenda klinikave. Në Klinikën aktuale Emergjente janë shtuar tetë shtretër, kurse sa i përket Qendrës Emergjente, një projekt i filluar qysh nga 2015, me njëqind e një mijë telashe, tash natyrisht që është në OSHP e po presim përgjigjen e OSHP për të vazhduar tutje, por s' do të ketë më problem. Faleminderit!

KRYESUESJA: Vazhdojmë me pikën:

## **2. Pyetjet parlamentare**

Siç e dini, koha për pyetjet parlamentare është gjashtëdhjetë minuta. Në këtë seancë janë gjithsej 58 pyetje. Prej tyre, 56 të bartura e dy të reja.

Atëherë fillojmë me pyetjen e parë. Është deputetja Ganimete Musliu, ka pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Ministrin nuk e kemi të pranishëm. A doni ta merrni fjalën?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare!

Janë bërë më shumë se gjashtë muaj që unë e kam parashtruar një pyetje parlamentare për ministrin Xhelal Sveçla dhe ai në asnjë formë dhe në asnjë rrethanë nuk gjen kohë për të ardhur në Kuvend dhe për t'u përgjigjur.

Sido që të jetë, do t'ia jap edhe një rast për seancën tjetër.

KRYESUESJA: Në rregull!

Tani në radhë është deputetja Ariana Musliu-Shoshi, pyetje për Kryeministrin Albin Kurti. Nuk e kemi kryeministrin të pranishëm. A doni ta merrni fjalën?

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Ka më shumë se gjashtë muaj që dy pyetjet e mia bredhin poshtë dhe lart në Kuvend, nga një seancë në tjetrën. Kështu që, patjetër, këtë pyetje do ta mbaj derisa Kryeministri të jetë prezent në seancë.

KRYESUESJA: Atëherë, është edhe pyetja e dytë e radhës. Bartet edhe kjo.

Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Nuk e kemi kryeministrin të pranishëm. E keni fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Pyetja është për Ligjin për referendumin, e parashtruar qysh në muajin mars dhe tani jemi në muajin shtator. Kryeministri ende nuk e ka marrë as mundin, as guximin, as vullnetin që të

përgjigjet për një pyetje parlamentare, të cilën e kishte premtim elektorale sa ishte në opozitë. Për Ligjin për referendumin, unë e ftoj Kryeministrin që të vijë në seancë dhe të përgjigjet.

Sa u përket shqetësimeve të ngritura në deklaratimet jashtë rendit të ditë, unë e ftoj ministrin e Shëndetësisë t'i bëjë publike të gjitha kontratat të cilat i ka nënshkruar për renovimet në SHSKUK.

**KRYESUESJA:** Tani në radhë është deputeti Rashit Qalaj, pyetje për ministrin Liburn Aliu. Nuk e kemi ministrin të pranishëm. A doni ta merrni fjalën?

**RASHIT QALAJ:** E nderuar nënkryetare!

Pyetja që kam përgatitur për ministrin Liburn Aliu daton më 26.07.2023, pra, më shumë se një vit jam duke pritur që ta marr një përgjigje nga ministri Aliu mbi një çështje shumë të rëndësishme që ka të bëjë me asfaltimin e segmentit rrugor nga QMI deri në hyrje të Lipjanit, mirëpo që një vit e tre muaj ministri nuk po gjen kohë që t'i përgjigjet kësaj pyetjeje. Normalisht, do ta mbaj këtë pyetje për seancën e radhës kur ai të jetë prezent.

**KRYESUESJA:** Në rregull, tani në radhë është deputetja Time Kadrijaj, pyetje për Kryeministrin Albin Kurti. Nuk e kemi të pranishëm. Të bartet pyetja.

Në radhë është deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Hekuran Murati.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Zonja kryesuese, po e bart pyetjen për seancën e radhës.

**KRYESUESJA:** Në rregull!

Deputeti Mërgim Lushtaku, pyetje për ministren Arbërie Nagavci.

**MËRGIM LUSHTAKU:** Realisht këtë pyetje e kemi bërë edhe më herët, kështu që unë e tërheq pyetjen.

**KRYESUESJA:** Atëherë, pyetja është tërhequr.

Prapë deputeti Mërgim Lushtaku, pyetje për ministrin Hekuran Murati. E keni fjalën.

**MËRGIM LUSHTAKU:** Unë i tërheq të gjitha pyetjet parlamentare në emrin tim, sepse këtu vetëm kanë skaduar si pyetje, prandaj i tërheq.

**KRYESUESJA:** Në rregull!

Atëherë, është edhe pyetja e radhës nga deputeti Mërgim Lushtaku për ministrin Liburn Aliu që tërhiqet. D.m.th. që të tri pyetjet, me kërkesë të deputetit tërhiqen.



Deputeti Bekë Berisha, pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Nuk e kemi ministrin të pranishëm. Deputeti Bekë Berisha nuk do ta bëjë pyetjen.

Vazhdojmë me deputeten e radhës. Deputeti Besnik Tahiri, pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Nuk e kemi të pranishëm, kështu që barten pyetjet.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Liburn Aliu, nuk e kemi të pranishëm.

Deputeti Pal Lekaj, pyetje për ministrin Faton Peci.

PAL LEKAJ: E nderuar nënkryetare, meqë ka kaluar shumë kohë dhe kemi pasur injorancë totale nga Qeveria dhe ministrat përkatës, i tërheq të gjitha pyetjet që i kam parashtruar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull! Atëherë deputeti Pal Lekaj i tërheq pyetjet.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Liburn Aliu, nuk e kemi të pranishëm.

Deputeti Elmi Reçica, pyetje për ministren Rozeta Hajdari. Më falni, nuk e kemi deputetin të pranishëm.

Prapë deputeti Elmi Reçica, pyetje për Kryeministrin Albin Kurti. Nuk e kemi të pranishëm.

Deputeti Ferat Shala, pyetje për ministren Artane Rizvanolli.

FERAT SHALA: E nderuar kryesuese,

Pyetja që kam shtruar para shumë muajsh ka humbur relevancën. Ministrja tashmë disa herë është prononcuar se nuk përgjigjet. Megjithatë, bash kisha pasur qejf të dëgjojë ministren çka thotë për ndërmarrjen Trepça, si është gjendja atje e minatorëve, a kanë marrë licencë, sa inxhinierë i ka në Bordin menaxhues? Pse ka ardhur në këtë gjendje kur para një viti ministrja doli në konferencë shtypi dhe tha po performon ndërmarrja në mënyrën më të mirën të mundshme? Cila është performansa e ndërmarrjes sot? Qe sa ditë dhe si do të veprojnë për ditën e humbura nga greva? Pse po ndiqen e po persekutohen ekspertët e ndërmarrjes, inxhinierët? Cili është opsioni? Si pret kjo, a i ka zbuluar ende hajnat në Trepçë? Sepse, shkonte i pyeste bashkë me ministrin e Brendshëm minatorët. Edhe të shkosh sot t'i pyesësh minatorët e Trepçës kush po vjedh, kur ministrja menaxhon me ndërmarrjen Trepça, kur ministrja e ka caktuar menaxhmenti, ku ministrja i ka ndërruar tri herë drejtorët, ku ministrja e ka në dorë menaxhimin e ndërmarrjeve publike, ku ministrja kontrollon dhe menaxhon çdo sektor të kontrollit dhe të financave në këtë ndërmarrje, vërtet është për marre. Andaj, kisha pasur qejf të di, çka po ndodh në këtë ndërmarrje dhe cila është perspektiva e saj sipas logjikës dhe mënyrës së menaxhimit të kësaj Qeverie?

KRYESUESJA: Ministrja Rizvanolli e ka fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit, deputet Shala, për pyetjen!

Ju gjatë pyetjes suaj në fakt dhatë një deklaratë të gjatë dhe shtuat edhe shumë pyetje specifike për numrat e inxhinierëve dhe të tjera, për të cilat nuk i kam përgjigjet këtu. Mirëpo, në pyetjen që e keni bërë fillimisht kur e keni shtruar e dërguar pyetjen, po ju përgjigjem.

Tani, sa po flasim, Trepça është duke prodhuar me një kapacitet në rritje në krahasim me muajt e kaluar dhe në krahasim me vitin e kaluar. Po sapo flasim, gjithashtu janë duke u bërë përpjekje që të rritet prodhimi në ndërmarrje në mënyra të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe kthimin e rreth tetëdhjetë punëtorëve që po risistemohen në ecurinë e prodhimit, nga radhët e atyre që ndër vite kanë lëvizur nga miniera drejt sipërfaqes, një tendencë, një trend që ka filluar në kohën kur ju e keni menaxhuar.

Dyzet e gjashtë punëtorëve të rinj po u vazhdojnë kontratat e punës të ndërlidhur drejtpërdrejt me prodhimin, gjë që gjithashtu do të vazhdojë të kontribuojë në rritje të prodhimit. Ndërsa, gjithashtu, Trepça po përgatit trajnimin dhe certifikimin e nëntëmbëdhjetë minandezëve, duke u mbështetur në udhëzimin e ri administrativ që ka nxjerrë Ministria e Punëve të Brendshme, me kërkesën e Trepçës për ta trajtuar këtë çështje, Ministria e Punëve të Brendshme ka reaguar me prioritet.

Në Trepçë shpenzimet mujore aktualisht arrijnë rreth 1,5 milion euro, ku rreth një milion euro janë shpenzime për para, ndërsa shpenzime të tjera rreth pesëqind mijë euro. Ndërmarrja ende ka vështirësi në mbulimin e këtyre shpenzimeve. Rrjedhimisht, muajt e fundit është fokusuar në riorganizimin dhe sistematizimin e punëtorëve në vendin e punës në të cilin janë pranuar dhe në kthimin në kontratën bazë ku kanë qenë.

Trepça do ta shfrytëzojë, menaxhmenti dhe bordi janë duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë e brendshme për riorganizim të burimeve njerëzore dhe vendosjen e punëtorëve në vendin bazë ku kanë qenë. Pas kësaj, do të shohim hapësirat në cilat pozita duhet të plotësohen me minatorë të rinj.

Përgjatë kësaj periudhe, bordi i ri dhe menaxhmenti i ri ka përpiluar edhe një plan për muajt në vijim, i cili, në njërin anë synon uljen e shpenzimeve, një mënyrë me të cilën kjo bëhet është edhe duke larguar nga listat e pagave punëtorë, të cilët është kuptuar që nuk kanë qenë në punë madje me muaj e vite, por që janë paguar nga Trepça, mirëpo edhe duke marrë masa disiplinore për shkelje të detyrave, duke përfshirë këtu edhe raste të dyshimeve për manipulime në tenderë e keqpërdorime të tjera të detyrës.

KRYESUESJA: Keni pyetje plotësuese?

FERAT SHALA: Ministre,

Nuk na u përgjigje në asnjë prej pyetjeve që shtrova. Nuk na u përgjigje me çfarë kapaciteti po prodhon Trepça? Nuk m'u përgjigje pse po i ndjek inxhinierët dhe ekspertët nga Trepça? Nuk na u përgjigje si është gjendja reale, çka na pret në të ardhmen nesër? Nuk na u përgjigje sa obligime ka Trepça sot ndaj institucioneve shtetërore dhe sa obligime ka ndaj ndërmarrjeve private? Nuk na u përgjigje pse në të gjitha raportet tuaja nga ardhja jote në menaxhim e ke ndarë Trepçën-veriun, dhe nuk figuron askund në raportet zyrtare të performansës së ndërmarrjes. Pra, ekziston një Trepçë tjetër për ty. Nuk na u përgjigje për të gjitha këto masa ndëshkuese që po merr pa asnjë bazë dhe pa asnjë analizë. Nuk na the asnjë shifër sa në të vërtetë ke investuar në investime kapitale. Ju e dini që unë e kam lënë atje me pesëmbëdhjetë milionë euro kesh në konton e Trepçës dhe sot e ke mbi...

KRYESUESJA: Ministrja Rizvanolli e ka fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: I nderuar deputet,

Pyetjet e tua të cilat i keni shtruar tash, unë nuk i kam informatat e freskëta me vete. Sa u përket 15 milionëve që i keni lënë konto, po besoj këto kanë qenë nga shitja e mbetjeve që është bërë te kompania IMCO, nëse nuk gaboj, diçka për të cilën ende flitet në Trepçë dhe jo vetëm, për çmimin e lirë me të cilin është shitur dhe për të cilin besohet dhe të gjithë thonë që ka pasur keqpërdorime jashtëzakonisht të mëdha.

Nëse po u referoheni 15 milionëve që i keni lënë nga këto shitje, atëherë kjo nuk është diçka që ne e synojmë.

KRYESUESJA: I nderuar, e keni një minutë për ta përmbyllur pyetjen.

FERAT SHALA: Jo, ministre e ke gabim. Mjetet që i kam lënë nga mbetjet kanë mbetur në AKP dhe ju i menaxhoni dhe e dini saktë. Krejtësisht e pavërtetë. Unë i kam lënë mjetet nga prodhimi, nga rentabiliteti, nga investimet kapitale.

Në asnjë makinë prodhuese nga ardhja juaj nuk e keni sjellë. Unë kam lënë 6 milionë euro makina të Atllaskpos të reja në Trepçë. Unë kam lënë dyfishimin e rritjes së pagave. Unë kam lënë për herë të parë investime kapitale të hidrombushjes. Unë kam lënë eksportet më të mëdha që ka pasur ndonjëherë. Ty të dhimbsen mbetjet e ish-Jugosllavisë, por ti ke mbetur në atë konturë.

Realisht, je orvatur që të shitësh mbetje të tilla, por nuk ditur dhe nuk ke mundur dhe s'keni kapacitete. Ministre, a më thua saktë ku mbeti gjeologu, arkeologu gjerman që e solle për Trepçën dhe diku mbeti, s'e pamë rezultatin e tij. E pate angazhuar një arkeolog për Trepçën. Kthehu në realitet, sepse... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Prapë deputeti Ferat Shala, pyetje për ministren Artrane Rizvanolli. I nderuar, ju lutem të kufizoheni të pyetjet që i keni parashtruar.

FERAT SHALA: Thënë të drejtën, unë nuk e di çka e pyes, se kjo paska ardhur e papërgatitur. Thashë, pyetjet realisht janë jashtëzakonisht të skaduara nga koha, por që parimisht ministrja në asnjë raport, në asnjë raport të saj nuk e ka pasqyruar çështjen e ndërmarrjes Trepça, veri.

Na thotë ministrja, pse e ka abroguar në raportet zyrtare njësinë e Trepçes-veri. Na thotë ministrja, cila është shkalla e monitorimit në këtë njësi. Na thotë ministrja, sa mjetet ka ndarë nga subvencionimi për Trepçën në njësi. Le të na thotë ministrja tani, nëse po do të flas edhe për sektorin edhe për të kaluarën.

KRYESUESJA: Ju lutem, fokusoheni te pyetjet, të cilat i keni parashtruar.

FERAT SHALA: Unë e di çka flas, është koha ime.

KRYESUESJA: Jo, nuk mundeni. Këto janë pyetjet parlamentare të cilat...

FERAT SHALA: Le të na thotë ministrja, sa sot e ka gjendjen e licencave në ndërmarrjen Trepça, dhe pse punohet pa licencë. Le të na thotë ministrja, pse sot edhe në KEK punohet pa licenca. Pse shkelet ligji në mënyrë flagrante...

KRYESUESJA: I nderuar, të lutem fokusohu te pyetja të cilën e ke për ministren.

FERAT SHALA: Kur vjen ministrja 6 muaj pas kohe që të përgjigjet, edhe unë pas 6 muajve flas për gjendjen reale të ndërmarrjeve publike, jo për ato që kam menduar të flas para 6 muajve. Para 6 muajsh janë bërë pyetjet dhe s'ka pasur guxim intelektual dhe qeveritar që të vijë e të përgjigjet dhe sot vetëm thotë, çka më ke pyetur para 6 muajve. Jo, po të pyes sot se si e ke ndërmarrjen? Po të pyes sot, si është KEK-u? Po të pyes sot, sa janë kapacitetet prodhuese e gjeneruese në KEK? Po të pyes sot, sa janë kapacitete prodhues e gjeneruese në KEK? Po të pyes sot, pse nga 18 i muajit të kaluar në KEK nuk ka filtra dhe ndotet ambienti? Po të pyes për sot, jo para përpara 6 muajve.

KRYESUESJA: I nderuar, e keni të gjithë të drejtën të bëni edhe pyetje të reja, kështu që keni pasur afat deri të martën që të dorëzoni pyetje të reja për seancën e sotme. Ministrja Rizvanolli e ka fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: I nderuar deputet Shala, tendenca juaj që ta shfrytëzoni për fjalime pyetjen që po e bëni për herë të dytë, po tash keni dalë komplet prej temës. Para 6

muajve keni pyetur për mbarëvajtjen e ankandit për kapacitetet solare, sepse keni menduar që është duke dështuar dhe keni shpresuar që është duke dështuar.

E kemi pasur ankandin solar më të suksesshëm, shembull në rajon dhe në Evropë, me 6 kompani dhe konzorciume ndërkombëtare, lokale, të diasporës. Kemi pasur një proces të konkurrencës që ka zgjatur tetë orë, ku kompanitë kanë dhënë çmimet e tyre.

Si rezultat kemi filluar me një çmim prej maksimal prej 75 euro për mgw orë, kemi përfunduar me një çmim prej 48.88 euro për mgw orë.

Një sukses i jashtëzakonshëm që e ka vendosur Kosovën në hartë të investimeve të huaja direkte dhe veçanërisht në burime të ripërtërishtme të energjisë. Një shembull se si qytetari përfiton kur ka transparencë, kur ka qeverisje të mirë dhe kur ka procese dhe konkurrencë fer dhe transparente.

Ky është një shembull të cilën do ta vazhdojmë edhe në të tjera, ndërsa sa i përket këtij procesi, kontrata është nënshkruar në fund të prillit dhe konzorciumi fitues është duke e bërë dizajnin detaj të projektit siç ka qenë e paraparë dhe duke i bërë fazat e tjera përgatitore për të filluar ndërtimin.

Faleminderit për pyetjen dhe interesimin që e keni pasur për ankandin solar megjithëse kur keni menduar që përgjigjja do të jetë ndryshe.

**KRYESUESJA:** Nuk është mikrofoni i lëshuar, i nderuar. Vetëm nëse keni pyetje shtesë, nuk e kemi kohën e deklarimeve jashtë rendit të ditës tani. Jemi te pyetjet parlamentare. Ju lutem të keni pak respekt!

**FERAT SHALA:** Dua ta mbaj në energji, se në energji po ka qejf. Pra, ministre u përgjigje për energjinë 6 muaj pas kohës së nënshkrimit të kontratave dhe nuk kam çfarë të pyes, sepse u bë publike. Por, na trego për energji, pse KEK-u është duke operuar me licence vetëm dy-vjeçare, ia dhatë para pak ditësh. E përshëndes prapë që ia dhatë SHARCEM-it për 22 vjet.

Qysh ka mundësi një sektori privat pasi e vizituar disa ministra edhe e çuat bordin politik atje, ia dhatë për 22 vjet SHARCEM-it licencën, e KEK-ut ia dhatë vetëm për 3 vjet, e Trepçës veç për 2. Pra, çka ndodhi që ju 22 vjet ia dhatë SHARCEM-it me proces të përshpejtuar, duke i bërë presion dhe shkelur Ligjin për KPMM-në, sepse në Ligjin për KPMM-në, ti e di mirë, thotë, e merr licencën ai në bazë të cilit ka aplikuar.

Jashtëligjshëm jeni duke operuar me KPMM-në ju personalisht si Qeveri dhe jashtëligjshëm jeni duke e lënë... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Ministrja Rizvanolli e ka fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Kjo do të duhej të ishte pyetje shtesë e deputetit. Por, deputeti megjithatë po e shfrytëzon në mënyrën e vet qysh paska vendosur sot në tema të lira ku po dy të hyjë edhe ku po do të dalë.

Edhe kjo le të llogaritet si përgjigje shtesë imja, megjithëse nuk bëtë asnjë pyetje shtesë në lidhje me pyetjen origjinale. Madje nuk e bëtë as pyetjen origjinale që keni pasur për ta bërë, po e shfrytëzuar për të folur për tema të tjera.

E tashti për temat që po i ngritni këtu ad-hoc për kompani specifike, unë nuk mund t'ju përgjigjem. Mirëpo, është interesant deputet Shala, qysh ju përgjatë këtij mandati pyetjet më të shpeshta dhe brengat më të mëdha i keni pasur kush e ka fituar një tender diku edhe kush e ka fituar na keni informuar këtu e kam marrë vesh prej jush. Ose, kujt i është dhënë licenca dhe me çfarë procedure.

Deputet Shala, interesimet e mia dhe puna ime ditore është pak më ndryshe. Unë nuk i di për besë këto gjëra. Nganjëherë, zakonisht i marrë vesh prej teje se cila kompani private po fiton, cila s'po fiton edhe kush po licencohet edhe kush s'po licencohet.

Sa u përket kompanive publike, mund t'i bëni pyetjet të rregullta kur të vendosni t'i bëni edhe i marrë informatat e ju përgjigjem.

KRYESUESJA: E keni një minutë kohë për ta përmbyllur pyetjen.

FERAT SHALA: E nderuar ministre, unë e di që pjesë një nuk e di, por duhet t'i dish për KEK tenderët meqë i përmende, dhe këtu të kam thënë që e ke gabim dhe ke vazhduar me të njëjtën logjikë dhe sot dihet çka po ndodh me menaxhmentin e KEK-ut. Dihet nga tenderët njëburimorë çka ka ndodhur.

Dihet që janë ngritur aktakuza për të cilat ke një përgjegjësi të madhe. Edhe sot për shkak të tenderëve njëburimorë, qytetarët e Kosovës po ndotën nga mosveprimi ose mosreagimi apo mosfunksionimi i filtrave. Nga data 18 e muajit të kaluar, Kosova është duke u helmuar nga mosveprimi dhe keqmenaxhimi i skajshëm juaji dhe i menaxhmentit të KEK-ut.

Shikoni! Ndotjen që po ndodh, t'i bëni publike të lutem shkarkimet që i ke obligim. T'i bëni publike shkarkimet që dalin nga termocentralet. Rregullorja dhe ligji e thotë qartë, ju duhet t'i bëni publike shkarkimet që po ndodhin në KEK...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Nuk i kemi të pranishëm.

Prapë deputetja Blerat Deliu-Kodra, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Nuk i kemi të pranishëm.

Deputeti Rashit Qalaj, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. E keni fjalën.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, nënkryetare! Unë i kam dy pyetjen për kryeministrin e Kosovës të dorëzuara më 20 tetor të vitit 2023. Pra, rrafsh që gati një vit, dhe nuk kemi pasur mundësinë që në këto pyetje të marrim përgjigje nga kryeministri i Kosovës për shkak se me të vërtetë e dëshmoi vet që puna e tij, rezultati është x e barabartë me zero. Po i bart këto pyetje në seancën e radhës, kur ai të jetë prezent.

KRYESUESJA: Në rregull, atëherë që të dyja pyetjet barten për seancën e radhës. Prapë është deputeti Rashit Qalaj, pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Nuk e kemi ministrin e pranishëm. Bartet edhe kjo pyetje me kërkesën e deputeti. Deputeti Hajdar Beqa, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Nuk e kemi kryeministrin të pranishëm. E keni fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesuese!

Unë i kam dy pyetje për kryeministrin në shkuarje, zotin Kurti. Pyetjet janë bërë më 20. 10. 2023 edhe njëra prej pyetjeve ka pasur të bëjë me situatën aktuale, e në veçanti për gjendjen e rëndë ekonomike nëpër të cilën po kalojnë qytetarët tanë. Fatkeqësisht kjo gjendje vetëm sa është thelluar.

Por, çka është për t'u mos u pranuar, se pyetjen do ta bart, po nëse zbatohet Rregullorja dhe e ke përgjegjësi që ta zbatosh Rregulloren edhe ti edhe kushdo që e kryeson Kuvendin, neni 92 i Rregullores së Kuvendit të cilën e kemi votuar më 28 korrik të vitit 2022, e merr obligim Kuvendi që të mos e lejojë Qeverinë të jetë e papërgjegjshme dhe të mos i përfillë deputetët edhe Kuvendin, sepse e ka obligim që të përgjigjet në pyetje, edhe te neni 92, pyetjet me gojë, po edhe te neni 93, pyetjeve me shkrim.

Andaj, unë mendoj që ne do duhej edhe duhet të jemi në nivel të detyrës si deputetë dhe ata ministra dhe ai kryeministër që nuk përgjigjet, nuk duhet të shkojmë në pika të tjera pa u përgjigjur, sepse duhet t'i tërhiqet të paktën vërejtja me gojë në bazë të nenit 92, pika 8 e Rregullores, nga kryesuesi se pse nuk po përgjigjet.

Nuk ka asnjë arsye që nga 2023, muaji 10, data 20 që të mos përgjigjet. Kështu, e bart pyetje edhe e di se tani këto pyetje më s'janë relevante, se edhe nëse do që të punojë ky kryeministër, nuk ka më kohë që t'i zgjidhë problemet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Prapë deputeti Hajdar Beqa e keni edhe një pyetje për kryeministrin Albin Kurti. A doni ta bartni edhe këtë pyetje, i nderuar?

HAJDAR BEQA: Unë detyrohem ta bart pyetjen për arsye që kryeministri tani nuk është fizikisht, por edhe kur ishte në seancë ka qenë i papërgjegjshëm në raport me deputetët dhe është precedent jo i mirë që për herë të parë në Republikën e Kosovës, Qeveria i kushtëzon deputetët nëse votoni marrëveshjet ndërkombëtare në përgjigje, nëse s'votoni, nëse nuk përgjigje. Dhe, mendoj ky nivel është nën zero i kësaj Qeverie në krye me këtë kryeministër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Isak Shabani, pyetje për ministrin Hekuran Murati. E keni fjalën.

ISAK SHABANI: E nderuar kryesuese, unë i tërheq të dyja pyetjet, jo për shkak se e kanë humbur relevancën, por për shkak se kërkesat të cilat janë parashtruar që një kohë të gjatë, jam i bindur që do t'i realizojë kryeministri i ardhshëm i Kosovës, zoti Bedri Hamza.

KRYESUESJA: Pyetja është tërhequr. Në radhë është pyetja e deputetit Mërgim Lushtaku, por deputeti ka kërkuar që të tërhiqen të gjitha pyetjet e tij. Në radhë është deputetja Eliza Hoxha, pyetje për ministrin Arbërie Nagavci. Nuk e kemi deputeten të pranishme.

Prapë është deputetja Eliza Hoxha, pyetjen për ministrin Hajrullah Çeku. Nuk e kemi të pranishëm. Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Liburn Aliu. Nuk e kemi ministrin e pranishëm. Ta bartim pyetjen për seancën e radhës? E keni fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare!

Nëse mundesh të ma gjesh ministrin, do ta parashtroja pyetjen sot, nëse jo po e presim Bedri Hamzën, qysh tha Isaku.

KRYESUESJA: E keni edhe një pyetje për ministrin Aliu. Doni ta bartni? Në rregull. Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, pyetje për ministrin Hajrullah Çeku. Me kërkesë të deputetes e bartim për seancën e radhës. Keni edhe një pyetje, e nderuar, për ministrin Liburn Aliu. Kërkesa është që të bartet për seancën e radhës.

Prapë deputetja Ganimete Musliu, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Doni ta bartni për seancën e radhës? E keni fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Çka të them! Është i njëjti reagim, e njëjta situatë, e njëjta ndjenjë. Nëse e di se ku është Albin Kurti, prapë, dhe nëse ka gjasa të vijë, unë sot e kryej obligimin tim si deputete ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, dhe do ta adresoj pyetjen. Nëse jo, presim deri në pafundësi.



KRYESUESJA: Deputeti Besnik Tahiri, pyetje për ministrin Liburn Aliu. Në fakt janë dy pyetje radhazi nga deputeti për ministrin Aliu. Të dy nuk janë të pranishëm, kështu që barten të dyja pyetjet.

Në radhë deputeti Mërgim Lushtaku, i cili ka kërkuar që t'i tërhiqen pyetjet. Deputeti Pal Lekaj, pyetje për ministrin Arben Vitia. Kemi gjithashtu dhe një pyetje nga deputeti Pal Lekaj, pyetje për ministrin Faton Peci. Por, deputeti ka kërkuar që të tërhiqen të dyja pyetjet.

Deputeti Hisen Berisha, pyetje për ministrin Liburn Aliu. Nuk e kemi ministrin të pranishëm. E keni fjalën.

HISEN BERISHA: Pyetjet e mia mbesin edhe më tutje aktuale, se i kontrollova. Domethënë, për të gjithë atyre që jua kam drejtuar, edhe kryeministrin, edhe ministren e Drejtësisë, edhe për Liburnin në veçanti mbesin aktive sepse gjendja e rrugëve për të cilat jam interesuar është e njëjta ose janë edhe më tmerruese. Bile sikur të mund t'i ndalnim mërgimtarët që të rrinë deri në fund të vitit, ndoshta do të kryheshin rrugët, fatkeqësisht edhe fatmirësisht u kthyen në vendet e veta të punës, e tash është ndalur edhe puna në to dhe rrugët janë bërë tmerrësisht të pakalueshme, qoftë kjo për Kijevë, qoftë Klinë-Gjakovë, qoftë të tjera drejtime. Kështu që, mbeten për ditë të tjera.

KRYESUESJA: Në rregull! E bartim pyetjen për seancën e radhës. Deputeti Hisen Berisha prapë pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Nuk e kemi kryeministrin të pranishëm. A doni ta bartni pyetjen?

HISEN BERISHA: Edhe pyetja për kryeministrin mbetet aktuale, kështu që kur të jetë këtu ia bëj.

KRYESUESJA: Deputeti Besian Mustafa, pyetje për ministrin Liburn Aliu. Nuk i kemi të pranishëm. Deputetja Rrezarta Krasniqi, pyetje për ministrin Faton Peci. Nuk e kemi deputeten të pranishme. Deputeti Luan Aliu, pyetje për ministrin Liburn Aliu. Nuk e kemi ministrin të pranishëm. A doni ta bartni për seancën e radhës? Në rregull.

Deputetja Mirlinda Tishukaj-Sadiku, pyetje për ministren Artane Rizvanolli. E keni fjalën.

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: Faleminderit, nënkryetare!

Përshëndetje për të gjithë kolegët!

E nderuar ministre Rizvanolli, e dimë të gjithë se uji është element parësor për të jetuar edhe një aset mjaft i rëndësishëm edhe kombëtar. Komunitat e Anamoravës ndër vite përballen me

mungesë të theksuar të ujit të pijes dhe sipas raporteve zyrtare të institucioneve relevante thuhet që mbulueshmëria është deri në masën 75%.

Edhe pse për mua kjo është një shifër mjaft diskutabile, sepse ka rrjete të ujësjellësit të shtrira, madje edhe qysh nga viti 2005, po që asnjëherë nuk janë bërë funksionale, siç është rasti me fshatin Skifteraj, ka në Budrigë, Remnik, Zhiti, Beguncë edhe shumë fshatra të tjera, po ashtu të Komunës së Vitisë.

Sipas një Raporti të performansës të Zyrës Kombëtare të Auditimit rezulton se kompania rajona Hidromorava ka në menaxhim sisteme të ujësjellësit në masën më të ulët në krahasim në rajonet e tjera, dhe atë në përqindje 56%.

Pyetja është, e di që është nënshkruar një kontratë me Flows për investime në Hidromoravë në lidhje me investimet në sistemet të ujit dhe cilat janë mundësitë që të investohet edhe në sistemin e ujësjellësit në Komunën e Vitisë?

KRYESUESJA: Ministrja Rizvanolli e ka fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit deputete Tishukaj-Sadiku.

Kontrata me Flows parasheh investime edhe për Komunën e Vitisë në komponentët në vijim: zgjerimi i fabrikës për trajtimin e ujit të pijes në Letnicë edhe për 60 litra në sekondë. Kapaciteti maksimal aktual këtu është 40 litra. Pra, me këtë investim do të rritet për dy herë e gjysmë kapaciteti i fabrikës. Rezervuari grumbullues me kapacitet 1 mijë e 700 metra kub është komponenti i dytë. Dhe, komponenti i tretë është krijimi i zonave të matura të ujit dhe vendosja e 1 mijë e 500 ujëmatësve të mençur smart.

Sipas projektit vlera investive është rreth 5 milionë euro për investimet e dedikuara për Komunën e Vitisë. Informata shtesë sa u përket investimeve në Komunën e Vitisë. KRUI Hidromorava do të investojë në përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit brenda qytetit të Vitisë këtë vit me shumën rreth 110 mijë euro. Procedurat e tenderimit janë duke u kryer nga ndërmarrja.

KRYESUESJA: A keni pyetje plotësuese?

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: Nuk kam pyetje plotësuese. Veç e kisha falënderuar që fokusi i Qeverisë Kurti 2 dhe po ashtu juaji si ministri e keni adresuar këtë çështje me mjaft interesim. Vetë fakti flet shumë që do të investohet një sasi 5 milionë euro dhe njëherë e përgjithmonë të hiqet ky problem, sepse nuk e di a dini se Komuna e Vitisë ka shumë qytetarë të cilët vuajnë nga gurët në veshka dhe ky investim i Qeverisë Kurti është mjaft domethënës edhe për shëndetin e përgjithshëm të qytetarëve. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Para se të procedojmë tutje, vetëm duhet t'i njoftoj deputetët që me pajisje të reja duhet ta keni kartelën tuaj kur ta merrni fjalën edhe për votim për shkak të formës së regjistrimit të pjesëmarrjes dhe punës së deputetëve. Kështu që, ju lutem edhe nëse i ndërroni vendet duhet t'i keni kartelat tuaja.

Vazhdojmë. Deputeti Shemsedin Dreshaj, pyetje për ministren Arbërie Ngavci. E keni fjalën.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryesuese!

Kjo është pyetje vërtetë që e kam bërë shumë herët. Pra, është bërë në muajin prill të këtij viti. Është një pyetje e cila i adresohet problemit të diplomave të lëshuara në vitet e '90-ta. Pra, bëhet fjalë për gradimet shkencore dhe gradimet profesionale në periudhën '90-'99, me një rikujtim se një pjesë e konsiderueshme e tyre sot kanë grada të profesorit të rregullt universitar, ndërsa në momentin e pensionimit shkojnë me diplomën e shkollës së mesme për shkak se këto grada janë arritur nga viti '90 e pas.

Pyetja ime konkrete për ministren Nagavci është; deri kur nuk do t'i njoh diplomatat dhe gradimet e veta profesionale dhe shkencore të bëra në vitet e '90-ta, me rastin e pensionimit, Qeveria jonë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Ministrja Nagavci e ka fjalën.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare! I nderuar deputet Dreshaj, është e vërtetë që kjo pyetje është bërë muaj përpara dhe në tri herë radhazi në seanca që ka ardhur momenti të shqyrtohet kjo pyetje, dy herë nuk keni qenë ju dhe njëherë ka përfunduar koha.

Përndryshe, për këtë temë unë i jam përgjigjur edhe deputetes Mirlinda Tishukaj që e ka ngritur të njëjtën çështje. Dhe, për informatën tuaj, Ministria e Arsimit njeh të gjitha diplomatat, gradat dhe titujt që janë fituar pa marrë parasysh kur, përfshirë edhe kohën që ju e përmendi.

Ndërkaq, sa i përket çështjes së pensioneve, ju njoftoj se kjo është e rregulluar me udhëzimet e veçanta të ministrisë së linjës dhe nuk ka të bëjë me mosnjohje të diplomave. Pra, nga Ministria e Arsimit njihen të gjitha diplomatat, gradat dhe thirrjet akademike të atyre që i kanë fituar në vitet '90-ta dhe pas kësaj kohe. Faleminderit!

KRYESUESJA: A keni pyetje plotësuese? Urdhëro!

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, ministre!

Vetëm dua t'jua përkujtoj, unë nuk e pyeta Ministrinë e Arsimit a i njeh vetë ajo apo jo diplomat. Sigurt mendoj që i njeh. Por, me rastin e pensionimit është neni numër 5 i udhëzimit

administrativ i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, i cili gradimet që janë marrë pas vitit 1990 nuk i njeh me rastin e pensionimit. Kjo ishte esenca e pyetjes sime. Pyetje ime ishte konkrete. Deri kur më?! Faleminderit!

KRYESUESJA: Ministrja Nagavci e ka fjalën.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Deputet, ashtu siç e thatë edhe ju, Ministria e Arsimit i njeh gradat, titujt dhe gjithçka për profesorët dhe stafin tjetër. Të gjitha udhëzimet administrative, legjislacioni dhe procedurat që ndiqen nga Ministria e Arsimit i njeh gradat dhe thirrjet. Këtë sapo e konfirmuat edhe ju.

KRYESUESJA: Keni një minutë kohë për përmbylljen e pyetjes.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit!

Unë pa dashur të hyj në debat, unë konkretisht bëra pyetje që ndoshta i inkorporon edhe ministritë e tjera brendapërbrenda. Unë e di që gradën shkencore të profesorit kur e kryen profesionin e vet e kanë të drejtën ta ushtrojnë, por me rastin e pensionimit meritat nuk i merr pensioni pas datës së pensionimit të moshës 65 vjeç. Pra, kjo ishte esenca e çështjes që kam ngritur me qëllim që një padrejtësi e këtyllë të ndërpritet një herë e përgjithmonë për punëtorët tanë, qytetarët tanë me dokumentacionin tonin që e kemi lëshuar ne. Deri kur më kështu! Faleminderit!

KRYESUESJA: Në radhë e kemi deputetin Pal Lekaj, pyetje për ministrin Faton Peci, por deputeti Lekaj i ka tërhequr pyetjet. Deputetja Albana Bytyqi, pyetje për ministren Rozeta Hajdari.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit, nënkryetare!

Nuk mendoj që është koha, unë po e tërheq pyetjen për shkak se nuk është koha t'i bëjmë pyetje më kësaj Qeverie, e aq më pak një ministreje që është e korruptuar dhe e dështuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Mirlinda Tishukaj -Sadiku, pyetje për ministrin Faton Peci.

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar ministër,

Që nga viti 2017 si Ministri e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural keni trashëguar një projekt për Institutin Bujqësor të Kosovës, e që ka përfshirë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit me qëllim të krijimit të sistemit dhe bazës së të dhënave për inventarizimin e tokave bujqësore që është shumë i rëndësishëm edhe që ka qenë edhe kërkesë e institutit.

Në bazë të konstatimit që ka bërë Zyra Kombëtare e Auditimit për këtë çështje, vërehet se ka pasur hapësirë të një menaxhimi më efikas të projekteve të teknologjisë së informacionit të cilat shënojnë vlerën e përgjithshme prej 700 mijë euro. Domethënë, ky raport është i performancës 2017-2022. Mungesa e sigurimit të cilësisë, mangësitë në konfigurim të sistemit, mangësi në sigurinë dhe vazhdimësinë e sistemit të informacionit kanë rezultuar edhe me shpenzime të panevojshme.

Prandaj, më intereson ta di ministër, ju si ministër a keni ndërmarrë diçka në këtë drejtim për ta evituar këtë çështje? Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Ministri Peci e ka fjalën.

MINISTRI FATON PEÇI: E nderuar deputete Tishukaj-Sadiku, faleminderit shumë për pyetjen e shtruar!

Projekti për inventarizimin e tokave bujqësore në vlerë prej 1.4 milionë euro është një ndër projektet më abuzive dhe flagrante që unë kam gjetur në Ministrinë e Bujqësisë.

Në këtë projekt në bazë të të gjeturave të raportit të auditorit, po edhe të denoncimeve që i kemi bërë të vazhdueshme, del se është prej projekteve sikurse e thashë, po e përsërisë, më abuzive në kohën e qeverive të kaluara. Si rezultat i veprimeve që unë i kam ndërmarrë si ministër, po edhe mekanizmat e drejtësisë, aktualisht ish-drejtori i Institutit Bujqësor është i suspenduar dhe me aktakuzë të ngritur, e bashkë më të edhe 3 zyrtarë të tjerë për shkak të abuzimit flagrant që kanë bërë me këtë projekt.

Si rrjedhojë e kësaj, në vazhden e angazhimeve tona, unë kam kërkuar edhe auditim të veçantë në mënyrë që të zbardhen të gjitha rastet. Në vazhden e angazhimeve tona për ngritjen e kapaciteteve në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe agjencive vartëse dhe IBK-ja jemi në proces të projektit të digjitalizimit të financuar nga Komisioni Evropian, i cili do të implementohet nga GIZ-i gjerman në vlerë prej 8 milionë eurosh krahas me projektin tjetër prej mbi 20 milionë euro që i dedikohet fushës së agroturizmit.

Zyra Kombëtare e Auditimit në auditimin IBK-së, Institutit Bujqësor të Kosovës në vitin 2023 ka kryer auditim dhe dërguar raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit, menaxhimi i të cilit ka qenë totalisht jashtë çdo standardi dhe detyrimeve ligjore, dhe si rrjedhojë e saj, tashmë gjendja është e sanuar dhe jemi në proces të krijimit të mekanizmave të ri.

Edhe njëherë ju falënderoj për pyetjen për shkak se është njëra prej pyetjeve më përmbajtjesore që unë gjatë gjithë mandatit e kam pasur në Kuvendin e Kosovës, e që flet për njërin prej abuzimeve më të rënda, por njëkohësisht edhe për veprimin e demonstrimin që ne kemi bërë si ministri dhe Qeveri në luftim të krimit dhe të korrupsionit.

KRYESUESJA: A keni pyetje plotësuese?

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: E përgëzoj ministrin që e ka kryer detyrën tamam siç duhet, sikurse edhe shumë ministra të tjera që kanë bërë shumë kallëzime penale që janë në krye të detyrës, sepse është abuzuar me 1.4 milionë euro.

Unë kur e kam lexuar këtë raport të performacës me të vërtet jam shokuar si ka pasur mundësi të ndodh të një gjë e tillë anipse Zyra Kombëtare e Auditorit ka dërguar diku më shumë se 300 raporte, mirëpo janë ngritur vetëm 4 aktakuza. Ju lumtë ministër, veç vazhdoni kështu. E vazhdojmë edhe me Qeverinë Kurti 3.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministren Albulena Haxhiu.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit për fjalën, nënkryetare!

E nderuar ministre Haxhiu, gjatë një vizite në Qendrën Korrektuese në Lipjan në kuadër të vizitave të rregullta që kemi bërë me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, kemi mësuar se në këtë qendër nuk po zhvillohet ende Programi për luftën kundër analfabetizimit.

Qeveria dhe Komuna e Lipjanit, përkatësisht Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë bashkë me Drejtorinë Komunale për Arsim në Lipjan kanë nënshkruar marrëveshje tripalëshe që personave që gjenden në këtë qendër t'u mundësohet një program që do t'ua mundësonte mësimi dhe shkrim-leximin.

Pyetja ime për juve është; pse nuk ka filluar ende realizimi i këtij projekti kaq të nevojshëm për këta persona?

KRYESUESJA: Ministrja Haxhiu e ka fjalën.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit! Faleminderit për pyetjen, po ashtu deputete Labinotë Demi-Murtezi!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që t'ju përgjigjem në raport me pyetjen që e keni adresuar. Në kuadër të Programit për luftë kundër analfabetizimit që nga shtatori i vitit 2023 ka filluar procesi mësimor për të miturit të cilët nuk dinë shkrim-lexim.

Në kuadër të shkollës fillore "Ismail Luma" në Lipjan është angazhuar një mësues për mësime klasor, i cili punon me klasë të kombinuar prej klasës së parë deri në klasën e pestë. Në kuadër të këtij programi nga shtatori i vitit 2023 kanë vijuar mësimet 4 mitur nga Qendra

Korrektuese, kurse këtë vit programin shkrim-lexim nga klasa 1 deri në klasën e pestë janë duke e ndjekur 6 të mitur. Pra, jemi duke punuar dhe jemi duke u angazhuar në këtë drejtim.

Ndërsa më lejoni vetëm të përgjigjem edhe ndaj pyetjes, gjegjësisht ndaj komentit të deputetit Hisen Berisha.

KRYESUESJA: Zonja Haxhiu, të lutem duhet vetëm pyetjes t'i përgjigjesh!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Nënkryetare e Kuvendit, të lutem, nuk është në rregull që në Kuvendin e Kosovës të ketë manipulime.

KRYESUESJA: Zonja Haxhiu, nuk keni të drejtë të komentoni.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Deputeti Hisen Berisha i ka bërë dy pyetje, por i ka tërhequr.

KRYESUESJA: Zonja Haxhiu të lutem, nuk keni të drejtë të komentoni në...

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Unë e kam edhe letrën që ai e ka dërguar dhe në të cilën thekson që i tërheq pyetjet.

KRYESUESJA: Regjia, ju lutem ia ndaloni fjalën!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Prandaj, unë nuk kam faj që deputetët e opozitës i bien pishman.

KRYESUESJA: Regjia! Deputetja Labinotë Demi-Murtezi e ka fjalën.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Lidhur me çështjen që kërkova përgjigje nga ministrja e Drejtësisë, për vazhdimin e Programit kundër luftës së analfabetizmit në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Më vjen mirë që ka filluar të zbatohet ky projekt sipas ministres mosha të caktuara janë të përfshirë, mirëpo në atë Qendër Korrektuese ka edhe mosha të tjera të cilat janë në pritje të jetësimit të këtij projekti dhe ajo çka unë shpresoj në të ardhmen është që Qeveria ta vazhdojë dhe ta thellojë bashkëpunimin që të përfshihen të gjitha moshat në këtë projekt, jo vetëm ata të mitur. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Driton Selmanaj, pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Nuk janë të pranishëm. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Nuk janë të pranishëm. Deputeti Shemsedin Dreshaj, pyetje për ministrin Liburn Aliu. Në fakt janë dy pyetje radhazi nga deputeti Dreshaj për ministrin Liburn Aliu. Nuk është i pranishëm. E keni fjalën.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryesuese!

Vërtet këto dy pyetje presin nga fillimi i qershorit edhe fatkeqësisht nuk kam marrë përgjigje deri më sot. Njëri prej tyre veç i ka skaduar më afati. Pra, flasim për fillimin e shirave në regjionin e Rugovës, dhe rruga Pejë-Kuqishtë është në gjendje të mjerueshme, edhe uroj të mos jetë edhe varr i së nesërme.

Pra, deri më sot përkundër buxhetit të ndarë për renovimin e rrugës Pejë-Kuqishtë. Nuk është bërë asnjë hap as në tenderim e as në fillimin e punimeve. Tash është vonë për pyetjen edhe tash është vonë për rrugën dhe për fillimin e kësaj Qeverie që të bëjë renovimin e asaj pjese të rrugës.

Kjo pyetje nuk ka më as kuptim që të bartet në seancat e radhës, sepse i ka humbur çdo kuptim. Faleminderit!

KRYESUESJA: I nderuar, a do të thotë kjo që i tërheq pyetjet?

SHEMSEDIN DRESHAJ: Po, kryesuese. Pyetjet do t'i tërheq për shkak se kanë humbur kuptimin komplet.

KRYESUESJA: I kemi edhe dy pyetje të fundit. Janë pyetje të reja që bëhen për herë të parë. Është deputeti Bekim Haxhi, pyetje për kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin Hajrulla Çeku. Nuk e kemi deputetin të pranishëm dhe kryeministrin dhe ministrin. Me kaq mbyllen pyetjet parlamentare.

Pika e radhës është:

#### **4. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit shqiptar**

Ju njoftoj se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës i ka shqyrtuar biografitë si dhe ka bërë intervistimin e kandidatëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga 2 kandidatë të propozuar.

Ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc, zonjën Adelina Grainca që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin e Komisionit ad hoc.

ADELINA GRAINCA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Në bazë të neve 44 dhe 45 të Rregullores së Kuvendit, si dhe nenit 26 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit të RTK-së, në mbledhjet mbajtura më 21.6 dhe 25. 6. 2024 zhvilloi procedurat për



përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit të RTK-së dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

#### Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të bëjë emërimin e 1 anëtari të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitetit shqiptar me votim të fshehtë. Për një pozitë për anëtar të Bordit të RTK-së propozohen për votim 2 kandidatë si në vijim: Ilir Bytyqi dhe Bul Salihu.

Kuvendi prej dy kandidatëve të propozuar zgjedh 1 anëtar të Bordit të RTK-së. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të RTK-së bëhet me votim të fshehtë dhe mandati i anëtari të Bordit të RTK-së është 2-vjeçar.

#### Arsyetim

Radio Televizioni i Kosovës në pajtim me nenin 26.2.1 të Ligjit për RTK-në ka bërë shpalljen publike për zgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitet shqiptar.

Kuvendi i Kosovës ka pranuar aplikacionet e 5 kandidatëve nga radhët e komunitetit shqiptar. Komisioni ad hoc i themeluar me vendim të Kuvendit nr. 08V720 i datës 16 maj 2024, në mbledhjet e mbajtura më 21.6 dhe 25. 6. 2024 ka shqyrtuar listën e kandidatëve dhe nga 5 kandidatë të cilët kanë aplikuar ka intervistuar 4 prej tyre për arsye se 1 kandidate nuk i ka përmbushur kushtet e konkursit.

Anëtarët e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të nenit 26.2.4 të Ligjit për RTK-në. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull! Atëherë për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet formimi i një komisioni zgjedhor. Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga 1 anëtar për komisionin zgjedhor. Nga Lëvizja Vetëvendosje, Mimoza Kusari e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetare!

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje propozoj deputetin Agon Batusha.

KRYESUESJA: Në rregull! Nga Partia Demokratike e Kosovës. E keni fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Partia Demokratike e Kosovës e propozon deputetin Isak Shabani.

KRYESUESJA: Në rregull. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARBEN GASHI: Deputeten Vlora Dumoshi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull! Nga Aleanca? Nuk e propozoni askënd. Nga Grupi Multietnik kë e propozoni për komision.

ENIS KERVAN: Deputetin Fridon Lala.

KRYESUESJA: Në rregull. Atëherë, të nderuar deputetë, ju lutem që t'i zini vendet tuaja për shkak që duhet ta votojmë Komisionin zgjedhor. Tani siç e dini votojmë përmes pajisjeve elektronike, kështu që ju lutem t'i zini vendet tuaja. Po votojmë për Komisionin zgjedhor. Vetëm që ta kemi të qartë. Është votim i fshehtë, kështu që duhet at votojmë komisionin.

Vetëm edhe një rikujtim që të keni kujdes që të votoni me kartelat tuaja, me emrin tuaj.

Të nderuar deputetë,

Ju lutem që t'i zini vendet tuaja që të procedojmë me votim për komision. Atëherë, nëse jemi gati e hapi votimin. Konstatohet që me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim formohet komisioni zgjedhor. Lus anëtarët e komisionit që t'i zënë vendet e tyre.

Atëherë, komisioni më njofton që është gati. Do t'i ftoj deputetët sipas radhës që të marrin pjesë në votim:

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Albana Bytyqi, Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj...

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralija, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Behgjet Pacolli, Bekë Berisha, Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri...

Biljana Maksiq, Blerta Deliu-Kodra, Burim Meta, Cvetko Veljkoviq, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili, Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enis Kervan, Enver Dugolli, Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi...

Fadil Gashi, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri, Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Glauk Konjufca, Gramoz Agusholli, Hajdar Beqa, Haki Abazi...

Halil Thaçi, Haxhi Avdyli, Hisen Berisha, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Isak Shabani, Jahja Kokaj, Jeta Statovci, Jetmire Vrenezi, Ksenija Bozhoviq, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku...

Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Milan Joksimoviq, Milan Kostiq, Milazim Salihaj, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku-Tishukaj, Mirsad Shkreta, Nenad Radenkoviq, Nasuf Bejta, Njazi Isaku, Olivera Zdravkoviq, Pal Lekaj, Radosh Mihajlovic, Ramush Haradinaj...

Rashit Qalaj, Rrezarta Krasniqi, Salih Zyba, Samra Iljaz, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Svetislav Jokiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vendenis Lahu, Visar Korenica, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Yllza Hoti, Zoran Maksimoviq.

Të nderuar deputetë,

Është thirrja e fundit për të gjithë deputetët që ende nuk kanë votuar që të marrin pjesë në votim. Atëherë, siç duket e kemi edhe një deputete që do të votojë. Siç duket, të gjithë kanë votuar. Mbyllet votimi. Komisioni mund të fillojë me procesin e numërimit.

ISAK SHABANI: Atëherë, po fillojmë numërimin e fletëvotimeve.

E pavlefshme,

Ilir Bytyqi,

Bul Salihu,

Bul Salihu,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Bul Salihu,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,

Bul Salihu,

Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
E pavlefhme,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
E pavlefhme,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,  
Iir Bytyqi,

Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Bul Salihu,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
Ilir Bytyqi,  
E pavlefshme.

**KRYESUESJA:** Ia jap fjalën anëtarit të komisionit që ta paraqesë rezultatin.

**ISAK SHABANI:** Komisioni pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 1 anëtarit të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shqiptar, në seancën plenare të mbajtur më 12. 9. 2024, konstaton: votat e fituara për kandidatët e propozuar për zgjedhjen e 1 anëtarit të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shqiptar janë:

Në votim kanë marrë pjesë 80 deputetë,  
Të pavlefshme janë 4 fletëvotime,  
Ilir Bytyqi i ka fituar 71 vota,  
Bul Salihu i ka fituar 5 vota.

**KRYESUESJA:** Atëherë, në bazë të raportit të Komisionit zgjedhor konstatoj se Ilir Bytyqi zgjidhet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shqiptar me mandat 2-vjeçar.

Të nderuar deputetë, do ta marrim një pushim të shkurtër. Shihemi në orën 14:30!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Edhe një paralajmërim teknik për deputetët, pasi kemi filluar me këto pajisjet e reja. Kujdes, nuk lejohet qysh i keni ndërruar vendet më herët, për arsye se secili e ka kartelën e vet në vendin e votimit dhe nëse uleni në ulësen tjetër, edhe mund ta bëni një vepër edhe një shkelje që nuk po e dimë çfarë niveli ta kategorizojmë, po nuk është fare e mirë ashtu. Kështu që, secili në vendet tuaja. Uluni!

Të nderuar deputetë, po votojmë për praninë tonë. Votimin e shpall tash. Vetëm 38 deputetë jemi.

Kam menduar që mezi e keni pritur këtë sesion, po paska diçka jashtë më interesant po më duket. Paj po ma merr mendja, a po di. Jo, ne fuqishëm, ne pakicën.

Votojmë edhe një herë, votimi fillon tash. Qysh ia kemi nisur, me të pestën herë besoj që bëjmë diçka.

Mirë, uluni nëpër vendet tuaja. Po votojmë edhe një herë. Mirë. do të votojmë tash, ju lutem!

Po votojmë për praninë edhe një herë, të shohim nëse e kemi kuorumin për të vazhduar seancën apo jo.

Votojmë tash, regjia!

Vetëm 57 deputetë, s'kemi kuorum, vazhdojmë një ditë tjetër.

Atëherë, ju kërkohet që kartelat t'i lini në pajisjet tuaja, sepse administrata ka ende punë me to. Duhet t'i përfshijë aty identitetin tuaj dhe elementet e tjera.

Çdo të mirë e mirupafshim!

\* \* \*

*E enjte, më 26 shtator 2024*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 12 shtator 2024*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar zëvendëskryeministre,

Po e fillojmë këtë seancë. Uluni nëpër vendet tuaja, ju lutem!

Votojmë fillimisht për të parë se sa deputetë jemi të pranishëm. Përgatitemi për votim, votojmë tash!

70 deputetë janë të pranishëm, kështu që konsideroj që mund t' ju pyes saktësisht për procesverbalet.

### **1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Janë të mbledhjeve 27 qershorit dhe 11 korrikut. Nëse nuk keni vërejtje si deputetë për këto procesverbale, konstatoj që i kemi miratuar.

Tash dalim te pika e pestë:

### **5. Emërimi i shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Komisioni për Arsim i ka intervistuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emërimin e shtatë anëtarëve të këtij këshilli. Përbërja e tyre është kjo: Artan Krasniqi, Fahri Sheqiri, Besarta Reçica, Enis Salla, Zanita Halimi, Arianit Buçinca dhe Slagjana Boshkoviq.

Po ia jap fjalën kryetarit të Komisionit për Arsim, deputetit Ardian Gola. Urdhëro, zoti Gola, për raportin se çka ka vendosur komisioni.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryekuvendar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim në bazë të nenit 29, 30, 41 dhe 110 të Rregullores së Kuvendit, nenit 4.8 të Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, në mbledhjen që ka mbajtur, më 4. 7. 2024 ka intervistuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Kosovës për trashëgiminë kulturore dhe ka vendosur që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të bëjë emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për trashëgiminë kulturore në këtë përbërje: Artan Krasniqi me gjithsej 78,5 pikë; Fahri Sheqiri, 74,5 pikë; Besarta Reçica, 74,4 pikë; Enis Salla, 74 pikë; Zanita Halimi, 72,6 pikë; Arianit

Buçinca 72 pikë; Slagjana Boshkoviq 59,5 pikë. Anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore emërohen në mandat trevjeçar.

Disa informata procedurale: Më 31. 5. 2024 është shpallur konkursi për zgjedhjen e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe është mbyllur më 14. 6. 2024. dhe në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor të këtij viti po ashtu ka shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve që kanë aplikuar për anëtarë të KKTK-së dhe vlerësoi se 16 kandidatët që kanë aplikuar i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe vendosi që të njëjtit të ftohen për intervistim. Më pastaj, më 4. 7. 2024 është zhvilluar intervistimi edhe vlerësimi i kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara për poentimin e kandidatëve dhe i rekomandon Kuvendit emërimin e shtatë kandidatëve të sipërcekur për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Faleminderit!

**KRYETARI:** A e marrin fjalën grupet, apo? Vlora Dumoshi flet nga Lidhja Demokratike.

**VLORA DUMOSHI:** I nderuar kryetar!

Lidhur me anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore ne si grup parlamentar kemi konstatuar që nuk ka gjithëpërfshirje të fushave sipas kriterëve të konkursit. Shumica e kandidatëve të përzgjedhur janë sociologë, etnologë, por jo edhe historianë, që ka qenë një ndër kriteret e konkursit.

Po ashtu janë përzgjedhur militantët partiakë, siç është rasti i Fahri Sheqirit nga Qendra e Vetëvendosjes në Bardhosh. Prandaj, ne mendojmë që procesi duhet të kthehet në pikën zero, po ashtu si komision kemi pranuar tri ankesa nga kandidatët dhe asnjë ankesë nuk është shqyrtuar. Kështu që kjo është një shkelje procedurale, e cila është bërë gjatë këtij konkursi. Edhe, kërkoj që të gjithë deputetët të mos e votojnë, por ta kthejmë në pikën zero dhe ta shpallim konkursin e ri. Janë eliminuar njerëz më të mirë, të cilët i kemi të trashëgimisë kulturore me grada shkencore dhe janë pranuar militantët, kjo s' di çka të them. Është shkelje dhe nesër, pasnesër kjo lë që askush të mos konkurrojë në këto pozita profesionale.

**KRYETARI:** Armend Zemaj është lajmëruar për të diskutuar.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Mendoj që edhe Vlora i tha pothuajse të gjitha ato që unë mendova t'i them, por është e pafalshme që ky institucion i cili duhet të jetë i pavarur në fushën e trashëgimisë, jo vetëm që dëmtohet në aspektin profesional, duke larguar njerëz me grada shkencore të dëshmuar në fushën e trashëgimisë dhe kulturës, dhe tentohet të rehabilitohen ose të rehatohen militantë politikë vetëm sa për të përmbushur egon e individëve dhe të asaj që quhet dëmtim i një institucioni, i cili ka bërë punë të mirë që nga paslufta, por edhe deri më tani.



Andaj, mendoj që ky propozim duhet të tërhiqet qoftë në komision, qoftë në ministri, dhe të rikthehet në pikën zero, në kuptimin e gjithë asaj që Kosova ka nevojë ta ketë një Këshill për trashëgimi kulturore, i cili i mbron interesat e Kosovës, jo interesat e individëve dhe të grupeve të caktuara. Ne jemi në luftë politike dhe diplomatike sa i përket trashëgimisë, sidomos me shtetin serb. Andaj të dëmtohet në këtë masë dhe të tentohet të kalohet në këtë formë me njerëz, të cilët nuk u përkasin profesioneve dhe të cilët nuk mund të avancojnë trashëgiminë në Kosovë dhe ta hulumtojnë atë në gjenezën historike çfarë e ka Kosova në trashëgiminë e saj, me të vërtetë është për të ardhur keq.

Andaj, më e mira do të ishte që të jeni më të sinqertë dhe të jeni më të vendosur në këtë pikë, jo për të përmbushur atë që e thashë ndonjë premtim të vogël të ndonjë militanti politik sa për të marrë një pagë atje e për të mos bërë asnjë punë të mirë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, flet Ardian Gola.

**ARDIAN GOLA:** Faleminderit, kryekuvendar!

Kjo përbërje është reflektim i vullnetit politik të komisionit, i cili është përcaktuar për një metodë të veçantë të vlerësimit dhe të poentimit. Në vitin 2021, kur kemi zgjedhur përbërjen aktuale, në fakt, kjo tashmë që është në largim, konsensualisht krejt komisioni në mënyrë profesionale jemi marrë, ndoshta deri në 3-4 mbledhje, që ta nxjerrim një formulë, e cila është shumë e saktë dhe produkti i të cilës kemi menduar që do të reflektojë po ashtu vullnetin dhe unitetin politik të komisionit dhe ka qenë një metodë, t'ju them të drejtën, goxha e sofistikuar.

Kemi filluar me 50% intervistë, 30% me sa e mbaj mend ka qenë kualifikimet dhe 20% ka qenë përvoja. Madje, edhe te kualifikimet për 20% nuk ka mundur dikush të mbërrijë komplet 100%, nëse nuk e ka pasur doktoratën, e megjithatë, përkundër faktit që ka qenë një metodë goxha e saktë, po themi kështu, prapë në fund produkti nuk na ka kënaqur të gjithëve, kanë qenë 1 ose 2 kandidatë domethënë që secili prej anëtarëve të komisionit e ka pasur një vërejtje, ta zëmë, në njërin nga komponentët e vlerësimit. Përkundër faktit që ka qenë një metodë shumë e mirë, prapë nuk është që e kanë zgjedhur një produkt që na ka kënaqur të gjithëve si komision. Për ta efektivizuar kohën dhe për shkak se këshilli kishte nevojë për t'u pajisur me përbërjen e re të këshillit, ne vendosëm që të shkojmë vetëm me intervistim.

Edhe kjo përbërje e reflekton relativisht profesionalizimin e komisionit, por përndryshe, asnjë nuk mund të garantojmë që përbërja e përzgjedhur nga komisioni i është krejtësisht profesionale. Në raportimet që i ka pasur përbërja e këshillit që është në largim, nuk është që na ka kënaqur shumë me raportimet e tyre, sidomos deputetja Eliza Hoxha ka pasur jashtëzakonisht vërejtje, disa vërejtje kanë qenë objektivisht të qëndrueshme, ka prej vërejtjeve që kanë qenë politikisht perspektivore. Në rregull është, ama jodomosdoshmërisht kemi qenë të kënaqur me punën, e aq

më pak nuk kanë reflektuar ndoshta optimizmin që e kemi pasur qysh me fillimin e zgjedhjes së tyre.

Kështu që është e vërtetë që disa që nuk janë më, që nuk janë rizgjedhur, mund të jenë të mirë dhe, në fakt, unë besoj që janë të mirë profesionalisht, por ky komision me votë dhe me diskrecion ka konsideruar që mirë është t'u jepet shansi disa të rinjve, ashtu që disa që kanë qenë me përvojë të mos rizgjedhin dhe ata që janë me perspektivë dhe kanë një potencial, të zgjidhen dhe t'u jepet shansi. Për sa i përket gjithëpërfshirjes, nuk ka vetëm sociologë, etnologë, ka edhe arkeologë, ka edhe historianë. Domethënë, është një gjithëpërfshirje relative, s'mund të jemi gjithmonë gjithëpërfshirës në çdo aspekt.

Kështu që kjo përbërje unë mendoj që reflekton edhe në aspektin profesional nevojën e këtij këshilli për këtë përbërje dhe unë konsideroj që edhe diversiteti profesional, edhe diversiteti i përvojave të atyre nga vijnë, disa vijnë nga Universiteti i Prishtinës, disa vijnë nga Muzeu, e përbëjnë një trup që mendoj se do të jenë efektivë. Tash, sa do të jenë efektivë, prapë mbetet të shohim gjatë mandatit sa do ta realizojnë. Kështu që unë u bëj thirrje të gjithë deputetëve që këtë Këshill ta votojmë, pasi që është përbërja më e mirë e mundshme që kemi mundur të nxjerrim nga ky proces. Faleminderit!

Vetëm një sqarim për sa u përket ankesave. Le ta kuptojnë kandidatët, nuk janë komisionet funksionale, nuk është Parlamenti shërbim civil atje t'i ankoresh për njëfarë poentomi. Nuk është ky konkurs për shërbim civil. Këto janë emërimë që i bën Kuvendi, nuk mundesh ti për çdo emërim që e rekomandon për seancë të japësh sqarime çka ka ndodhur, sepse proceduralisht është e pamundur, ne nuk e kemi atë mandat si komision t'i trajtojmë ankesat, të cilat procedohen nga kandidatët e pakënaqur me vlerësimin dhe poentimin. Nuk funksionon ashtu. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fjalën, në emër të AAK-së, Besnik Tahirit.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Profesor Gola e ngriti një çështje që është një problem serioz sa i përket vlerësimit të kandidaturave që vijnë për një institucion, siç është ky institucion që po flasim, e që rolin e ka ta mbikëqyrë krejt procesin e trashëgimisë kulturore.

Ju lutem, nuk mundesh, as nuk mundet profesori Gola dhe askush prej deputetëve ta ndalë procesin e ankimimit të njerëzve, të cilët mendojnë se u janë bërë të padrejta në atë proces. Unë s'kam qenë pjesë e procesit, e dëgjova deputeten Dumoshi se çka tha, unë mendoj që as nuk i keni votat për ta kaluar, ne nuk do të marrim pjesë, as nuk do të bëjmë forum, as nuk do të marrim pjesë në këtë proces të votimit, kërkoj prej shumicës parlamentare ta shohim a janë 80

deputetë brenda, në mënyrë që t'i kalojmë marrëveshjet ndërkombëtare. Në qoftë se nuk janë, të vazhdojmë tutje, për shkak se nuk ka kurrë një logjikë të diskutojmë tash për meritat dhe, mbi të gjitha, të diskutojmë mbi atë se a ka apo nuk ka të drejtë të bëjë një kandidat ankesën kur i bëhet e padrejtë në procesin e intervistimit.

Procesi i intervistimit është i bazuar në meritë dhe në qoftë se dikush mendon që emërimi nuk është mbi bazën meritore dhe ka mundur të jetë kandidat më i mirë, e ka plotësisht të drejtën të ankohet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Keni kërkuar replikë, zoti Gola? Urdhëro!

**ARDIAN GOLA:** Me zotin Tahiri, jo, jo, absolutisht, unë nuk jam kundër ankesës, përkundrazi ata le t'i shfrytëzojnë rrugët ligjore për ankesë, por nuk ka kuptim të ankimohet procedimi i komisionit. Ata ende nuk dinë a do të votohen apo jo, ende nuk e dinë a do të kemi vota të mjaftueshme të kalojnë, a jo. Çka nëse ata nuk kalojnë?

Pra, duhet të ankimohet vendimi i seancës së Kuvendit, por jo vendimi i komisionit, pra, nuk ka asnjë kuptim. Unë nuk jam kundër, përkundrazi, e mbroj të drejtën, për atë jemi zgjedhur këtu, të garantojmë sigurinë juridike. Vetëm le të ndiqen procedurat e duhura dhe të rregullta të ankimit, jo Komisioni FunkSIONAL të merret tash me ankesa të tyre, s'ka asnjë kuptim ajo.

**KRYETARI:** Ia japim fjalën kryetarit të Grupit të LDK-së, Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, kryetar!

Thënë të drejtën, më shumë e mora fjalën ta përgëzoj zotin Gola për sinqeritetin që e pati këtu dhe nëse mund t'ia përsëris atë çka e tha: ky është vullnet politik, pra vullnet politik i Vetëvendosjes, e para.

E dyta, ka pasur tha një metodologji efikase në vitin 2021, të cilin e kemi eliminuar si Vetëvendosje, pra Vetëvendosja e ka eliminuar një metodologji efikase, për të cilën foli në detale zoti Gola. Ka pasur tha persona me përvojë dhe përgatitje akademike më të mirë, të cilët i kemi eliminuar. Pra, i ka eliminuar zoti Gola me ekipin e vet të Vetëvendosjes në komision. Pra, po e parafrazoj zotin Gola, kanë mbetur jashtë njerëz me doktorata, tha. Nuk kemi lejuar ankesën, tha, pra këto janë ato çka tha zoti Gola.

Dhe, pyetjet e mia janë: Pse duhet qenë vullnet politik i një grupi parlamentar?

Pse nuk ka gjithëpërfshirje për trashëgiminë kulturore?

Pse është eliminuar një metodologji efikase, të cilën e tha vetë që ka qenë efikase, edhe pse ka pasur disa probleme në rezultatin final? Pra, ka qenë shumë më efikase se kjo. Pse është shkuar me intervistim të drejtpërdrejtë dhe jo me metodologjinë e dakorduar nga të gjitha grupet

parlamentare, e cila ka dhënë një rezultat relativisht të mirë, sipas zotit Gola, sipas mendimit të tij shumë të mirë, dhe është kaluar me një metodologji të intervistimit të drejtpërdrejtë, ku aty është elementi i subjektivitetit, pra vlerësimi individual i personit qysh t'ia marrë mendja e vlerëson. Pse është bërë kjo? Pse kanë mbetur jashtë profesionistë të fushës, profesorë, doktorë? Pse, zoti Gola, iu ka dhënë mundësia dikujt që ju thatë, unë po ju parafrazoj juve, iu ka dhënë mundësia dikujt që është më i ri, më me pak përvojë, më me pak thirrje akademike, por i është dhënë mundësia? Pse?

Sepse, kriteret e ligjit janë ndryshe, kriteret e ligjit e përcaktojnë se personi, i cili ka përgatitje më të lartë akademike, përvojën e plotë të punës, e të tjera, e merr vlerësimin final në fund. Pra, cili është kriteri i konkursit? Pse ka pasur një konkurs nëse është dashur dikush që është më i dobët të prevalojë mbi dikë që është më i përgatitur, ka përvojë më të madhe akademike, ka përvojë më të madhe të punës etj.

Pra, ajo që tha z. Golaj, të bindë që nuk duhet të kalojë ky vendim. Ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk marrim pjesë në këtë votim, si tendencë e ndaljes së këtij procesi të dëmshëm për një institucion kaq të rëndësishëm për Kosovën. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Kundër-replikë, Gola!

**ARDIAN GOLA:** Të lutem, mos na i përzgjidhni fjalët.

Nuk thashë “vullneti politik i grupit parlamentar”, në asnjë rrethanë. Thashë “vullneti politik i komisionit”. Edhe shikojeni, tetë vota kanë qenë pro, asnjë kundër, asnjë abstenim. Aty nuk ka qenë Enis Kervan, nuk ka qenë i pranishëm. Krejt votat e opozitës kanë qenë pro procedimit për seancë. Prandaj, është vullnet politik. Si s'ke qenë? Vlora Dumoshi ka qenë në mbledhje dje.

Tash, veç diçka, është vullnet politik i deputetëve të komisionit, pavarësisht përkatësisë politike. Pse e përmenda këtë? Veç diçka edhe për përvojën. Gjashtëmbëdhjetë kandidatë që kanë aplikuar, administrata ka konsideruar që i përmbushin kriteret minimale për t'u futur në intervistim. Pra, nëse po flasim për përvojën, nuk janë futur njerëzit pa përvojë, por janë futur njerëz...

*(Ndërprerje e incizimit)*

...nuk janë larguar njerëzit me përvojë, e janë përfshirë njerëzit pa përvojë. Jo, jo. Janë përfshirë njerëz që megjithatë e kanë përvojën minimalisht të mjaftueshme, bile më tepër se sa kaq, kurse mund të kenë më pak sesa ata të tjerët. Mirëpo, ky nuk është kriteri i konkursit, kush ka më së shumti përvojë. Pra, kriteri i konkursit është kush e plotëson minimumin e viteve të përvojës së punës dhe ata kanë potencial, kanë perspektivë, vijnë nga ajo fushë, për shkak se janë në muze, e kështu me radhë. Kështu që, nuk po besoj që këtu ka ndonjë problem.

KRYETARI: Kundër-replikë, Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Pra, deputeti Golaj po i përsërit ato gabimet që i kanë bërë. Ka marrë pjesë ekipi i Vetëvendosjes dhe ka vendosur në mënyrë unilaterale, e ka prishur një traditë pozitive, i ka çuar personat me më pak përvojë përballë atyre me më shumë përvojë dhe më shumë përgatitje akademike, sepse ka thënë minimumin e kanë mbërri këta, le të shkojnë këta me minimum, jo ata me maksimum. Nuk e ka bërë gjithëpërfshirjen e fushave që duhet se e kërkon ligji dhe po thotë ju e keni fajin pse keni thënë duhet të shkojë në seancë. Sepse seanca është ajo që merr vendim final. Pra, këtu në mënyrë direkte shihet qartë çka do të thotë kapje institucionale dhe veprim me urdhër. Më vjen keq, z. Golaj, që ke dështuar! Në fakt, për Vetëvendosjen ke qenë i suksesshëm në këtë mision të shkatërrimit të këtij institucioni të pavarur.

KRYETARI: Ia jap fjalën tash Visar Korenicës.

VISAR KORENICA: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk kam ndonjë hapësirë tjetër për të marrë fjalën, por dua të ngre një shqetësim aktual. Të njëjtin shqetësim e kam ngritur edhe vitin e kaluar dhe më vjen keq që sot ministrja e Arsimit nuk është në Kuvend. Megjithatë, duhet ta dini që ka katër javë që një vajzë nuk po vijon procesin mësimor në Pejë dhe është e moshës madhore. I ka tetëmbëdhjetë vjet. Çdo të dytën ditë, të tretën ditë paraqitet në shkollë dhe përjashtohet nga drejtori Musa Nikçi. Unë nuk e kuptoj se sa e drejtë është ne të qëndrojmë këtu si deputetë, juve si kuvendar në krye të Kuvendit, po edhe vetë ministrja e Arsimit, e të mos merret me rastin, edhe t'i japë të drejtën vajzës të shkojë në shkollë. Ne e kemi këtë përgjegjësi kolektive këtu, edhe si deputetë, po edhe ju si kryetar i Kuvendit. Edhe nuk ka kuptim të vazhdohet me procesin e votimit, edhe të mos merremi, e të mos e trajtojmë këtë rast dhe t'i jepet e drejta, sikurse që kanë të gjithë fëmijët e tjerë për shkollim dhe arsimim.

Pra, i çoj mesazh të drejtpërdrejtë ministres së Arsimit të merret me rastin dhe të mos lejojë të njëjtat probleme çdo vit të na paraqiten, për një faj të cilin ne e kemi trashëguar nga dikush tjetër që e ka vendosur në fuqi një udhëzim diskriminues administrativ. Faleminderit!

KRYETARI: Unë si Kryetar i Kuvendit, pra pasi po kërkon të jem profesional, më duhet të ta tërheq vërejtjen që ishe jashtë rendit të ditës. E para.

Besoj që fushata fillon kah 6-7 janari dhe e keni gjithë kohën e mjaftueshme të ngrini të gjitha problemet.

Tash jemi për këtë Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe diskutimet janë harxhuar. Kështu që do ta vija në votim këtë pikë.

Uluni! Zini vendet tuaja!

Do të votojmë për këtë përbërje të Këshillit. E shohim nëse i merr votat apo jo.

Të nderuar deputetë,

Për përbërjen e Këshillit votojmë tash.

Vetëm 55 deputetë, me sa po e shoh, kanë marrë pjesë në votim. Nuk ka kuorum Kuvendi për të marrë këtë vendim.

Nëse doni, e përsëritim.

E përsëritim.

Uluni nëpër vendet tuaja! E përsëritim.

Përgatituni për votim! Votojmë tash!

Votojmë tash, regjia!

Vetëm 58 deputetë po marrin pjesë në votim. Nuk kemi kuorum për ta votuar këtë Këshill.

Konstatohet, pra, që kjo i mbetet një seance tjetër. Mbetet pjesë e këtyre pikave, por janë të papërfunduara. Prandaj, kurdo që ta organizojmë një seancë tjetër për t'i përfunduar ato, e votojmë edhe këtë.

Tash, të nderuar deputetë, e kemi një seri të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Kalojmë në pikën tjetër:

**6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër” ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim**

Diskutimet kanë përfunduar për këtë marrëveshje. Na nevojitet vetëm ta dimë nëse e kemi kuorumin e mjaftueshëm për votimin e saj.

Me sa po e shoh, nuk më duket që jemi 80 deputetë, por e provojmë.

Përgatituni për votim! E votojmë këtë marrëveshje ndërkombëtare.

Votojmë tash!

Vetëm 71 deputetë kanë votuar. Nga ta, 69 për. Nuk e ka kuorumin Parlamenti për ta votuar këtë marrëveshje ndërkombëtare.

Nuk besoj që edhe po të presim, do të vinin më shumë, me sa po e shoh gjendjen e pjesëmarrjes së grupeve parlamentare.

Kjo i mbetet një seance të ardhshme. Kalojmë te marrëveshja tjetër:

### **7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar si dhe na e ka rekomanduar miratimin e kësaj marrëveshjeje.

E ftoj në këtë rast ministrin e Kulturës, sepse ministri i Financave ia ka deleguar atij përgjegjësinë për ta paraqitur këtë marrëveshje para Kuvendit.

Urdhëroni, z. Çeku!

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Këtë ekspozë po e prezantoj në emër të ministrit të Financave në mungesë të tij.

Republika e Kosovës është anëtarësuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore në qershor 2009. Marrëveshja për anëtarësim është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me Ligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në FMN dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore, shpallur edhe me dekretin e dt. 30.05.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Drejtorët ekzekutivë të Bankës kanë rekomanduar që seksioni 3 i nenit 3 të po të njëjtës marrëveshjeje, i cili vë kufizim mbi huadhënien, të hiqet në tërësi nga marrëveshja. Ky rekomandim është aprovuar në parim edhe nga Bordi i Guvernatorëve të Bankës, ku përfaqësues janë ministrat e financave të shteteve anëtare.

Meqë Ligji ynë për marrëveshje ndërkombëtare kërkon që procedurat e amendamentimit të përcillen me hapa të njëjtë ligjorë, sikur hapat për lidhjen e marrëveshjes fillestare, para jush sot kemi marrëveshjen e amendamentimit, e cila duhet ratifikuar në Kuvend.

Miratimi i saj në Kuvend i lejon Qeverisë ta pranojë zyrtarisht rezolutën për ndryshimin e marrëveshjes. Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm të Kosovës me këto institucione, ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kjo ishte paraqitja e marrëveshjes nga ana e Qeverisë. Sërish më duket se nuk jemi rreth 80. Mund të jemi 72 maksimumi. E kryejmë ne procedurën tonë. E qesim në votim këtë marrëveshje.

Uluni, të nderuar deputetë!

Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar. Nuk kemi kuorum për ta miratuar këtë marrëveshje ndërkombëtare.

Kalojmë te tjetra:

## **8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin “Energjia diellore fotovoltaike në KEK – Porta Globale”**

Të nderuar deputetë,  
Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Sërish e kemi ministrin Çeku për ta prezantuar këtë marrëveshje.

Urdhëroni, z. Çeku!

**MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU:** Faleminderit, zoti kryetar!  
Edhe një herë e prezantoj ekspozenë në emër të ministrit të Financave, në mungesë të tij.

Në kuadër të përpjekjeve tona për të avancuar zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë në vend, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka negociuar dhe nënshkruar më 18 mars 2024 Marrëveshjen e kredisë me Bankën Evropiane për Investime për projektin “Energjia diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale”.



Projekti përfshin ndërtimin e një impianti fotovoltai diellor me kapacitet të instaluar deri 100 MW dhe rreth 152 GWh prodhim në vit dhe infrastrukturën përkatëse, duke përfshirë rrugët hyrëse, kabllot në terren, një transformator në rritje dhe një lidhje kablore nëntokësore me nënstacion ekzistues në TC Kosova A.

Kjo kredi nga Banka Evropiane për Investime kap vlerën prej 33 milionë eurosh, ndërsa tërë projekti vlerësohet të ketë vlerën rreth 104 milionë euro.

Për këtë projekt, vitin e kaluar veçse janë nënshkruar marrëveshjen e grantit 29 milionë euro nga KfW dhe 32 milionë euro grant nga Korniza Investive për Ballkanin Perëndimor WBIF.

Kushte e financimit të projektit janë më të favorshme se të tregut, ku Banka Evropiane ka dhënë mundësinë e zgjedhjes në mes të një norme fikse interesi 3.5 për qind dhe një norme variable interesi, e lidhur ngushtë me Euribor gjashtëmujor, e cila për momentin është pak mbi 3 për qind.

Kredia ka maturitet 25 vjet nga data e planifikuar e disbursimit, me katër vjet greis-periodhë dhe do disbursohet deri në tetë këste.

Përkritazi me dispozitat e Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, janë ndjekur të gjithë hapat ligjorë për përmbylljen e marrëveshjes ndërkombëtare, andaj ju ftoj që ta mbështetni aprovimin e këtij projektligji. Faleminderit!

**KRYETARI:** Komisioni për Buxhet, kryetari i komisionit, Armend Muja.

**ARMEND MUJA:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e ka trajtuar këtë marrëveshje në dy mbledhje të veçanta, dhe marrëveshja konsiston në zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2022-2031, dhe nënkupton financimin e projekteve për energji të ripërtëritshme. Kështu që, projekti në fjalë ka të bëjë me investimin në prodhimin e 100 mgw energji elektrike diellore nga KEK-u dhe ka vlerën 33 milionë euro. Diçka që edhe përkon me Strategjinë edhe është në kuadër të kritereve dhe të kërkesave për integrim evropian, por në anën tjetër është edhe e nevojshme.

Dhe, Komisioni për Buxhet e ka mbështetur dhe u kërkon deputetëve që ta votojnë.

**KRYETARI:** E hedhim në votim këtë marrëveshje ndërkombëtare. Uluni, zini vendet tuaja! Votojmë tash! Më fal, anuloheni votimin, sepse tash po e shoh që vonë ma kërkoi fjalën deputeti Avdullah Hoti. Dëshiron që të diskutojë për këtë marrëveshje. Ia mundësojmë. Urdhëroni, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Mendova se do ta marrin fjalën grupet parlamentare, dy grupet paraprake, prandaj u paraqita pak me vonesë.

Është e vërtetë që e kemi diskutuar në Komision për Buxhet këtë marrëveshje dhe dy marrëveshjes paraprake për hir të së vërtetës. Por, edhe tash nuk e kemi të pranishëm ministrin e Financave. Edhe në komision nuk janë dhënë sqarimet e nevojshme për këtë marrëveshje.

Ne e mbështetim, sepse kjo marrëveshje për dallim prej asaj paraprake që është 99 e sa milionë mbështetje direkte buxhetore pa asnjë nevojë për buxhetin e shtetit, kjo marrëveshje lidhet me një investim kapital. Problemi me këtë marrëveshje është që ministri i Financave në Komisionin për Buxhet nuk ka dhënë asnjë sqarim se si do të zbatohet dhe si do të menaxhohet kjo marrëveshje.

Janë 33 milionë euro kredi. Nuk është e qartë, s'kemi marrë përgjigje. Në dokumentet përcjellëse të marrëveshjes dhe në memorandumit e ligjit nuk ka asnjë sqarim, a kthehen këto mjete nga buxheti i shtetit direkt, apo nesër reflektohen në buxhetin e KEK-ut, të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Pra, a e kthejnë drejtpërdrejt qytetarët nëpërmjet tarifave më të larta të energjisë, apo kthehet nga buxheti i shtetit.

Nuk po e shoh sot praninë e ministrit të Financave për t'i dhënë këto sqarime. Ne në parim e mbështetim këtë marrëveshje, por nuk mund të shkojnë marrëveshjet ndërkombëtare pa i dhënë sqarimet e nevojshme për të gjithë deputetët në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Sidoqoftë, e hedhim votim. Përgatituni të nderuar deputetë. Votojmë tash!

Vetëm 66 deputetë votuan. Kuvendi nuk e ka kuorumin për ta kaluar këtë marrëveshje ndërkombëtare. Prandaj, kalojmë në pikën e nëntë:

### **9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor**

Në pikën e nëntë, është një lexim i dytë. Pikërisht kemi mbetur te trajtimi i amendamenteve gjatë këtij leximi të dytë, kemi mbetur në gjysmë. Nuk ka pasur kuorum pikërisht tek amendamenti i pestë. Pra, aty vazhdojmë.

Është Projektligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar. Amendamenti i pestë është paraqitur nga deputeti Visar Korenica. Nuk e ka pasur përkrahjen e Komisionit Funkcional. Por, ne si Kuvend nuk e kemi pasur po ashtu kuorumin për t'i dhënë epilog këtij amendamenti. Kështu që, po e hedh në votim edhe një herë. Votojmë tash për amendamentin pesë. Vetëm 38

deputetë po votojnë. Kështu që, nuk po e përsëris fare, sepse po duket qysh në fillim një disponim i pamjaftueshëm që të kalohet ky projektligj.

Kalojmë te pika e dhjetë:

**10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë**

Sërish e kemi një projektligj në lexim të dytë, e ky është Projektligji për zyrtarët publikë. Diskutimet për projektligjin kanë përfunduar. Janë propozuar gjithsej dy amendamente nga Komisioni FunkSIONAL. I hedhim të dyja në votim. Përgatituni, e shohim nëse kemi kuorum.

Meqenëse janë të dyja nga Komisioni FunkSIONAL, po i hedh të dyja. Përgatituni për votim, të nderuar deputetë! Zini vendet tuaja, votojmë tash. Vetëm 59 deputetë votuan për këto amendamente. E thërras në diskutim të shkurtër kryetaren e grupit parlamentar të mazhorancës.

Me sa po e kuptoj gjendjen brenda grupit të mazhorancës, së paku 3 deputetë nuk do të votojnë asgjë, asnjë projektligj, kështu që Kuvendi nuk ka kuorum për të vazhduar. E caktojmë ndonjë ditë një seancë tjetër. Me gjasë javën e ardhshme. Mirupafshim!

\* \* \*

*E enjte, më 10 tetor 2024*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 12 shtator 2024*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ne e kemi këtu rendin e ditës, të nderuar kolegë deputetë, po votojmë për prani fillimisht, të shohim se a ka kuorum Kuvendi.

Uluni nëpër vendet tuaja!

Përgatituni për votim, votojmë tash për prani.

79 deputetë janë të pranishëm.

Nëse do të flasësh dhe paraqet problem a diçka, e shikojmë, kjo sa për votim lidhur me praninë mirë është. 79 deputetë janë të pranishëm. Kështu që mund të fillojmë punën e Kuvendit.

Kryetari i Grupit të PDK-së ma ka kërkuar fjalën, urdhëro zoti Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tashmë jemi njoftuar edhe me faktet e reja për involvimin e kryeterroristit Milan Radojçiq në vendimmarrjen e Kuvendit të Kosovës.

Pra, të nderuar kolegë deputetë, u njoftuam që Milan Radojçiq, në koordinim me kryetaren e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zonjën Mimoza Kusari-Lila, e kanë përcaktuar pagën minimale në Republikën e Kosovës. Po ashtu, përmes këtij koordinimi këta dy persona kanë lënë jashtë pagës minimale kategoritë më të ndjeshme në vendin tonë, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve. Ajo çka është edhe më tragjike shkon faktin që të dytë bashkë paskan pasur edhe kandidatë të përbashkët për Gjykatën Kushtetuese, pra këtu dua t'i falënderoj një pjesë të vogël të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje që së bashku e kemi pamundësuar që kandidatin e Milanit dhe të Mimosës, tashmë personin që shërben si zëvendësministër i Drejtësisë, zotin Vigan Qorolli, ta pamundësojmë shkuarjen e tij në Gjykatën Kushtetuese si gjyqtar në këtë gjykatë.

Pra, të nderuar kolegë deputetë, sot ne e kuptojmë që kemi një rend dite përpara dhe ajo çka është më e rëndësishmja sot kërkojmë mirëkuptimin e të gjithë juve që ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës të deklarohe mi një për një për këto çështje jashtëzakonisht të rrezikshme dhe që cenojnë sigurinë kombëtare për vendin tonë. Prandaj, sot ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkojmë që pikat të cilat janë të përcaktuara të shtyhen për një seancë

tjetër dhe të diskutojmë për secilën pikë për involvimin e Milan Radojçiqit në vendimmarrjen e Kuvendit të Kosovës.

Pra, ky Kuvend është kontaminuar dhe është kriminalizuar aq shumë sa që nuk e meriton të vazhdojë. Pra, personi i cili mund ta ketë vrarë direkt Afrim Bunjakun, apo njëri nga ushtarët e tij, na e ka përcaktuar vendimmarrjen në Kuvendin e Kosovës. Pra, edhe një herë, mos harroni, personi i cili e ka vrarë direkt Afrim Bunjakun apo njëri nga ushtarët e tij na e ka përcaktuar vendimmarrjen në Kuvendin e Kosovës. Pra, sot kjo shtëpia jonë, ky vendi jonë i punës në të cilën jemi është kontaminuar dhe është kriminalizuar aq shumë sa që nuk ka çështje më të rëndësishme që duhet të diskutohet se sa pikërisht kjo pikë. Pra, ku po doni më tragjike se sa Milan Radojçiqi të ketë edhe kandidatë nga radhët e shqiptarëve për Gjykatën Kushtetuese. Po qysh mund të tejkalohet kjo çështje?

Kryetar i Kuvendit, kërkoj nga ana juaj që të na e mundësoni një debat të tillë. Nuk kom proceduar mocion përmbajtjesor për faktin sepse e di që e mbivotoni, nuk kam proceduar një çështje të tillë, ne kërkojmë kemi precedentë edhe nga herët e kaluara ku çështjet e tilla me dakordim i kemi vendosur në rend dite, siç ka qenë çështja e dialogut, pa proceduar fare mocion e kemi vendosur në rend të ditës. Kur cenohet siguria kombëtare e vendit tonë, nuk ka çështje më të rëndësishme që mund të diskutojë ky Kuvend. Prandaj, dhe për fund, po e them, ju e patë edhe deklarin e zonjës Mimoza Kusari, pra para dy vjetëve që na e rifreskuan dje, ku e akuzoi Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike që e solli në Kuvend Listën serbe për të votuar.

Pra, Mimoza Kusari-Lila, kjo zonjë së bashku me Milan Radojçiqin na e kanë përcaktuar agjendën e Kuvendit të Kosovës. Unë i kërkoj kësaj që të dalë dhe t'i kërkojë falje Grupit Parlamentar për këtë gënjeshtëri, është e papranueshme të dalë dhe të gënjesh, Mimosë, t'ia ngjitësh një të pavërtetë Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që e kemi sjellë Listën serbe në Kuvend dhe kur i shohim qartë bisedat e tua pikërisht me Milanin.

Pra, unë të kërkoj sot të dalësh dhe t'i kërkojë falje grupit tonë parlamentar. Po i them edhe një çështje Lëvizjes Vetëvendosje, në asnjë rrethanë, në asnjë çështje nuk do të bashkëpunojmë dhe as nuk do të votojmë as marrëveshjet ndërkombëtare dhe as çështjet e tjera përderisa e keni në krye të grupit një person, i cili e ka kontaminuar këtë Kuvend. Kurrë njollë më të zezë në historinë e Kosovës nuk do të ketë se sa involvimin e një kryeterroristi, i cili ka vrarë policë të Kosovës, në vendimmarrjen e Kuvendit të Kosovës.

Kryetar, kërkoj që sot rendi i ditës të zhvendoset dhe të vendoset pikërisht për debat një çështje: Ndikimi i Milan Radojçiqit në vendimmarrjen e Kuvendit të Kosovës. Pra, cilat janë çështjet dhe cilat janë temat të cilat këta janë dakorduar dhe cilat janë kërkesat të cilat i janë plotësuar Milan Radojçiqit nga Lëvizja Vetëvendosje dhe nga Mimoza Kusari-Lila. Faleminderit!

KRYETARI: Debat të bëjmë nuk kemi mundësi, sepse nuk na lejojnë procedurat, i vetmi kompromis që mund ta bëjmë në këtë Kuvend, urdhëro? Sa i përket sqarimit do t'ua jap mundësinë vetëm grupeve parlamentare të deklarohen, e nëse doni debat duhet, për besë, t'i ndiqni procedurat. Është problem kështu, prej një rendi për të cilin jemi pajtuar në Kryesi, ta devijojmë krejt çështjen.

Por, nëse doni, i vetmi kompromis që mund ta bëjmë këtu në seancë është që seanca ta përcaktojë nëse do debat apo jo. Unë si kryetar nuk e kam atë kompetencë, kështu edhe i shkel ligjet e Republikës së Kosovës e nuk po dua ashtu, është e padrejtë. Kështu që grupet parlamentare, mazhoranca, a do të flasë a jo? A LDK-ja? Mazhoranca?

Mimoza Kusari-Lila në emër të mazhorancës.

MIMOZA KUSARI-LILA: Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës dhe ju media,

Në fakt, për keqardhje është të dëgjosh në Kuvendin e Kosovës jo vetëm shpifje, fabrikim, por gjithashtu edhe nxitje e cytje për urrejtje edhe linçim. Tash ajo çka unë dua ta them është që këtu duhet të jetë një ose dy argumente kryesore, të cilat Grupi Parlamentar i PDK-së i ka në këtë hall për këtë debat.

E para është, Abelard, se në asnjë formë ose mënyrë nuk po mund t'i pasqyroni ose t'i atribuoni bashkëpunimin që e keni pasur ju me Listën serbe e ta barazoni, prandaj po duhet të shkoni me shpifje e falsifikime, kjo është e para. Ndërsa, e dyta ka të bëjë me faktin që aq shumë po ju mungojnë pse s'janë këtu prezentë që 28 muaj, 28 muaj me Qeverinë Kurti, e me këtë pozitë Lista serbe nuk është në Kuvend. Kuvendi po funksionon, ndërsa ju në pamundësi për t'i pasur ata t'ju ndihmojnë, duhet fabrikuar, dhe çka bëni? I thirrni bashkëpunëtorët, bashkëpronarët e Milan Radojçiqit e të tjerëve për t'iu fabrikuar materialet që ju duheni t'i publikoni, e disi t'i sillni ata këtu. A e dini ju që Slavko Simiq prej kohës, prej qershorit 2022 nuk është ulur në këto ulëse? A e dini ju që Milan Radojçiq në Qeverinë Kurti është i përndjekur prej Interpolit, prej Kosovës, e natyrisht ai shans nuk ka të kthehet në Kosovë, asnjëherë më, vetëm duarlidhur.

Tash, kur po flisni për këto bashkëpunime, më lejoni t'ju rikujtoj memorien pak. Time, pjesa e qeverisë të cilën ke qenë ti, ka qëndruar këtu në Kuvend 7 orë, e ka pritur Listën serbe të vijë prej Beogradit e t'i japë votat që Ramush Haradinaj të bëhej kryeministër, a të kujtohet? Si ke votuar në orët e vona të shtatorit të vitit 2017 për të ardhur Vuçiqi e ta lejojë Ramushin të bëhej kryeministër. Po kjo s'ka ndodhur me Kryeministrin Kurti, po më vjen shumë keq. A ju kujtohet shumë mirë bashkëpunimi e përrurimi i shtëpisë, dëgjoni kjo çka ka dalë dje është fabrikim i plotë, imagjinoni kur të dalin fotot e përrurimit të shtëpisë së Radojçiqit, imagjinojeni kur të dalin dhuratat për fëmijët e Radojçiqit, nga zyrtarë e nga udhëheqës, imagjinojeni kur dalin kush e ka vizituar e kush ka pasur biznese. E juve po ju them, votimi në lexim të parë i Ligjit për pagën minimale ka ndodhur në maj të vitit 2022, ju keni dalë jashtë, Lista serbe ka hyrë brenda.

Pyetja e vetme që i kam bërë Listës serbe është: pse jeni këtu? Pse jeni këtu?! Thanë “është interes për ne”. Asnjë bisedë s’ka qenë me Listën serbe për atë ligj, nën një. Nën dy, ai ligj është votuar në korrik të vitit 2023 kur ka hyrë në fuqi. As edhe një rritje nuk u keni bërë veteranëve sa keni qenë në pushtet. 12 vjet keni qenë në pushtet, keni abuzuar me atë emër, keni marrë fitimin maksimal si milionerë, veteranët me pagën minimale, në rregull është. Milionerë, a jeni ju mirë? Veteranët i latë me pagën minimale, e bisedojmë atë, hiç pa problem. Milionët kur keni shkuar t’i bisedoni me kryetarët e Listës serbe në Veri, me kompanitë e zyrtarëve tuaj, e deputetëve tuaj, kur keni shkuar t’i merrni me përmbarrim, në çfarë gjuhe i keni biseduar? Një kompani në pronësi “Lirigzoni” e deputetit tuaj, zotit Haxhiu, ku është? Mbi 2 milionë euro tërheq me para të drejtpërdrejta të punëve në Veri, çka po jua merr mendja juve, a po kujtoni që këto veç si fakte mund të gjuhen lart e poshtë.

Lista serbe nuk ka as edhe një ndikim të vetëm në Kuvendin e Kosovës prej qershorit të vitit 2022. Ajo bisedë dje është tërësisht e fabrikuar, sot është rasti në Polici dhe do të vazhdojë të jetë në polici, do të kërkojmë super-ekspertizë, e atëherë ju veç duhet të përgjigjeni për një gjë, ju duhet të përgjigjeni se si është e mundur që koordinimi për këto materiale po bëhet përmes zyrtarëve tuaj? Kur del ky informacion, atëherë hajde e kërkon i llogari prej tjetërkujt. Me Listën serbe, të votohet qeveria dhe të mos ketë mundësi të shkarkohet, po tash duhet krijuar dikujt incizime që duhet thënë që “kjo qeveri shkon në shtëpi”. Fatkeqësia juaj është që veç po ia rritni kredibilitetin qeverisë edhe mundësisë për fitore tjetër të pakontestueshme. Ajo çka jeni duke provuar të bëni, linçimi, sulme të ulëta, ato do të shkojnë bashkë me ju ashtu qysh do të shkoni me zgjedhjet e 9 shkurtit, se asnjë mundësi tjetër nuk e keni të bëni.

Gjithashtu veç edhe një informatë, kush po mundohet t’ia pastrojë personalitetin Radojçiqit dhe Simiqit, të gabuar e të humbur jeni. Fatkeqësi që Slavko Simiqit në televizione nacionale në primetime i jepet mundësia dhe argumentet e tij merren më të forta se të deputetes së Kuvendit të Kosovës, edhe mundësisë që i kemi këtu për të diskutuar e debatuar, është e turpshme. Por, gjithsesi unë e kuptoj, për arsye se janë para të mëdha në pyetje, e ju e dini sa. Secili prej jush e dini sa. Për cilat para jemi duke folur tash aktualisht që qoftë në studio televizive, përmes atyre analistëve apo përmes bizneseve tuaja, shumë po më vjen keq. Ju mund të mos votoni asgjë, krejt është çështje juaj, absolutisht jo, veç fatkeqësisht po tregoni që pa Listën serbe s’po mund të funksiononi ju, jo ne.

**KRYETARI:** Lidhja Demokratike, ju lutem. Së pari grupet, Bekim, pastaj replikat. Urdhëro, Lidhja Demokratike me radhë.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!  
Të nderuar kolegë deputetë,

Është për keqardhje se ku ka mbërritur debati publik në Kosovë. Debati publik në Kosovë sot ka mbërritur në pikën e degjenerimit të vet, se sa është i përfshirë terroristi Milan Radojçiq në Qeverinë dhe Parlamentin e Kosovës.

Kjo është fatkeqësi për Kosovën, fatkeqësi e cila e dëmton sakrificën e secilit qytetar të Kosovës. E dëmton besimin e secilit qytetar të Kosovës, sot çka po dëgjojmë këtu dhe ajo çka pamë dje është në vazhden e logjikës të cilën Lëvizja Vetëvendosje e ka ndërtuar i logjikë e përbaltjes, duke qenë vetë e zhytur deri në fyt, deri në fyt me kriminelet si Milan Radojçiq. Ky është tmerri i demokracisë në Kosovë. Ky është tmerri i përfaqësimit në Kosovë. Çfarë përfaqësimi është ky? Çka përfaqësojnë këta deputetë kur kryetarja e grupit të tyre parlamentar del e akuzon para e prapa, anash, djathtas-majtas, shtyn në të gjithë anët e këta entuziasmohen. Çka është ky entuziazëm? Kush e për çka po gëzohet? Po gëzoheni se kush është më tradhtar se tjetri. Po gëzoheni se kush i ka shërbyer Serbisë më shumë se tjetri. Çka po gëzoheni? Çka po duartrokisni? Kush kujt po i duartroket këtu?

Ai është një terrorist, i cili ka kryer akt terrorist ndaj shtetit të Kosovës. Ai terrorist ka vrarë një polic të Republikës së Kosovës. Ju dilni këtu sot dhe pa pikën e pafytyrësisë mburreni. Të njëjtat deklarata i kemi parë këtu në këtë Kuvend. Të them të drejtën, unë i kam marrë me rezerva. E kam parë me rezerva edhe Partinë Demokratike të Kosovës kur doli Mimoza Kusari-Lila edhe në Parlament edhe në konferencë për media, tha ju u koordinuat që ata të vijnë në sallë e të na dëmtojnë imazhin neve. Ishte çudi për mua. Thashë, ndoshta është ashtu. Kur dalin përgjimet, janë komplet e kundërta. Komplet e kundërta del. Dëgjohet duke folur në telefon, duke i thënë eja voto.

Çka është kjo punë? Çka është kjo sjellje? Është e kuptueshme që grupet politike në Parlament duhet të komunikojnë mes vete, duhet të koordinohen mes vete, po jo të koordinohen me kriminelë. Jo të dilet e të akuzosh tjetrin kur je vetë duke u koordinuar. Çka është kjo sjellje? Çka i shërben kjo sjellje qytetarëve të Kosovës? Çka i shërben? Zonë krimi u bë Kuvendi i Kosovës, zonë krimi. Pse? Sepse mentaliteti që është ndërtuar në këtë qeverisje, është i gabuar. Është i gabuar.

Interesi i Kosovës nuk është ky. Nuk është interesi i Kosovës të koordinohet me Milan Radojçiqin. Terrorist, në kërkim ndërkombëtar prej Kosovës. Person i përfshirë në aktivitet terrorist, në listë të zezë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në kohën kur jeni koordinuar me ta, ka qenë në listë të zezë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe i kërkuar ndërkombëtarisht nga institucionet e Kosovës. Pse duhet të flitet me të? Pse duhet të flitet me të, kjo është pyetja.

Pse Lëvizja Vetëvendosje duhet të flasë me të? Çka përfaqëson Lëvizja Vetëvendosje në këtë rast? Cilat janë vlerat që përfaqësohen? Cilat janë vlerat institucionale? Cilat janë vlerat



demokratike? Cilat janë vlerat kombëtare? Cilat janë? Ejani t'i flasim cilat janë... ejani të diskutojmë cilat janë vlerat? Apo janë vlerat e rreme... apo janë vlerat e shpifjeve?

Pra, vlerat e demokracisë, vlerat e institucionalizimit, vlerat e patriotizmit, vlerat e shtetbërjes, ato janë vlerat që përfaqësojmë ne këtu, jo vlerat e rrugaçerisë, jo vlerat e këtij rrugaçi që flet këtu pas shpine. Cila është vlera e këtij rrugaçi? Vlerat e pafytyrësisë. Këtu duhet të përfaqësohet institucionalizimi, këtu duhet të përfaqësohet patriotizmi, këtu duhet të përfaqësohet shteti i Kosovës, këtu duhet të përfaqësohen interesat e shtetit të Kosovës. Jo kjo gjuhë këtu, jo kjo sjellje këtu.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Prandaj, po shkojmë atje ku nuk duhet të shkohet. Është fatkeqësi. Është fatkeqësi për Kosovën që sot kemi një turmë entuziastësh që duartrokasin në fatkeqësi kombëtare. Koordinimi me një terrorist është fatkeqësi kombëtare, në rastin më të lehtë, nëse jo koordinim për tradhti kombëtare. Dhe nuk duhet t'i duartrokitet një fatkeqësie kombëtare.

Me këtë fjalë po e mbyll fjalimin tim, me keqardhjen më të thellë të një entuziazmi primitiv mbi një fatkeqësi nacionale të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Aleanca, a flet? Kryetari i Grupit flet në emër të Aleancës, Besnik Tahiri.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të respektuar deputetë,

Sot në Kuvendin e Kosovës kemi një kërkesë konkrete, e cila na obligon neve deputetëve të zgjedhur të popullit të Kosovës që të kërkojmë një ballafaqim me Qeverinë, na obligon që të kërkojmë një transparencë rreth një përgjimi, i cili ka shpërfaqur në publik tri çështje të cilat meritojnë përgjigje në këtë Kuvend.

Ky Kuvend, qytetarët e Republikës së Kosovës meritojnë dhe duhet ta dinë për çfarë kushtesh është negociuar me kryekriminelin, me terroristin, me iniciuesin e sulmit ndaj shtetit, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, ndaj njeriut, i cili është në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ndaj personi që akuzohet drejtpërdrejt nga rendi ynë kushtetues, nga gjykatat tona, si urdhëruesi, udhëheqësi i sulmit terrorist dhe ai i cili është përgjegjësi për vrasjen e heroit të kombit Afrim Bunjakut.

Ky Kuvend i Republikës së Kosovës duhet të informohet se cili ka qenë pazari i këtij negociimi. Aty nuk flitet për ligje që kanë të bëjnë me komunitete. Aty nuk flitet për çështje të cilat pajtohen në Kuvend në raport me dy të tretat.

Të nderuar deputetë,

Aty diskutohet për një ligj, i cili prek secilin njeri të këtij vendi, për pagën minimale dhe shihet qartë se aty ka qenë në kushtëzim, në pazar rreth largimit të vlerës më të madhe tonë kombëtare, luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne duhet ta dimë, që ta kemi transparencën e plotë në këtë Kuvend, se ky koordinim a është një thikë pas shpine ndaj demokracisë në Kosovë? Pse po e them këtë? Po e them se që nga nisja e kësaj legjislature, neve na është thënë këtu, deputetë, se nuk ka koalicion me Listën serbe. Na është thënë se nuk ka asnjë marrëveshje me ta. Bile-bile, kjo është thënë me mburrje. Përgjimet, i pari dhe i dyti, vërtetojnë se një marrëveshje e thellë dhe në thelb kundër disa vlerave që lidhen drejtpërdrejt me të mirën publike, me të mirën e qytetarëve të Kosovës, kanë ndodhur. Ndaj, duhet të debatohet këtu nga ne, edhe nga ju deputetë të shumicës parlamentare.

Kjo Qeveri nuk ka etikë politike. Po të kishte etikë politike, sot ishte dashur të flitet që Ushtria e Kosovës është pa ushqim, që ushtarët tanë shkojnë atje e bëjnë ushqimin. Po të kishte etikë, do të duhej të dorëhiqet dikush, për faktin se është duke u vjedhur me të madhe dhe Prokuroria në asnjë moment nuk po ndalet ndaj kabinetit qeverisës. Po të kishte një etikë politike, do ta diskutonim pushtimin ekonomik që Serbia e bëri me një vendim të kësaj Qeverie. Këto do të ishin çështjet që duhet t'i diskutojmë.

I drejtohem znj. Kusari-Lila. Nuk duhet në asnjë moment tëndin të vendosesh argument i cili nuk qëndron, për shkak se mashtrimi dhe rrena luftohen vetëm me të vërtetën. E të vërtetën e di ky popull kush është Ramush Haradinaj, cili është kontributi i tij në luftë e në liri, e në Marrëveshjen e Brukselit e të Ohrit, e të secilës pore të jetës, dhe e di kush je ti. Po nuk mund të vish këtu e të na shesësh moral për atë temë.

Ajo çka ne po ne kërkojmë si shumicë parlamentare, është e thjeshtë, ballafaqim, transparencë, llogaridhënie, për një pazar dhe një kushtëzim të cilin ne duam ta elaborojmë. Mashtrimi luftohet me të vërtetën. Në doni të vërtetën, hape seancën! Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Prej Grupit të të Pavarurve e ka kërkuar fjalën Haki Abazi dhe pastaj vazhdojmë me replika dhe e mbyllim këtë.

**HAKI ABAZI:** A po më dëgjoni?

Nuk e di a më ka ndenjtur më mirë ndonjëherë përshkrimi a mbiemri "i pavarur". Nuk kisha dashur për asnjë sekondë t'i takoj një grupi parlamentar sikur që është ky, për të cilin kam thënë para dy vjetësh që janë pazaret e pista, pazaret e pista për të hapur pompa të benzinës, për të futur familjarë në punë, për të futur njerëz të afërt nëpër Gjykatë Kushtetuese, për t'i bërë

anëtarët e bordeve të drejtorëve, për interesa të vogla të cilat Lëvizja Vetëvendosje i ka kritikuar pushtetet e kaluara.

I ka prishur punët me Haki Abazin, i ka prishur punët me Eman Rrahmanin, me Visar Korenicën, me Fatmir Humollin, me të gjithë për të shkuar të kërkojë vota prej Listës serbe, prej Radojçiqit. Edhe qe po del. Le që ka kërkuar vota, i ka pranuar në zyrë, ata të cilët e kanë vrarë Bunjakun, oficerin tonë, e pa turp kryetarja e shefit shkon te varri i Bunjakut të bëjë nderime. Ky është turp. Nuk ka moral më të ulët, e më të poshtër, kur përgatit skenar, u jep tender kompanive kriminale të Radojçiqit, edhe në fund shkon i qan familjarët e policëve të vrarë atje. Turp! Për pompa të benzinës, për punësim të familjarëve, për borde të drejtorëve të ndërmarrjeve publike këta janë të heshtur. Kjo shumicë e cila u ka garantuar qytetarëve ndryshim përmbajtjesor, transformues në zgjedhjet e fundit. Këta janë të heshtur se nuk guxojnë ta çelin gojën, se u tregojnë qysh i kanë vjedhur pulat nëpër komunat e tyre ku kanë shitur. Se tregojnë qysh kanë bërë pompa të benzinës pa leje, sepse i kanë motrat nëpër institucione ku marrin vendime. Turp!

Nuk guxon ta lejoni debatin parlamentar demokratik të tregoni që ka rënë standardi i kësaj demokracie në zero. Është turp kur në emisionin e parë thotë nuk e di Albin Kurti që kam folur me Radojçiqin, ndërsa dalin incizimet të cilat tregojnë për koordinim të plotë për të marrë votat e Listës serbe për të hequr veteranët dhe të diskriminohen kategoritë e ndryshme. Të flitet për orën e Abelard Tahirit me serbë. Ata të cilët natë e ditë punojnë ta rrënojnë shtetësinë dhe demokracinë e vendit. Nuk e kuptoj ku e ka atë fytyrë të dalë dhe të flasë. Ky është rrezik për shtetin. Ky standard i bie që ne nuk kemi shtet. Ky standard tregon që nuk kemi Prokurori, e cila më merr mua në pyetje për ekspozimin e humbjes së mostrave të Astrit Deharit, ndërsa nuk e merr në pyetje dhe nuk e burgos njeriun i cili flet, me njeri që ka aktakuzë të ngritur për rrezikim të sigurisë kombëtare. Është turp ku kemi arritur.

Nuk e di cili prej këtyre deputetëve ka fytyrë të shkojë të kërkojë votën te qytetarët më, duke u thënë që ata të tjerët kanë bërë keq për pesëmbëdhjetë vjet, ka përfunduar ajo storie. Secili qytetar e di që katërvjetëshi është i pari që një legjislacion e ka përfunduar deri në fund, dhe rezultatet janë zero. Rezultatet janë postime të Facebook, lule të freskëta të Holandës nëpër varreza për ta prekur empatinë e qytetarëve. Por, në përmbajtje jeni zero në secilin sektor, përfshirë edhe në tradhtinë e vendit me këto marrëveshjet që i keni bërë me Listën Serbe. Turp!

**KRYETARI:** Tash i kemi edhe dy replika. Ia japim fjalën z. Tahiri, në fillim e ka kërkuar. Kryetari i grupit ka përparësi.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Po ia them znj. Kusari-Lila që s'ka akt patriotik më të madh në Kosovë sesa ta demaskosh një komunikim me një terrorist, siç është Milan Radojçiq. Sot, nëse kishim pasur një presidente në nivel të detyrës, dy gazetarëve, Berat Buzhala dhe Vehbi Kajtazi, që i kanë bërë këto publikime,

duhet dhënë Medalje Presidenciale. Ju edhe qeshni, sepse këta janë vazhdimësi në sulm të gazetarëve. Pra, dertin e kanë te gazetarët, të publikimet, të opozita. Që ta fshehin koordinimin me kryeterroristin, i cili e ka vrarë Afrim Bunjakun, e i cili na e ka përcaktuar vendimmarrjen në këtë Kuvend, e i cili na e ka përcaktuar edhe pagën minimale, e i cili ka pasur kandidatë edhe për Gjykatë Kushtetuese, këta janë të gatshëm të bëjnë gjithçka, vetëm e vetëm ta mbyllin disi.

E sulmon gazetarin. E sulmon politikanin. E sulmon opozitën. E sulmon shoqërinë civile, sepse duhet të përmbillet ky debat. Prandaj, nuk ka akt më të madh patriotik sesa të demaskohet komunikimi me kryeterroristin Milan Radojçiq.

Kryetari i Kuvendit e tha që nuk mund të tolerohet një debat i tillë për shkak të Rregullores. Por, a e ka bërë komunikimin kjo bazuar në Rregullore, me Milan Radojçiqin? A i ka shkelur ligjet e Kosovës? A e ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës në kontakt me Milan Radojçiqin?

Të mos e reduktosh në këtë formë këtë çështje kaq të rëndësishme. Kurrë njollë më të zeze ky Kuvend nuk do të ketë sesa ky komunikim që ka ndodhur dhe ky diktim i votimit në Kuvendin e Kosovës, prej Milanit e prej Mimosës. Kurrë!

Edhe nëse 200 vjet i kemi ymër që të rrojmë, kurrë nuk do të ketë njollë më të zeze.

**KRYETARI:** Po! Abelard Tahiri, ju lutem edhe një minutë!

**ABELARD TAHIRI:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

Unë kërkoj prej jush që ta lejoni këtë debat, ose së paku ta nxirrni në votim kërkesën e Partisë Demokratike, e cila është mjaft e qartë, komunikimin e Mimoza Kusarit me Milan Radojçiqin, koordinimin, dhe cilat janë ato kërkesa të Milan Radojçiqit që Qeveria Kurti dhe mazhoranca e Lëvizjes Vetëvendosje i ka plotësuar në këmbim të votës për përcaktimin e pagës minimale. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kjo ishte replika. Tash replika e zotit Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

**KRYETARI:** Ty Time nuk të është përmendur emri.

**BEKIM HAXHIU:** Unë dje kam kërkuar që Kuvendi i Kosovës t'ia marrë mandatin Mimoza Kusari-Lilës për shkak të bashkëpunimit të saj me Radojçiqin.

Sot, jam edhe më shumë i bindur kur kjo është në gjendje që një kompani “Lirigzoni kompani”, që kurrë në jetën time s’kam qenë, as nuk jam pronar, as i “Lirigzonit”, e asnjë tjetre, e cila ka qenë kundërshtarë me kompaninë “Rade” të Radojçiqit.

Radojçiqi me grupet e tij ia ka djegur kamionët “Lirigzonit”. Ia ka djegur buldozerët. E kanë sulmuar me armë “Lirigzonin”. E kanë sulmuar te ura e Ibrit “Lirigzoni kompani”, dhe kjo është në gjendje ta bëjë bashkë, kundërshtarin, ata që kanë luftuar i bën bashkëpunëtorë. Kjo është fëlliqësia e Mimoza Kusari-Lilës, që ta shpëtojë veten.

Kjo është në gjendje që ta akuzojë edhe UÇK-në që ka bashkëpunuar me Serbinë për të luftuar. Kjo është logjika e kësaj që s’e meriton të jetë deputete, sepse e fëlliq edhe mandatin e deputetit. Kjo s’meriton të jetë këtu.

**KRYETARI:** Kujdes fjalorin, deputet!

**BEKIM HAXHIU:** Kjo është më e rëndë se të të akuzojnë, pa qenë kurrë pronar. Pa qenë kurrë bashkëpunëtor. Por, të jesh luftëtar kundër Serbisë dhe t’i bësh luftëtarët ata që kanë qenë kundërshtarë t’i bësh bashkë, kjo është fytyra e vërtetë e Mimoza Kusarit-Lilës.

“Lirigzoni kompani” ka pasur punë me institucionet e Kosovës dhe është sulmuar nga bandat e Radojçiqit në veri. Dhe, shikojeni se çfarë të pavërtete flet. Hyni në google dhe kërkoni se si është sulmuar “Lirigzoni kompani” te lumi Ibër.

Si është sulmuar “Lirigzoni kompani” në pjesën veriore nga bandat e Radojçiqit dhe ju i duartrokisni kësaj pafytyrësie. Dhe, ju doni që ta bëni bashkë luftëtarin me bashkëpunëtorin. Jo zonjë, jeni bashkëpunëtoresh në krim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Time, a je e sigurt që të është përmendur emri? Kush ia ka përmendur? Mimoza i është drejtuar Times. Urdhëro Time, dy minuta!

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Mimoza Kusari, unë jam Time Kadrijaj. Dhe, ajo që e mbaj me mburrje, jam ushtarë e lirisë. Ramush Haradinaj është gjeneral. Familje emblematike. E ti çka je? Unë ty do të mbaj në mend si “zemljake” e Radojçiqit, po edhe si valltare e Gadafit.

**KRYETARI:** Kujdes fjalorin për kolegen, Time! Kundër-replikë? Një minutë, pra!

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Të nderuar kolegë deputetë,

E keni vendosur që ta çoni mbrapsht fundin në përmbyllje të një legjislature të suksesshme goxha, besoj. Me argumentim tuaj që sot para kësaj foltoreje të Kuvendit u besoni më shumë fabrikimeve të Slavko Simiqit sesa deklarimeve tona, ose deklaramit tim në këtë rast, si e para.

Si e dyta, tradhti kombëtare ka qenë t'i marrësh votat e Listës serbe që të themelohet Gjykata Speciale, që të dënohet UÇK-ja atje. Ju lutem, shikojini votimet e secilit, e emrat tuaj kush e ka votuar Gjykatën Speciale dhe në çfarë forme keni komunikuar me Listën serbe për Gjykatën Speciale.

Tradhti kombëtare është të diskutohet me Listën serbe, me Beogradin, shkëmbimi territorial. T'i merret tokë Kosovës për ta marrë një marrëveshje paqësore.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Mirëpo, nëse ka mundësi ta përmbyllni, se po votojmë tash.

MIMOZA KUSARI-LILA: Tradhti kombëtare nuk është të ndiqet Radojçiqi, të largohet prej Kosovës, e për 28 muaj ky Kuvend të funksionojë pa asnjë ndihmë e pa asnjë prezencë të tyre. Por, në fakt, kjo mungesë e tyre duket se po ju vë në siklet, e medoemos po doni t'i lidhni të dyja, por nuk bën. Lëvizja Vetëvendosje ju ka treguar që mundet pa Listën serbe, që vendosja e Qeverisë dhe kriminelët e kanë vendin atje ku duhet, në burg dhe të ikur në Serbi.

Kur të vini me argumentime se pse 28 muaj ata nuk janë këtu, mund të bëjmë debat. Këto të tjerat janë pallavra, të cilat mundoheni ju ta përmbyllni seancën në mënyrën e njëjtë qysh e keni filluar. Nuk u ka ndezur vjet, po mundoheni sivjet. E kotë është. Të humbur jeni. Të mbaruar jeni. E kur të vini, veç një premtim mund t'ua bëni qytetarëve, t'u thoni: ne me Listën serbe në mandatin tjetër. Jo, jo, nuk mundeni dhe s'do t'i sillni më që ata të jenë këtu vendimmarrës. Ka mbaruar bashkë me juve. Faleminderit!

KRYETARI: E hedhim në votim. Dëgjo! Edhe sikur të dua unë të vendos, s'mundem si kryetar i Kuvendit që krye më vete të caktoj debate kështu pa rend të ditës. Nuk është rregull. Kështu që, e hefhim bë votim. Uluni! Zini vendet tuaja! Seanca vendos, ajo e sqaron situatën. Një kundër-replikë! Urdhëro, zoti Gashi para se të votojmë!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë personalisht nuk shquhem si person që i personalizoj gjërat.

KRYETARI: Qetësi!

ARBEN GASHI: Ajo që duhet thënë zonjës Kusari-Lila, është: kur nuk janë rritur pensionet e veteranëve të luftës ka qenë ulur si zëvendëskryeministre. Kur ka folur me Radojçiqin ka qenë e ulur si kryetare e grupit parlamentar. Kur është ulur në darkë me PDK-në për ta shpërndarë Kuvendin, ka qenë e ulur si kryetare e grupit parlamentar. A i ka ditur ato gjëra që po ua thotë sot.

Kur është pritur shtatë orë që vijë Lista serbe për ta votuar qeverinë ka qenë e ulur me neve këtu prapa. Bashkë kemi protestuar. Ndoshta është ky i vetmi moment i lavdishëm i saj. Por, po më vjen keq se ku shkon kufiri i pafytyrësisë së saj. Pra, patriotizmi dhe atdhedashuria janë mbi të gjitha. Faleminderit!

KRYETARI: Besnik, çka ishte kjo. Po do replikë, apo çka? Megjithëse s'të është përmendur emri.

BESNIK TAHIRI: Këtu shihet shumë qartë që po shpërfaqet një fshehtësi. Popullit të Kosovës është duke iu fshehur diçka. Ky Kuvend duhet të diskutojë për kushtet që dëgjohen në telefon. Duhet të diskutojë për koordinimin joformal, parapolitik. Ky Kuvend duhet të ballafaqohet, të shohim se e kujt është e vërteta. Këtë mashtrim duhet shpërfaqur vetëm me të vërtetën.

Duhet ta dimë se çka kanë qenë ato kushte. A kuptoni? Nuk mund veç ta lëshojmë, të shkojmë në votim pa e diskutuar këtë temë që është e rëndësishme. Në qoftë se nuk bëhet, duhet ta bëjmë këtë me seancë të jashtëzakonshme, me 40 nënshkrime.

KRYETARI: Po, ajo është më e lehta. Ashtu shkohet, procedurë e rregullt. Ashtu ka mundësi. Ndërkaq, s'ka mundësi veç pse një mëngjes po na kujtohet edhe duam të bëjmë debat të caktuar pa rend. E hedhim në votim. Uluni nëpër vendet tuaja!

Votojmë tash për debat se a duhet të mbahet.

Atëherë, mirë edhe nënkryetari Shala me siguri është pa kartelë, por po voton me dorë. E ka të drejtën e tij. Njëjtë po voton edhe Luan Aliu, apo? Dy janë pa kartela, kështu që për debatin ishin 34 me zotin Shala, dhe së bashku me Luan Aliun, 50 ishin kundër që të mbahet debati, 1 abstenim.

Ky është epilogu që ia dha seanca kësaj kërkesë se a duhet të mbahet debati apo jo. Urdhëro, për procedurë zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pas kësaj situatë të krijuar e konsiderojmë të paarsyeshme që ne të vazhdojmë të jemi pjesë e kësaj seancë. Shkojmë të koordinohemi për veprimet e mëtutjeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Uluni nëpër vendet tuaja! E shohim nëse Kuvendi ka kuorum tash pa opozitën. Uluni! Përgatituni për votim. Regjia, për prani e shohim sa jemi fillimisht pastaj e kuptojmë a mund të vazhdojmë me projektligje. Votojmë tash për praninë e deputetëve.

59 kanë votuar. Ju zoti Aliu, nuk keni kartelë, a po? 60. Nuk ka kuorum Kuvendi për 1 deputet. Kështu që, nuk ka mundësi të vazhdojmë punën. E shohim javën e ardhshme se si qëndron kjo. Mirupafshim!

\* \* \*



*E mërkurë, më 30 tetor 2024*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 12 shtator 2024*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po votojmë për praninë, e kuptojmë më mirë se sa jemi të pranishëm në seancë. Përgatituni për votim, votojmë tash!

Uluni! E përsëritim votimin. Votojmë për ta kuptuar më saktë praninë tonë në seancë, votojmë tash!

Mirë, zini vendet tuaja! Votojmë edhe një herë për prani, herën e fundit ishin 60. Votojmë tash!

Zoti Uka keni harruar të votoni, apo kartela ka problem? Nuk po bën kartela, a? E sheh regjia nëse është problem teknik. Mirë, regjia ma konfirmon që aparatura e zotit Uka është në rregull.

Mirë, votojmë prapë për praninë. Votojmë tash! Mirë, 61 deputetë i ka mazhoranca këtu të pranishëm dhe që kanë votuar. Prandaj, mund të fillojmë me rendin e ditës.

Pikën e parë e kemi, të nderuar deputetë:

## **5. Votimi për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

Vendimin e keni parë, çështja është trajtuar, më 12 shtator, kështu që votojmë tash. Vetëm 60 deputetë kanë votuar, një nuk ka votuar. Po, në rregull, por edhe zoti Muja duhet të kthehet atje derisa t'i kryejmë këto. Ju lutem, deputetë të mazhorancës, a mund të jeni më të koncentruar që të më dëgjoni çka jam duke folur kur e shpall votimin, e kështu me radhë se po e shoh që nuk...

Po pse s'ka votuar? A mund të jeni më të vëmendshëm në seancë, ju lutem secilit prej jush. Kemi ardhur enkas për këtë punë në Kuvend për t'i votuar projektligjet.

Votojmë tash!

Mirë, të gjithë kanë votuar, e kanë mbështetur emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi.

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që Kuvendi e mori këtë vendim, emërohen shtatë anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, këta janë: Artan Krasniqi, Fahri Beqiri, Besarta Reçica e Esin Salla, Zanita Halimi, Arianit Buçinca dhe Slagjana

Boshkoviq. Mandati i anëtarëve të Këshillit është tre vjet, ne u urojmë suksese dhe punë të mbarë.

Tash, i kemi këtu marrëveshjet ndërkombëtare, për të cilat me sa po e shoh nuk ka atmosferë që të votohen. Kërkoj nga Sekretaria pra që ta ketë parasysh që pikën 6, kështu siç figuron në rendin e ditës, pikën 7 dhe pikën 8, të tria marrëveshje ndërkombëtare, të barten kurdo që ka mundësi Kuvendi t'i trajtojë në ndonjë seancë të ardhshme.

### **9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor**

Kemi mbetur siç ju kujtohet te amendamenti i pestë. Kuvendi nuk ka pasur kuorum një kohë të gjatë për ta votuar këtë amendament. Amendamenti nëse po ju kujtohet është i deputetit Visar Korenica, po e hedh në votim të shikojmë nëse mund të marrë epilog kjo çështje.

Amendamenti i pestë është i propozuar nga Visar Korenica, nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Kush e voton këtë amendament? Votojmë tash!

Vetëm 44 deputetë kanë votuar për këtë amendament. Kuvendi nuk ka kuorum, kështu që pa u zhbllokuar ky amendament nuk mund të kalojmë në të tjerat. Prandaj, kjo është arsyeja pse tash do të kalojmë tash në pikat tjera.

### **10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë**

Por, projektligji i ka dy amendamente, të cilat janë propozuar. Të dyja amendamentet janë nga Komisioni Funkcional, kështu që e shohim nëse do ta marrin dritën e gjelbër nëse po votohen në Kuvend.

Përgatituni për votim, të nderuar deputetë, votojmë tash!

59 deputetë votuan për, 1 votë ishte kundër dhe 1 votë abstenuese. 61 vota në total, kalojnë amendamentet.

Tash e hedhim projektligjin në votim bashkë me këto amendamentet e miratuara.

Kush e voton këtë projektligj?

60 vota për, një votë ishte kundër, asnjë abstenim.

Me 61 vota, konstatoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zyrtarët publikë.

## **11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Çështje të Sigurisë e ka shqyrtuar projektligjin Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij, kurse Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji përmban edhe implikime buxhetore shtesë, por të cilat janë të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ndërsa, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka konstatuar që amendamentet dhe vetë projektligji janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm, kurse Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk rregullohen në mënyrë specifike nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Po ia jap fjalën qysh në fillim kryetarit të komisionit, më herët e pashë këtu, nuk qenka më duket, Bekë Berisha. Nuk qenka për momentin, a e kemi Enver Dugollin apo dikë tjetër, i cili është në gjendje ta paraqesë raportin e komisionit, ju lutem!

Urdhëroni, nënkryetar Dugolli!

ENVER DUGOLLI: Po, kryetar Komisioni për Çështje të Sigurisë edhe të Mbrojtjes e ka shqyrtuar këtë raport me rekomandime dhe njëzëri e kemi rekomanduar për seancë. I lus deputetët që ta votojnë këtë projektligj.

KRYETARI: Po ashtu, zoti Dugolli kenë propozuar shtatë amendamente, duhet t'i trajtojmë fillimisht këtu. Me sa po e shoh, të gjitha qenkan nga Komisioni Funkcional, kështu që po i hedh në votim.

Përgatituni për votim, të nderuar deputetë, janë amendamentet e Projektligjit të Këshillit të Sigurisë, votojmë tash për amendamentet.

Vetëm 59 deputetë votuan. Mirë, nëse mazhoranca i ka të gjithë deputetët në sallë, ju lutem të jeni më të koncentruar, tash po i votojmë amendamentet e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kalojnë amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

Tash po e votojmë pra Projektligjin për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës, votojmë tash së bashku me këto amendamente që u miratuan.

Mirë, 62 vota i mori projektligji së bashku me amendamentet. Kështu që konstatoj që Kuvendi me 62 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim e miratoi Projektligjin për Këshillin e Sigurisë.

## **12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët**

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin, Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij, Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji përmban edhe implikime buxhetore shtesë, por të cilat janë të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ndërsa, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kryetarja e komisionit flet tash, Fitore Pacolli-Dalipi, na e paraqet raportin.

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Faleminderit, kryetar!

Po, komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka shqyrtuar të gjitha amendamentet, të cilat janë të Komisionit FunkSIONAL dhe mbështeten nga komisioni, prandaj ne u kërkohet të gjithë deputetëve që ta votojnë këtë projektligj dhe amendamentet e tij. Faleminderit!

**KRYETARI:** Me sa po e shoh, projektligji paska 95 amendamente, të cilat qenkan propozuar nga Komisioni FunkSIONAL. Të gjitha më duket janë të komisionit, ka pasur pajtueshmëri për to, kështu që po i hedh në votim. I hedhim amendamentet e Projektligjit për rrugët, votojmë tash!

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që Kuvendi e miratoi Projektligjin për rrugët. A vetëm amendamentet i votuam?

Tash e hedhim projektligjin, votojmë tash!

Mirë, 62 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Projektligjin për rrugët.

### **13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka vlerësuar se projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji nuk rregullohet në mënyrë specifike përmes legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të Kthimit nuk e ka shqyrtuar fare projektligjin brenda afatit siç e parasheh Rregullorja e Kuvendit.

Kush e merr fjalën për ta paraqitur raportin? Kryetari i Komisionit, Adnan Rustemi flet. Urdhëro, zoti Rustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar projektligjin ndërmjet dy leximeve, bëhet fjalë për një ndryshim të kufizuar me një nen esencial që u mundëson bashkëkombësve tanë nga Lugina e Preshevës për të pasur pronësinë mbi pronën edhe në Kosovë.

Unë i ftoj deputetët që ta miratojnë këtë ndryshim, respektivisht këtë projektligj.

KRYETARI: E hedhim në votim. Është për të drejtat e shtetasve të huaj. Po e hedhim projektligjin drejt në votim, sepse nuk ka amendamente.

Përgatituni për votim, të nderuar deputetë. Votojmë tash për projektligjin.

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Projektligjin për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

#### **14. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile**

Përgatituni për votim! Të gjitha diskutimet kanë përfunduar qysh më herët. Votojmë tash!

Vetëm 48 deputetë kanë marrë pjesë në votim. Ky është një projektligj siç duket që nuk ka pajtim në grupin parlamentar të mazhorancës, kështu që nuk kemi mundësi ta trajtojmë.

Kërkoj që ky të zhvendoset. Pra, është ky Projektligji për gjendjen civile.

Tash e kemi një projektligj tjetër:

#### **15. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore**

Përgatituni për votim! Projektligji i maturës, të nderuar deputetë. Votojmë tash!

Nuk votohet as ky projektligj. Vetëm 54 deputetë po marrin pjesë në votim.

Ky numër më thotë që nuk është çështje teknike, po me siguri ka një mospajtim nga një grup i deputetëve. Kështu që edhe këtë e lëmë, sepse nuk ka kuorum Kuvendi.

#### **16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Mjedis e ka shqyrtuar projektligjin dhe ia ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e tij.

Komisioni ka rekomanduar mosmiratimin e tij?

Mërgim Lushtaku, deputeti në emër të propozuesit e paraqet dhe e arsyeton këtë çështje.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse ky projektligj është hera e dytë që e prezantoj, jo vetëm në këtë legjislaturë, por edhe në legjislaturën e kaluar. Ka qenë kërkesë e shumë qytetarëve që të ketë një ndryshim të Ligjit për automjete. Kryesisht prej familjeve me standard më të ulët, duke e ditur që e kanë të vështirë që të blejnë një veturë me një standard ekonomik të familjeve të ulëta dhe të mesme.

Duke e parë që Ligji për automjete ua ndalon importimin e veturave më të vjetra se dhjetë vjet, unë kam propozuar që ky kufizim të largohet, meqenëse në Ligjin për automjete i kemi dy standarde dhe ato standarde të dyfishta, gjë që nuk ndodh as në Evropë. Në Evropë kemi vetëm një standard, ku përmendet Euro Diesel 4 apo 5 dhe varësisht prej qyteteve apo kryeqyteteve ku ka komunikacion më të madh dhe mund të shkaktojnë edhe ndotje të ajrit.

Herën e kaluar kur e kam prezantuar këtë projektligj, ka pasur shumë debate në nenet e ndryshme, kryesisht te kontrollet teknike. Prandaj, meqenëse ka pasur debat në atë fushë, unë e kam tërhequr atë propozim dhe jam fokusuar vetëm te pjesa e ndalimit të importit të veturave, meqenëse siç thashë, ekonomitë familjare nuk e përballojnë të blejnë vetura shumë të reja. Sigurisht, që duhet t'ua lehtësojmë familjeve në fjalë.

Unë kam propozuar një rritje të standardit në Ligjin për automjete që në ligjin aktual është Euro Diesel 4. Kam propozuar që të ketë një rritje të standardit, siç është Euro Diesel 5, ku edhe ruhet ambienti dhe ajri në përgjithësi.

Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët pa dallim që të votojnë në këtë projektligj, i cili besoj që është në të mirën e qytetarëve të vendit, sidomos atyre të cilët nuk kanë mundësi të blejnë vetura 2015, 2016, 2017, se me të vërtetë kanë ekonomia familjare të dobëta dhe të varfra dhe s'kanë mundësi të ndërrojnë një veturë të tillë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash, në emër të Komisionit, kryetarja Fitore Pacolli-Dalipi flet. Urdhëroni deputete!

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni i ka shqyrtuar propozimet të cilat kanë ardhur nga deputeti, i cili sapo i prezantoi. Komisioni mendon se propozimet janë joprofesionale, prandaj edhe u kërkohet deputetëve që të mos i votojnë.

Po ashtu, Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës është duke punuar në hartimin e Ligjit të ri i cili rregullon të gjitha problemet që janë paraqitur me ligjin ekzistent. Kështu që, ne u propozojmë deputetëve që të votojnë kundër këtij propozimi dhe të presin ligjin i ri, i cili do të ketë ndryshime profesionale dhe të domosdoshme në Ligjin për automjetet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Duhet ta hedhim në votim këtë projektligj. Përgatituni për votim.

Të nderuar deputetë, uluni! votojmë tash për këtë projektligj!

Për këtë projektligj, 9 deputetë votuan për, kundër tij ishin 52 deputetë, 5 deputetë abstenuan. Gjithsej 66 vota.

Konstatohet që Kuvendi nuk e miratoi Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të automjeteve.

### **17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Mjedis e ka shqyrtuar projektligjin dhe në parim na ka rekomanduar miratimin e tij.

Kush? Ministri Aliu ka pasur ta prezantojë këtë projektligj, po nuk qenka më duket. A ia ka deleguar dikujt këtë përgjegjësi? Jo. Kështu që, konstatohet që projektligji pa ministrin nuk mund të prezantohet.

I ftojme kabinetet e ministrave të jenë më të vëmendshëm, ta shohin kur është seanca dhe kur i kanë projektligjet.

### **18. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Integrim Evropian e ka shqyrtuar Programin kombëtar për integrim evropian 2024-2028.

Për këtë çështje, pikërisht për ta prezantuar programin e kemi zv.kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Besnik Bislimi.

Urdhëroni z. Bislimi, fjala është e juaja!

Në foltore, mikrofonin ju lutem!

ZV.KRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Konjufca!

E nderuar nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 2 prill dhe tre muaj pas miratimit në Komision për Integrim Evropian, më lejoni të prezantoj para jush Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028 për miratim nga Kuvendi.

Programi përbëhet nga tri blloqe: kriteret politike, kriteret ekonomike, si dhe përafrimi i legjislacionit tonë me AQUIS.



Programi ka 306 masa, prej të cilave 105 janë masa legislative, kurse 201 janë masa zbatuese.

Nga 105 masat legislative, 38 prej tyre janë projektligje, tri janë marrëveshje ndërkombëtare, kurse pjesa tjetër janë akte nënligjore.

Buxheti për zbatimin e këtij programi në përgjithësi është vlerësuar të jetë 56.043.856 euro. Nga të cilat, 22.6 milionë euro janë nga buxheti publik, ndërsa 33.434.996 euro vijnë nga partnerët zhvillimorë dhe donatorët.

Rrjedhimisht, për implementimin e këtij Programi ka zero vakum buxhetor.

Masat afatshkurta që janë paraparë ndërlidhen dhe janë në harmoni të plotë me konkluzionet e strukturave institucionale të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim, me Programin për reforma ekonomike 2024-2026, me Planin Kombëtar për Zhvillim dhe Programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2024.

Meqë janë me rëndësi për punën e Kuvendit, në Programin Kombëtar për integritet evropian janë planifikuar këto projektligje, përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare e po flas vetëm për këtë vit. Projektligji për plotësim-ndryshim të ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimi i tyre me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative në fazën e tretë. Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura.

Projektligji për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve. Projektligji për prokurimin publik në plotësim-ndryshim. Projektligji për partneritetin publiko-privat, po ashtu plotësim-ndryshim. Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, plotësim-ndryshim. Projektligji për shoqëritë tregtare. Projektligji për ndihmën shtetërore, plotësim-ndryshim. Projektligji për bankat, për komunikimet elektronike, për agroturizëm, për tokën bujqësore, veterinarisë, për peshkatarinë dhe akuakulturën, për automjete, për patentshoferë, për hekurudha, për transportin rrugor, për transportin e mallrave të rrezikshme, për sigurinë hekurudhore, për energjinë, për energjinë elektrike, për Rregullatorin e Energjisë, për eficientësinë e energjisë, për të drejtën në gjykim brenda kohës së arsyeshme. Pastaj, Projektligji për Gjykatën Administrative, Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ai për plotësim-ndryshimin e Ligjit për të huajt. Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për armë. Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Marrëveshja për bashkëpunim juridik me Francën, Marrëveshja për bashkëpunim juridik me Suedinë si dhe Marrëveshja për bashkëpunim juridik me Italinë. Pastaj Projektligji për veprimtaritë kërkimore-shkencore, inovacion dhe transfer të dijes dhe teknologjisë. Projektligji për mbrojtjen e mjedisit, ai për menaxhimin e resurseve ujore, Projektligji për mbrojtjen e natyrës, Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit

hapësinor, ndërtimit dhe banimit. Projektligji për pajisje dhe produkte medicinale, Projektligji për kontrollin e duhanit si dhe Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit në plotësim-ndryshim.

Në vijim, shkurtimisht për disa reforma kryesore për secilin bllok. Te kriteret politike, kemi legjislacionin dhe politikat kornizë për reformën e administratës publike, kemi projektin e reduktimit të barrës administrative, kemi programin e racionalizimit të agjencive, avancimin e politikave dhe legjislacionit për qeverisje lokale, si dhe avancimin e reformave në fushën e politikës së jashtme dhe atë të BE-së.

Te kriteret ekonomike, kemi zbatimin e Strategjisë dhe planin e veprimit për reformat e menaxhimit të financave publike 2022-2026 si dhe luftimin e ekonomisë informale.

Te standardet evropiane, apo përafrimin e legjislacionit, kemi reformat legjislative në fushën e prokurimit publik dhe atij publiko-privat, reformat në fushën e inspektiveve, reformat legjislative në fushën e sektorit bankar, reformat në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit dhe të shërbimeve financiare si dhe zbatimi praktik, reformat legjislative dhe të politikave në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore si dhe zbatimi në praktikë, reformat legjislative dhe të politikave në fushën e bujqësisë e agroturizmit e veterinisë, reformat legjislative dhe të politikave në fushën e transportit dhe rrjeteve transevropiane, TIK-ut si dhe zbatimi dhe ngritja e kapaciteteve institucional, reformat legjislative dhe të politikave në fushën e energjisë dhe zbatimi i tyre në përputhje me agjendën e dekarbonizimit, reformat legjislative dhe të politikave në fushën e mjedisit, ujërave dhe mbeturinave, reformat legjislative dhe të politikave në fushën e shëndetit publik dhe mbrojtjes së konsumatorit, reformat e politikave dhe ato institucionale në fushën e të drejtës së kompanive, ndërmarrjeve dhe industrisë, me fokus në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për investitorë dhe ndërmarrjet e tjera si dhe forcimin e konkurrueshmërisë në treg brenda vendit dhe jashtë tij.

Reformat legjislative dhe të politikave fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, me fokus në funksionalizimin e institucioneve, sistemit të drejtësisë, profesioneve të lira të drejtësisë, të drejtave themelore, mediave, barazisë gjinore, të drejtave të pakicave, dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Reforma legjislative dhe të politikave në fushën e punëve të brendshme me fokus në mbikëqyrjen e kufirit, azilin dhe migracionin, rendin publik dhe bashkëpunimin policor, sigurinë kibernetike dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe juridike;

Reforma legjislative dhe të politikave në fushën e punëve të brendshme me fokus në luftimin e shpëlarjes së parave, financimin e terrorizmit dhe luftimit të narkotikëve;

Përmirësimi i politikave dhe i zbatimit të tyre në fushën e arsimit, shkencës dhe hulumtimeve shkencore; si dhe avancimi i politikave dhe zbatimi i tyre në fushën e kontrollit financiar.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ju ftoj që këtë Program për Integrim Evropian ta miratoni në seancën e sotme. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Tash komisioni do të duhej ta ketë fjalën. Nuk po e shoh këtu kryetaren Krasniqi, por po ia jap fjalën nënkryetares Ujkani.

Urdhëroni deputetja Ujkani, fjala është e juaja për ta prezantuar raportin.

**FJOLLA UJKANI:** Faleminderit, kryetar!

Programi Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028 është dokumenti kryesor strategjik i Republikës së Kosovës për zbatimin e reformave për integrim në Bashkimin Evropian, i orientuar nga adoptimi i Acquis së BE-së, me legjislacionin kombëtar dhe zbatimin e tij.

Sa i përket përmbajtjes, ky Program është gjithëpërfshirës për nga fushëveprimi. Ai paraqet reforma afatshkurtra për v. 2024 dhe objektiva prioritare afatmesme për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së përmes përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së dhe zbatimin të legjislacionit të përafruar.

Bazuar në strukturën e kriterëve të Kopenhagës, ai është i ndarë në tri blloqe: kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet evropiane, përafrimi i legjislacionit të Kosovës me Acquis e BE-së.

Secili kapitull është i ndarë në dy pjesë, pjesën tekstuale dhe matricën e masave afatshkurtra. Pjesa tekstuale përmbledh gjendjen aktuale, kornizën legjislative të politikave dhe atë institucionale dhe objektivat prioritare afatmese.

Ndërsa, projektet relevante të asistencës për zhvillim janë përmbledhur në shtojcën në fund të kësaj pjese.

Matrica e masave afatshkurtra përmban masa konkrete të planifikuara për v. 2024 për zbatimin e reformave, përkatësisht masat legjislative, legjislacionin kornizë dhe aktet nënligjore, e aktet e tjera rregullative dhe ato zbatuese të Kornizës së politikave, reformave institucionale e ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe për zbatim në praktikë.

Përgjegjëse për zbatimin e këtij programi dhe monitorimin e zbatimit të tij do të jenë organet përkatëse të administratës shtetërore, ndërsa Kuvendi do të jetë një nga shtyllat kryesore

institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti përmes miratimit të legjislacionit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tij përmes Komisionit për Integrim Evropian dhe komisioneve të tjera funksionale.

Si të tillë, Komisioni për Integrim Evropian ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare. Faleminderit!

KRYETARI: Po, katër-pesë deputetë po e shoh që po mungojnë të mazhorancës.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, Besnik Tahiri ma ka kërkuar fjalën. Urdhëroni z. Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit kryetar Konjufca!

I nderuar zv.kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

E kërkoja fjalën për shkak se siç po shihet dokumenti kryesor strategjik i qëllimit më të madh politik të Republikës së Kosovës, pra të integrimit evropian, disi po do të kalohet pa u thënë asnjë fjalë dhe pa u debatuar aspak se ku është Kosova dhe ku do të shkojë Kosova me këtë dokument.

U tha nga kolegja Ujkani që Programi Kombëtar për Integrim Evropian është dokumenti kryesor strategjik i Republikës së Kosovës që i jep drejtim në katër vitet e ardhshme procesit më jetik të Kosovës, atë të integrimit evropian.

Çka duhet të dijë qytetari i Kosovës sot dhe çka duhet të përgjigjet zv.kryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës që e ka po ashtu në portfolion e vet platformën e integrimit evropian?

Të nderuar deputetë,

Ky dokument është miratuar në Komisionin përkatës më 19 qershor të këtij viti. Pra, pesë muaj më parë. dokumenti strategjik i cili është dashur të reflektojë në synime dhe në detyra afatshkurtra të zbatimit për këtë vit vjen në Kuvendin e Kosovës pesë muaj prapa.

Në qoftë se e shikoni te rekomandimi i cili u prezantua nga nënkryetarja e këtij Komisioni, shihet shumë qartë referenca që duhet të kryhen disa punë që quhen veprime afatshkurtra të v. 2024. Cilat janë këto veprime? Këto veprime ndërlidhen me akte nënligjore dhe rregullore që ishte dashur Qeveria t'i përfundojë.

Kërkoj nga zv.kryeministri të dalë të na tregojë cilat akte në detyrën tuaj afatshkurtër të v. 2024 i keni përfunduar dhe cilat nuk i keni të përfunduara?

Të nderuar deputetë,

E dyta, ne po flasim për po ashtu miratimin e disa ligjeve dhe sot jemi në fund të tetorit. Pra, na kanë mbetur edhe një muaj e gjysmë dhe nuk ka asnjë fjalë, nuk u tha cilat ligje vijnë sot, cilat ligje kanë interes të konsensusit kombëtar, pse kanë interes të konsensusit kombëtar.

Ky dokument i trajton tri elemente që u thanë më herët që janë shumë të rëndësishme dhe të cilat duhet qytetari i Kosovës t'i kuptojë se ku është Kosova dhe ku synon të shkojë. Elementi i parë është elementi politik. Kur flasim për elementin politik, duhet t'ia rikujtojmë zv.kryeministrit të parë që Kosova sot është nën sanksione. Që sot në ora katër i dorëzohet, nuk e di a i është dorëzuar ende, Raporti i Progresit që në kriterin politik përfaqëson kritika të drejtpërdrejta për menaxhimin e shtetit që ka qenë vitin e kaluar.

Pra, Raporti i Progresit nënvizon probleme serioze që ndërlidhen me kapacitetin e kësaj Qeverie për të shtyrë përpara agjendën e reformave të integritit evropian. Ndërlidhet po ashtu me një mori ligjesh të cilat bien ndesh drejtpërdrejt me kriteret e Kopenhagës, ligje të cilat kanë prekur funksionimin e institucioneve të pavarura, duke filluar nga Këshilli i Pavarur për Media, duke filluar nga moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, mirëpo po ashtu edhe me legjislacion që ndërhyt drejtpërdrejt në fushat të cilat janë kritere të paprekshme dhe janë rrugëtim dhe udhërrëfyes i një shteti për t'u bashkuar përmes këtij Plani Kombëtar për Integritin Evropian.

Duhet të na përgjigjet zv.kryeministri sot këtu se për çfarë ekonomie po flet. Ku është sot ekonomia e Kosovës dhe ku projektohet ekonomia e Kosovës?

Cilat janë masat që ka marrë Kosova që ekonomia jonë të përafrohet me kriteret e integritit evropian në raport me planin kombëtar dhe me kërkesat që u thanë më herët dhe me masat, me 105 masat, të cilat duhet t'i marrim.

Ekonomia e Kosovës sot është buzë kolapsit. Ekonomia e Kosovës sot nuk e ka asnjë ndihmëse të vetme. Vetëm ka pengesa. Ajo që u fol më herët për reduktimin e barrë administrative, e cila do të duhej të ishte udhërrëfyesi i Qeverisë. Janë masa plotësisht të dobëta.

Sot, secili biznes i ri, secili investim i huaj ballafaqohet me masa, me barriera administrative të politikave publike për të cilat duhet të flasë zëvendëskryeministri këtu.

Një element i rëndësishëm që mund të jetë pozitiv është çështja që u ngrit nga zëvendëskryeministri për luftimin e informalitetit, të dhënat edhe në Agjencionin e Statistikave, por edhe të dhënat e tjera empirike e japin një masë pozitive në raport informalitetin. Por, gjithçka tjetër në ekonomi është presion, është ndikim dhe nuk lidhet me synimin që e ka Kosova për integritim evropian.

Pra, ekonomia e Kosovës, të mos harroni, është ekonomia më e dobët dhe me masa dhe barriera më të mëdha që një shtet i jep sektorit privat dhe investitorëve të huaj.

Pika e këtij raporti, pra, i Programit Kombëtar për Integrim Evropian, po e ripërsëris, dokumentit kryesor strategjik që e ka vendi ynë, lidhet me standardet evropiane. Për çfarë standarde, më falni, evropiane po flasim. Për standarde evropiane që miratojmë ligje të cilat apriori na vijnë nga Unioni Evropian, nga organizatat që i monitorojnë proceset dhe thonë, jeni gabim, jeni në kundërshtim me kriteret e Kopenhagës. Qysh ka mundësi që të udhëhiqet shteti me ushtrues detyre dhe kjo të legalizohet me Ligjin për administratë publike, t'i jepen dy vjet një ushtruesi të detyrës në administratë? Qysh ka mundësi që shërbyesit civilë në karrierë, të cilët janë ndërtuar me kohë, t'u nënshtrohen një provizionit ligjor, i cili ia hap vendin e punës dhe karrierën e tij apo të saj në këtë institucion ta dëmtojë? Qysh ka mundësi, mbi cilën bazë?

E them edhe tjetrën që është po ashtu e rëndësishme të thuhet, gjuha që është përdorur në këtë foltore ndaj instancave të sundimit të ligjit. Është gjuhë e papranueshme, ku evidentohet drejtpërdrejt ndikimi politik.

Dhe e fundit, te matrica e masa konkrete dhe afatshkurtra për vitin 2024, duhet të dalë zëvendësministri të na tregojë se çka kanë bërë këtë vit 2024, dhe sa detyra kanë mbetur pa u kryer, të cilat pastaj përkthehen në dobësimin e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ju lutem deputetë, meqenëse do ta votojmë Programin së shpejti, kërkoj që të mblidheni në sallë. Fillimisht, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje. Pra, ua japim fjalën grupeve parlamentare, Lëvizjes Vetëvendosje, Driton Hysenit fillimisht. E keni në emër të grupit a po.

**DRITON HYSENI:** Ju faleminderit, kryetar Konjufca!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht, meqë zoti Tahiri e përmendi që raporti dorëzohet sot, do të ishte mirë që ta presim dorëzimin, ta trajtojmë më kujdes dhe mandej të shohim se cila është perspektiva që përmban raportin, cilat janë të gjeturat e tij, e ne e dimë që në dy vitet e kaluara, sidomos, kemi parë që raportet e Bashkimit Evropian kanë evidentuar zhvillime shumë pozitive në vendin tonë, për çka duhet t'i gëzohemi edhe pozita edhe opozita.

Referuar ekspozesë së zëvendëskryeministrit sa i takon Programin Kombëtar të Integritimit Evropian për periudhën 2024-2028, pra, kemi një përmbledhje të zbatimit të reformave përafuese, të cilat sigurojnë rrugëtim të qartë të Republikës së Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Vlen të theksohet fakti, të nderuar kolegë deputetë, se programi në fazat e përpilimit ka marrë në konsideratë programin e Qeverisë, agjendën legjislative të saj, por edhe dokumente të tjera me rëndësi për sektorët që programi ka në fokus.

Programi me prioritet të lartë adreson edhe konkluzionet e dakorduara me Bashkimin Evropian në kuadër të strukturave të përbashkëta të stabilizim-asociimit, dhe i ka përmbledhur brenda vetes edhe në rekomandimet e raportit të dorëzuar Kosovës nga Komisioni Evropian në vitin 2023.

Përfshirja e të gjitha institucioneve përgjegjëse në hartimin e programit siguron që programi është hartuar me kujdes shumë të madh dhe që do të ketë nivel të lartë zbatueshmërie, që në përkthim i bie, përfarim me legjislacionin e BE-së dhe me të gjitha masat të cilat BE-ja ia kërkon vendin tonë.

Them nivel të lartë zbatueshmërie, të nderuar kolegë, sepse si vend vitet e fundit kemi shënuar progres në implementimin e reformave që na për afrojnë me Bashkimin Evropian. Për konsideratën tuaj dhe për konsideratën e publikut, përderisa gjatë fazës ERA 1 e dakorduar në vitin 2016, zbatueshmëria e masave të planifikuara ishte në nivelin 45%. Pra, nuk ishte as 50%. Në Agjendën e Reformave Evropiane ERA 2, e miratuar në vitin 2021, niveli i zbatimit të masave të parapara është 72%.

Në këto vite të zbatimit të masave të planifikuara me ERA 2, kemi një përmbushje prej 60% më shumë sesa përmbushja e masave që ishin planifikuara në ERA 1.

Uroj që me punë e angazhim të të gjitha institucioneve të implementohen masat e planifikuara me Programin Kombëtar të Integritimit Evropian, dhe ato të arrijnë zbatueshmëri të madhe. Zbatimin e plotë të programit do ta ndihmojnë edhe fondet e para-aderimit të alokuara nga Bashkimi Evropian, por edhe mekanizmi për reformat e rritjes ekonomike si fonde shtesë nga Bashkimi Evropian.

Ju e dini që së fundmi me planin e rritjes, Kosova deri në vitin 2027 është paraparë t'i fitojë mbi 880 milionë euro.

Me zbatimin e këtij programi, një nga shtyllat kryesore, në veçanti përmes miratimit të ligjeve, është edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe ne përmes komisioneve tona parlamentare të cilat janë relevante për fushën e integritimit, duhet ta japim maksimumin në drejtim që vendi ynë të përmbushë të gjitha këto objektiva që ka, dhe vendi ynë sa më parë të jetë pranë BE-së, i pranuar në gjirin e shteteve evropiane.

Duke ju lutur për miratim të këtij Programi Kombëtar të Integritimit Evropian, ju falënderoj për vëmendjen! Faleminderit!

**KRYETARI:** I thërrasim të gjithë deputetët që të kthehen në sallë, se tash mund të votojmë. Uluni, zini vendet tuaja! Urdhëro! Besnik Tahiri e ka fjalën. Urdhëro!

**BESNIK TAHIRI:** I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Po e shoh që nuk ka përgjigje nga Qeveria rreth tri kërkesave të mia. Unë i them këtij Kuvendi dhe qytetarëve të Kosovës dhe 80 mijë njerëzve që i japin kuptim shtetit, që sot me miratimin e Ligjit për zyrtarët publikë i është dhënë një goditje sistemit në administratën shtetërore, që vështirë do të mund të përmirësohet në këtë aspekt.

E them me përgjegjësi të plotë, i nderuar kryetar, për shkak se do të jetë shumë vështirë çfarëdo qeverie tjetër që vjen që ta heqë ndikimin partiak në emërimin dhe rikthimin e konkursit. Sot është kthyer konkursi i treshes të cilën ne e kemi hequr dhe e kemi çuar në kriter tjetër të vlerësimit.

Sot, secili zyrtar i mesëm dhe i lartë ndjehet i rrezikuar prej presionit politik dhe në veçanti prej provizionit, po ju them me përgjegjësi të plotë, të normimit me ligj të ushtruesit të detyrës, 1+1.

Të mos harroni, secila qeveri që të vije do të mundohet ta ketë 1+1, një vit ushtrues detyre që t'ia vazhdojë edhe një herë që të mund ta mbaj me një e-mail në detyrë dhe me një e-mail ta shkarkojë. Kjo është goditja e madhe e pafalshme, për mua, ekstremisht befasuese që vjen prej një koncepti që do të duhej të përfaqësojë barazi, dinjitet dhe profesionalizëm.

**KRYETARI:** Prapë po e shoh që një pjesë, sidomos të komuniteteve, e deputetëve nuk janë të pranishëm. Tash mazhoranca u kumpletua, kështu që e hedhim në votim këtë Program Kombëtar të Integritimit Evropian. Votojmë tash.

59 deputetë votuan për, asnjë votë kundër, dy abstenime. Me 61 vota në total, por 59 për, kalon Programi Kombëtar i Integritimit Evropian për vitet 2024-2028.

Megjithatë, u pajtuam që këtë për menaxhimin e resurseve ujore ta bëjë zëvendëskryeministri Bislimi. Kështu që, e ftojme ta marrë fjalën për projektligjin dhe ta paraqesë në emër të Qeverisë. Urdhëroni, zoti Bislimi!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,



Marrë parasysh përcaktimin programor të Qeverisë në programin e saj 2021-2025, por edhe miratimin e koncept-dokumentit nga fusha e ujërave që u miratua në muajin qershor të vitit 2023, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka hartuar Projektligjin për menaxhimin e resurseve ujore me qëllim të krijimit të kuadrit të duhur ligjor që mundëson zhvillimin, shfrytëzimin dhe financimin e qëndrueshëm të resurseve ujore aq të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe në tërësi zhvillimin ekonomik të Republikës.

Duke e miratuar këtë projektligj mundësojmë arritjen e objektivave themelore rreth menaxhimit të resurseve ujore, siç janë: mbrojtja e ujërave, mbrojtja nga veprimet e dëmshme mbi to, dhe shfrytëzimi eficientë i ujërave.

Përmes projektligjit adresojmë mangësitë e Ligjit aktual për ujëra, në veçanti kur flitet për rolet dhe përgjegjësitë institucionale dhe statusin e tyre. Kështu, përmes projektligjit themelojmë Agjencinë për Menaxhimin e Resurseve Ujore si agjenci ekzekutive me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë dhe në përputhje të plotë me programin e Qeverisë, i cili parasheh konsolidimin e institucioneve për menaxhimin e ujërave.

Po ashtu rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me tokën ujore dhe objektet ujore, si dhe janë rregulluar në mënyrë të detajuar instrumentet e dhënies së të drejtës ujore për shfrytëzim të ujërave dhe për shkarkim të ujërave të ndotura.

Është me rëndësi të përmendim që projektligji transponon më legjislacionin tonë direktivat kornizë për ujërat e Bashkimit Evropian dhe direktivat e tjera relevante nga fusha e ujërave, me ç'rast përafrojmë legjislacionin e ujërave me AQUIS të BE-së, e ky është orientim strategjik i Republikës sonë, dhe njëkohësisht një prej objektivave që i kemi të përcaktuara në Strategjinë për ujërat.

Andaj, marrë parasysh rëndësinë thelbësore që ka kompletimi i kuadrit ligjor për ujëra për administrimin e tyre, ju ftoj që këtë projektligj ta miratoni. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ky ishte prezantimi nga ana e zëvendëskryeministrit, i projektligjit. Tash po ia jap fjalën kryetares së komisionit, Fitore Pacolli-Dalipi. Urdhëroni, e keni fjalën për ta paraqitur raportin e komisionit tuaj.

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për menaxhimin e resurseve ujore dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kriteret e para me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit. Kështu, i rekomandojmë deputetëve që ta miratojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: A jeni të gjithë këtu? Po e hedhim në votim projektligjin. Përgatituni për votim. Votojmë tash. Teknika, ju lutem! Votojmë për projektligjin tash. Regjia, ju lutem! Votojmë Projektligjin për menaxhimin e resurseve ujore. Votojmë tash.

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për menaxhimin e resurseve ujore. Kërkojmë nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj, dhe pastaj sipas afateve që gjithmonë i kemi këtu në Kuvend, na e sjellin për lexim të dytë.

Të nderuar deputetë,

Tash e kemi në trajtimin pikën e nëntëmbëdhjetë, e që është:

### **19. Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH**

Diskutimi është kryer. E hedhim në votim. Rezoluta për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit. Është një diskutim që është ngritur më 2 maj, por kurrë s'kemi mundur që t'i japim epilog kësaj.

Përgatituni për votim, votojmë tash. 61 deputetë votuan, por 58 abstenuan. 1 votë kundër, 2 vota për, kështu që konstatoj që Kuvendi e hedh poshtë këtë rezolutë të propozuar. Nuk miratohet ajo.

### **20. Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

Kjo deklaratë ka pasur të prezantohet nga deputeti Xhavit Haliti, por zoti Haliti e ka një arsye objektive familjare pse nuk është këtu. I ka ndërruar jetë nëna, kështu që edhe në emër të deputetëve edhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës i shprehim atij dhe familjes së tij ngushëllimet tona për deputetin Haliti. Kështu që, kjo rezolutë besoj që trajtohet kur ai të vijë në Kuvend dhe harmonizohet kjo deklaratë edhe me grupet e tjera parlamentare.

Tash e kemi:

### **21. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës**

Kjo projektrezolutë me sa po e kuptoj unë ka pasur të paraqitet nga ana e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Nuk janë të pranishëm, kështu që e lëmë për një moment tjetër.

## **22. Shqyrtimi Projekt-rezolutës për tërheqjen e tri (3) projektligjeve nga shqyrtimi në Kuvend**

Po ashtu... Në emër të grupit parlamentar, Mimoza Kusari-Lila, urdhëroni!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Kjo rezolutë ishte e propozuar në sesionin e kaluar, gjegjësisht në sesionin pranveror dhe kishte të bënte me tri ligje të cilat i ka miratuar Kuvendit. Do të thotë, kësaj rezolute tashmë i ka skaduar koha. Kështu që, mund ta hidhni në votim ndoshta që ta përmbyllim këtë proces, po ne sapo e votuam edhe ligjin e tretë, i cili ka qenë në këtë projekt-rezolutë.

KRYETARI: Po e hedhim në votim projektrezolutën. Uluni në nëpër vendet tuaja! E hedhim në votim, votojmë tash. 62 deputetë votuan. Për asnjë, 52 kundër, 10 abstenime. 62 vota në total. Konstatoj që hidhet poshtë kjo. E pastrojmë nga rendi i ditës.

## **23. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për arratisjen e personave të dënuar – degradimi i institucioneve të sigurisë**

Kjo siç duket nuk është prezantuar a po? Nuk është prezantuar nga ana e deputetit Tahiri. Nuk janë këtu. Atëherë, e lëmë për një moment tjetër kur t'i vijë koha edhe kur i kemi mundësitë këtu në Kuvend më të përshtatshme.

## **24. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim e ka shqyrtuar këtë raport dhe neve na e ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Këtë raport ka pasur për ta paraqitur në emër të Komisionit Funkcional, deputetja Eliza Hoxha. Me sa po e shoh zonja Hoxha nuk është në Kuvend sot.

A ka mundësi kryetari i komisionit, Ardian Gogla, deputeti e paraqet këtë raport të komisionit. Urdhëroni, zoti kryetar!

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryekuvendar!

Ligji për sponsorizimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është dokumenti më i rëndësishëm i miratuar viteve të fundit për këto tri fusha jetike të secilës shoqëri. Edhe pse ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2017, zbatimi i tij ka filluar të ndjehet ndjeshëm tek në vitin 2021.

Zbatimi i Ligjit për sponsorizime ishte shumë i kufizuar edhe për shkak të pandemisë COVID-19, pasigurisë ekonomike dhe hezitimit të bizneseve që të sponsorizojnë sportin, rininë dhe kulturën.

Sidoqoftë, për tri vite zbatim të plotë pas pandemisë, ky ligj ka mundësuar sponsorizimin në vlerë të përgjithshme mbi 30 milionë euro dhe është një ka shtysat kryesor të zhvillimit të sportit, sukseseve ndërkombëtare të ekipeve të Kosovës, rritjes së pagave të sportistëve, punës më të mirë të federatave dhe qarkullimit të përgjithshëm më të madh të buxhetit në sport, kulturë e rini.

Sidoqoftë, ligji ka disa mangësi të evidentuara, kurse nga zbatimi i tij janë evidentuar edhe telashe praktike në terren. Mangësia kryesore e ligjit është diskriminimi i kulturës dhe rinisë në raport me sportin meqë në sport lejohet që sponsorizimet të arrijnë vlerën deri në 30% të tatimit në fitim të një biznesi të caktuar, kurse për rini, kulturë kjo kuotë është vetëm 20%.

Ligji, po ashtu nuk parasheh trashëgiminë kulturore si veprimtari që mund të sponsorizohet nga bizneset, përfshirë këtu edhe disa probleme që lidhen me aspekte të rregullimit të brendshëm të ministrisë përkatës. Në terren ndërkaq 90% të sponsorizimeve janë drejtuar në sport. Megjithatë, një pjesë të klubeve dhe federatave, për shkak të telasheve me licencim, nuk u janë vërtetuar sponsorizimet dhe një numër i madh i artistëve të pavarur, duke mos pasur status të qartë juridik, nuk mund të fitojnë fare nga ky ligj.

Megjithatë, statusi i artistëve të pavarur është adresuar me Ligjin e ri për kulturën dhe tashmë mund të llogaritet që ky problem vetëm se është tejkaluar. Meqë raporti është diku rreth 18 faqe dhe është mjaft i detajuar si i tillë, po mjaftohem këtu vetëm me paraqitjen para deputetëve të nderuar të disa prej rekomandimeve që grupi punues i ka adresuar komisionit dhe që komisioni po ashtu i ka rekomanduar për procedim në seancë plenare.

Në mbledhjen e mbajtur më 28 maj të këtij viti, pas shqyrtimit të raportit të grupit punues, komisioni nxjerr këto:

#### Rekomandime

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të fillojë menjëherë me procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 5/L-090 për sponsorizimin në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-116 bazuar në të gjeturat e këtij raporti.

Ministria e Kulturës gjatë procesit të ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji duhet ta adresojë çështjen, si në vijim: eliminimin e diskriminimit të kulturës dhe rinisë në raport me sportin, pra 20% deri 30% të tatimit në fitim si shumë maksimale për sponsorizime me qëllim të krijimit të shanseve të barabarta për qasjen në sponsorizim.

Krijimi i bazës ligjore që edhe bizneset individuale dhe ortakëritë të kenë mundësinë e sponsorizimit,

Krijimin e bazës ligjore për mundësitë që artistët e pavarur të përfitojnë nga sponsorizimet nëpërmjet këtij ligji,

Adresimin e strukturës dhe organizimit të punës së komisionit për njohje të sponsorizimit me qëllim që lëndët të shqyrtohen pa vonesë dhe procesi të ketë integritet të lartë,

Eliminimin e kolizionit ligjor me Ligjin nr. 06/L-105 për tatimin e të ardhurave të korporatave, ashtu që ATK-së t'i lehtësohet puna kur kontrollohen bizneset dhe bizneseve t'u lehtësohet procedura e sponsorizimit.

Përfshirja e fushës së trashëgimisë kulturore si përfitues nga sponsorizimet.

Dhe, në fund, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Udhëzim Administrativ ta rregullojë çështjen e licencimit të klubeve dhe federatave, në mënyrë që klubet dhe federatat të krijojnë kapacitete për përfitim të sponsorizimeve.

Kjo me shumë domethënë me pak fjalë është paraqitja e këtij raporti dhe konsiderojmë që është një bazë e mirë dhe urojmë që një dokument i mirë të mund të shërbejë për amendamentimin në një të ardhme shumë të shpejtë të Ligjit për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Kështu që për këtë arsye i ftojme deputetët dhe i lusim ata që të miratojnë këtë raport. Faleminderit!

**KRYETARI:** E votojmë për këtë raport me rekomandime nga ana e komisionit. Mirlinda Tishukaj-Sadiku është paraqitur për diskutim.

**MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU:** Faleminderit kryetar për fjalën!

Përshëndetje për të gjithë,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Çështjen e Ligjit për sponsorizim në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit e kam ndjekur me vëmendje, po ashtu edhe në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike. Në fund të sesionit ka shkuar për trajtim dhe raporti i auditimit së performansës, i realizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ku në këtë raport ka të gjetura, të cilat janë trajtuar thelbësisht në problematikën e funksionimit të ligjit, problemet procedurale nga Ministria e Kulturës, ATK-ja dhe federatat, si dhe problemet dhe anomalitë e identifikuar nga bizneset dhe klubet përfituese.

Përfituesit e fondeve nga sponsorizimi nuk kanë objektiva të qarta për shpenzimin e fondeve, madje në raport thuhet se në shumë raste nuk janë paraqitur fare rezultatet e arritura gjatë shfrytëzimit. Po ashtu, ZKA-ja ka gjetur se në shumë raste fondet e sponsorizimit janë përdorur për aktivitete jospportive, siç janë: bileta udhëtimi, VIP-bileta, madje ka pasur edhe marrëveshje për emërimet në bordet drejtuese të klubeve sportive me kusht sponsorizimin, duke vënë në pah faktin se sponsorizuesit nuk e kanë pasur qëllim sponsorizimin, por vetëm përfitimin dhe kontrollin mbi klubet sportive.

Të nderuar kolegë deputetë,

I kam lexuar me vëmendje edhe rekomandimet e komisionit, edhe të grupit punues për t'u lehtësuar procedurat e këtij ligji, mirëpo te klubet sportive dhe federatat duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe të definohen edhe më qartë ndryshimet e reja. Pra, një gjë duhet ta kemi të qartë të gjithë, sponsorizuesit nuk po japin fondet e veta për sport, por po i japin fondet e shtetit për sport, prandaj çdo shpenzim i parasë publike duhet të meritohet, duhet të ndiqen procedurat për t'u përfituar dhe duhet të raportohet çdo shpenzim.

Unë si anëtare e Komisionit për Menaxhim të Financave Publike kam kërkuar nga Drejtoria për Hulumtim, Bibliotekë dhe Arkiv që të bëjë po ashtu një punim hulumtues, me ç'rast edhe i falënderoj për realizimin e këtij hulumtimi, i cili ka bërë një analizë të gjithmbarshme dhe përmbledhje të ligjeve se si janë të rregulluara në vendet e rajonit dhe të BE-së, e të cilat mendoj që kur të bëhet amendamenti e plotësim-ndryshimi i këtij ligji të merret parasysh ky hulumtim, i cili është shumë thelbësor. Faleminderit!

**KRYETARI:** E hedhim në votim këtë raport, përgatituni për votim. Votojmë tash për këtë raport.

Vetëm 57 deputetë votuan. Provojmë tash, më duket që tash të gjithë deputetët janë këtu. Votojmë raportin, votojmë tash!

62 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Konstatohet që u votua raporti i komisionit.

## **25. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Çështje të Sigurisë ia ka paraqitur për miratim këtë projekt-rezolutë Kuvendit, e cila ka të bëjë me vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë, Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij, ndërkaq Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave

Publike, pas shqyrtimit të raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Agjencisë, nuk ka propozuar ndonjë rekomandim.

Ia japim fjalën nënkryetarit të Komisionit për Çështje të Sigurisë, deputetit Enver Dugolli, e paraqet këtë projekt rezolutë.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Po, në emër të komisionit po e paraqes këtë raport. Pra, Komisioni Funkcional për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, në mbledhjen e mbajtur më 25. 6. 2024, e miratoi Projekt-rezolutën të cilën ia paraqet Kuvendit për miratim.

Në këtë draft-rezolutë janë vlerësimet për punën e kësaj agjencie, si dhe disa rekomandime. Prandaj, ju ftoj që ta votoni këtë projekt-rezolutë.

KRYETARI: Atëherë një sqarim shtesë për ju, sipas nenit 43, paragrafi 9 i Ligjit për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura pas prezantimit në seancën plenare raporti i vlerësimit i performancës dhe projekt-rezoluta e hartuar nga komisioni përgjegjës votohet. Kështu që përgatituni për votim. Votojmë tash!

Vetëm 60. Edhe një herë votojmë tash. 60 vota të gjitha për. Asnjë kundër, dy abstenime ishin, kjo i bën 62 vota. Kështu që konstatoj që Kuvendi e miratoi Rezolutën për vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022.

## **26. Shqyrtimi i Raportit të performansës të ndërmarrjeve publike për vitin 2022**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin e performansës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2022, Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Nga ana e Qeverisë, ministren e kemi këtu për ta prezantuar punën dhe performansën e ndërmarrjeve publike qendrore, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Pra, sot para jush po paraqesim raportin e performansës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2022, duke u mbështetur në raportimin e tyre të rregullt dhe në të dhënat e Ministrisë së Ekonomisë.

Ju përkujtoj që Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron të drejtat e aksionarit në 17 ndërmarrje, të cilat janë në pronësi të Republikës së Kosovës dhe ky raport u referohet vetëm këtyre ndërmarrjeve publike.

Ndërmarrjet qendrore publike gjatë vitit 2022 kanë angazhuar 10 401 punëtorë gjatë këtij viti, që i bie 691 më pak se sa në vitin paraprak, ndërsa kanë përmbyllur vitin 2022 me fitim financiar prej gjithsej 101,5 milionë euro, që është rreth 80 milionë euro më shumë se në vitin 2021. Gjithsej 9 ndërmarrje e kanë mbyllur vitin 2022 me fitim financiar, ndërsa shumica dërmuese kanë afaruar me fitim operativ, duke zvogëluar humbjet në krahasim me vitet paraprake.

Gjatë vitit raportues, Qeveria u ka ndarë ndërmarrjeve publike qendrore 12 milionë euro subvencione dhe transfere për mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale. Subvencionet për shpenzime operative janë zvogëluar mbi 10 milionë euro në krahasim me vitin 2021, që do të thotë se ndërmarrjet kanë afaruar më mirë dhe janë mbajtur kryesisht me mjete vetjake.

KEK-u dhe “Ibër Lepenci” kanë qenë ndër ndërmarrjet më të suksesshme. KEK-u ka dalë ndërmarrja më me fitim falë prodhimit rekord të energjisë, mirëpo në anën tjetër edhe uljes së shpenzimeve operative dhe rritjes së çmimeve të tregut. Gjithashtu, prodhimi i energjisë ka qenë i kënaqshëm edhe në ndërmarrjen hidro-ekonomike “Ibër Lepenc”, e cila ka shënuar rritje të dukshme të performansës, ndërsa kompanitë e ujësjellësit kanë afaruar me sukses, duke kryer investime kapitale, duke zgjeruar operimet e rrjetit në shërbim të qytetarëve dhe gjashtë nga shtatë e kanë mbyllur vitin me fitim financiar, ndërsa KRU “Gjakova” ka dalë me fitim operativ.

Spektori i Postës dhe Telekomit gjithashtu ka pasur përmirësim të dukshëm, përdërisa Posta e ka përmirësuar bilancin për gjysmë milionë euro në vitin 2022, duke e rritur kontrollin e brendshëm, duke nisur ristrukturimin dhe duke përmirësuar në përgjithësi llogaridhënien. Tek Telekomit i Kosovës humbja në këtë vit është tkurrur në 3,7 milionë euro nga 16 e 10, e madje deri në 40 milionë euro në vitet paraprake dhe ky ka qenë viti i fundit që Telekomit e ka kaluar me humbje.

Ju faleminderit për vëmendje!

**KRYETARI:** Mirë, kjo ishte sa i përket paraqitjes së raportit nga Qeveria lidhur me performansën e ndërmarrjeve publike qendrore. Nëse jeni të gatshëm, e hedhim këtë raport në votim, apo? Kryetarja fillimisht, a e keni fjalën në emër të komisionit, apo në emër të grupit parlamentar, zonja Bajrami? Në emër të grupit, mirë. Në emër të komisionit, nënkryetarja Jeta Stavocci, pastaj ua jap radhën grupeve parlamentare.

**JETA STATOVCI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Atëherë në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike, Qeveria ia dorëzon Kuvendit të Kosovës një raport vjetor të performansës së ndërmarrjeve publike qendrore.



Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, në bazë të nenit 29 dhe 30 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 2. 7. 2024, e shqyrtoi raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022, të cilin e paraqiti ministrja e Ekonomisë dhe vendosi që t'ia paraqesë Kuvendit këtë:

### Rekomandim

Rekomandimi i komisionit në fjalë është që të miratohet raporti i performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022. Faleminderit!

Kryetar, nëse mund të vazhdoj edhe në emër të grupit?

KRYETARI: Po, grupet parlamentare, Vetëvendosja urdhëro!

JETA STATOVCI: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Pa dyshim që një nga aspektet më të rëndësishme të ekonomisë dhe një nga sektorët më crucial në raport me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në vend kanë të bëjë me ndërmarrjet publike dhe në kuadër të raportit, të cilin e kemi pranuar për vitin 2022 nga tërësisht 17 ndërmarrje publike qendrore rezultojnë që nga 9 prej tyre faktikisht të dalin në tërësi me fitim, ta kenë përmbyllur vitin, të cilin në qoftë se e shikojmë në retrospektivë ose krahasuar me vitet përpara ishin parimisht dy apo tri ndërmarrje në tërësi.

Është punuar në vazhdimësi që të përmirësohet gjendja brenda këtyre ndërmarrjeve për t'i siguruar planet e qarta të biznesit, për ta ristrukturuar shumicën nga këto ndërmarrje, të cilat operonin jo domosdoshmërisht në gjendje stabile financiare, për ta ndihmuar afarizmin e tyre, për të siguruar menaxhim të duhur të burimeve njerëzore, si dhe për t'i zvogëluar shpenzimet dhe për t'i rritur të hyrat. Ndërmarrjet publike vitin 2022 e kanë përmbyllur me një fitim të jashtëzakonshëm, pra prej 101,41 milionë euro me një trend pozitiv, i cili ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2023 dhe tutje.

Pra, për ilustrim, në periudhën 2015-2017, humbjet e ndërmarrjeve publike ishin 55,6 milionë. Në periudhën 2018-2020, humbjet e ndërmarrjeve publike ishin 26 milionë. Në periudhën 2021-2023, fitimet e ndërmarrjeve publike ishin 123 milionë.

Kjo tregon për një ndryshim rrënjësor të performansës së këtyre ndërmarrjeve publike. Në qoftë se i shikojmë në aspektet individuale të profilit të secilës prej tyre, në qoftë se e shikojmë Telekomin, Telekomu u gjet diku me shtatëmbëdhjetë milionë euro humbje dhe me një varg problemesh, të cilat ishin bartur vit pas viti.

Problemet ishin gjithashtu edhe në raport me burimet njerëzore. Në kuadër të Raportit të Auditorit, kishte diku rreth 323 pozita të cilat ishin avancuar pa u përcjellë me bazën e nevojshme ligjore. Kjo përbënte një kosto dhe një barrë të madhe të shpenzimeve, të cilat pasi u rishikuan, doli që diku rreth treqind mijë euro kursehen për Telekomën në muaj.

E njëjtë ishte situata edhe me qiratë e shumta dhe me shuma marramendëse, të cilat u përmirësuan përgjatë vitit 2023, duke kaluar edhe në profit brenda vitit 2023 e tutje.

Në sektorin e ujërave, KRU Prishtina shënoi inkasim rekord, jo vetëm në faturim, mirëpo gjithashtu edhe në mbledhje të borxheve paraprake.

“Ibër-Lepenci” gjithashtu, i cili ishte i famshëm për kontratat e famshme në raport me energjinë elektrike, rezultoi që të jetë ndërmarrje profitabile, me një rimëkëmbje e sipër në kuadër të kapaciteteve të saj.

Gjithashtu, edhe KEK-u, i cili përveçse përmirësoi gjendjen e vet financiare, rezultoi edhe me projekte të reja, të cilat kishin të bënin me parkun diellor me kapacitet 100 MW, që paraqet projektin e parë në diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë.

Vlen të ceket që shumica e këtyre ndërmarrjeve për vite me radhë nuk ishin audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, duke u bërë kryesisht nga auditorë të kompanive private. Më shumë se pesë vite, KEK-u nuk ishte i audituar nga ZKA-ja, Trepça nuk ishte audituar e as “Ibër-Lepenci” nuk ishte audituar në më shumë se gjashtë vite nga Zyra Kombëtare e Auditimit, e të cilat në vitin 2022 e tutje bëhen pikërisht nga ky institucion.

Pikërisht këto janë rezultate të cilat e paraqesin përkushtimin e bordeve të këtyre ndërmarrjeve dhe qasjes së Qeverisë në përmirësimin e aspektit profitabil të tyre, aspektit operativ të tyre dhe në sistemimin dhe strukturimin e kapaciteteve njerëzore, në mënyrë që të ketë gjendje më të mirë ekonomike në përgjithësi. Ju faleminderit!

**KRYETARI: Tash Lidhja Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami!**

**HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit Kryetar për fjalën!**

Sa i përket performansës së ndërmarrjeve publike, po mendoj që është analoge edhe me performansën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sot jemi më 30 tetor 2024, derisa po e shqyrtojmë një raport të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022.

Ministre,

Deputetë nga Grupi Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, respektivisht deputeti Hoti, ju ka bërë disa herë pyetje lidhur me shpalosjen e subvencioneve për entitetet publike. Ju sapo e

thatë që gjatë vitit 2022 janë dhënë subvencione ndërmarrjeve publike dikur rreth dymbëdhjetë milionë. Ndërkohë, unë kam këtu para vetes raportin financiar për vitin 2023 dhe te fq. 28 e raportit, te shpalosja e shënimit nr. 30, në raport i cili është hartuar nga Ministria e Financave dhe është aprovuar në Qeveri, thuhet se subvencionet për entitetet publike në vitin 2022 kanë qenë 233 109 000 euro. Ju lutem shumë, a keni mundësi ta deshifroni këtë?

Po e them, po e përsëris edhe një herë, disa herë keni marrë pyetje nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës se ku kanë shkuar këto 233 000 109 euro? Janë mjete subvencione për entitete publike në vitin 2022. Ndërkohë që në vitin 2021 kanë qenë 101 milionë dhe në vitin 2023 i keni 185 milionë.

Unë ju përkujtoj që në vitin 2019, që ishte ky një vit normal para pandemisë, subvencionet për entitete publike kanë qenë rreth 60 milionë euro. Andaj, na intereson besoj të gjithëve se cilët janë ato entitete publike të cilat ju i keni shpenzuar 233 milionë euro?

**KRYETARI:** Pyetja ishte e drejtpërdrejtë nga ana e deputetes. E kemi ministren e Ekonomisë e cila përgjigjet. Urdhëro, ministre Rizvanolli.

Regjia, në foltore!

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Faleminderit për pyetjen!

E nderuar deputete Bajrami,

Sa i përket vitit raportues 2022, kanë qenë dymbëdhjetë milionë euro subvencione dhe transfere për shpenzime operative dhe investime kapitale të ndërmarrjeve publike për operim dhe investime sikur në kohë të rregullt. Ndërsa, gjatë vitit 2021 dhe 2022, duke qenë se kanë qenë vite të krizës energjetike globale, Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të furnizimit sa më stabil me energji elektrike për qytetarët dhe tejkalim të krizës energjetike, ka subvencionuar qytetarët përmes ndërmarrjes publike KEK për subvencionim të mbulimit të shpenzimeve të importit të energjisë elektrike në vlerën prej njëzet milionë euro në vitin 2021, dhe tridhjetë milionë euro në vitin 2022.

Sa i përket raporteve të tjera dhe ndërmarrjeve të tjera, unë nuk i kam shifrat momentalisht, sepse raporti të cilin po e diskutojmë, është raport i mbikëqyrjes së performancës së ndërmarrjeve publike qendrore, shtatëmbëdhjetë ndërmarrjeve publike qendrore te të cilat të drejtat e aksionarit i ushtron Qeveria e Republikës së Kosovës.

**KRYETARI:** Kjo ishte sa i përket Raportit, të cilin mund ta votojmë tash, nëse deputetët janë të pranishëm, ose këtu afër diku, sepse mesa po e shoh as gjysma e sallës nuk është.

E qesim në votim Raportin lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2022.

Votojmë tash!

61 vota, 59 për, asnjë kundër, 2 abstenime.

Kuvendi e miraton raportin e komisionit përkatës.

## **27. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe reflektimin e agjendës transformuese të Kosovës në buxhet dhe në politikat qeveritare**

Të nderuar deputetë,

Deputetja Fatmire Kollçaku, në cilësinë e kryetares së Këshillit për Zhvillim të qëndrueshëm ka kërkuar nga Qeveria që të raportojë në Kuvend. Pra, ia japim fjalën asaj që të na e shpjegojë se si qëndron puna lidhur me këtë temë.

Urdhëroni, znj. Kollçaku!

FATMIRE KOLLÇAKU: I nderuar kryetar,

Fillimisht ju falënderoj për fjalën,

Kërkesa kur është paraqitur para Kryesisë së Kuvendit për futjen në rend të ditës të kësaj pike, ka qenë që të raportojë Kryeministri.

Desha vetëm të pyesim, meqenëse kemi nderin që është prezenca e zv.kryeministrit, a është deleguar nga kryeministri te zv.kryeministri apo ta shtyjmë edhe për një seancë të radhës? Vetëm ta sqarojmë dhe mund të procedojmë në rast nevoje.

KRYETARI: Ideja e Qeverisë është që mund të procedojmë edhe sot.

Po, znj. Kollçaku e ka fjalën fillimisht në emër të Këshillit për Zhvillim të qëndrueshëm, pastaj ia japim fjalën Qeverisë.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj kryetar!

Po ashtu edhe zv.kryeministrin,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është një kënaqësi e jashtëzakonshme që të prezantoj sot në emër të Këshillit për Zhvillim të qëndrueshëm, të themeluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në vitin 2018, më 25 janar, ku ky Kuvend është zotuar, përkundër faktit që ende nuk jemi pjesë e Kombeve të Bashkuara, që t'i

bashkëngjitet botës demokratike, e cila tashmë është zotuar për zbatimin e agjendës 2030, përkatësisht zbatimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm.

Përkundër faktit që nga themelimi i Këshillit kanë qenë disa legjislatura dhe koha kur jemi ballafaquar edhe me pandeminë, mund të them që në këtë legjislaturë Këshilli është konsoliduar më mirë dhe ka filluar realisht me zbatimin e agjendës 2030 dhe në bashkëpunim edhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës, fillimisht ne kemi kërkuar të fillojë rekomandimi në Kuvend dhe tani sot do të ndodhë për herë të dytë raportimi i Qeverisë, sepse herën e parë para deputetëve ka raportuar ish-ministri i Financave, Hekuran Murati.

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm janë një zotim fisnik dhe moral për të gjithë. Për këtë arsye, të gjitha shtetet pa dallim i kanë bërë këto objektiva pjesë të politikave të tyre publike. Të gjitha parlamentet demokratike i kanë përfshirë në punën e tyre të përditshme.

Këshilli për Zhvillim të qëndrueshëm që unë e kryesoj, tani në vitin e katërt ka punuar me një seriozitet të madh, së bashku me komisionet parlamentare, fillimisht në futjen në agjendë të objektivave që bien në fushëveprimin e këtyre komisioneve. Ne kemi identifikuar komisionet kryesore që kanë deri në shtatë objektiva që bien në fushëveprimin e tyre dhe kryetarët e atyre komisioneve janë anëtarë të Këshillit.

Dua të theksoj se Këshilli nacional për Zhvillim të qëndrueshëm është një trupë koordinuese ndërinstytucional, ku përfaqësohet me përfaqësuesin e Presidencës, Zyrës së Kryeministrit, ministrive, OJQ-ve, shoqërisë civile dhe agjencive të UN K-team. Me këtë rast, dua të falënderoj Zyrën e UN K team. Fillimisht me znj. Ulrika Richardson dhe tani me znj. Arnhild që i kanë dhënë mbështetje të madhe Këshillit për Zhvillim të qëndrueshëm në Kuvend, edhe me mbështetje me një ekspert të angazhuar.

Po ashtu, stafin e Kuvendit të Kosovës të Republikës së Kosovës, dua të falënderoj edhe Kryetarin e Kuvendit, i cili ka dhënë mbështetje të madhe punës së Këshillit për Zhvillim të qëndrueshëm, sidomos në organizimin e disa konferencave të rëndësishme, prej të cilave njëra ka qenë edhe regjionale, ku është diskutuar për tema të rëndësishme. Njëra prej tyre ka qenë edhe tema për balancës mes punës e jetës. Ky është një qëllim i yni që kjo direktivë të futet në Ligjin e ardhshëm të punës. Ka qenë konferenca e organizuar për planifikimin e futjes së vaksinës SPV, që së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe falë punës së Këshillit, tash është diçka që po ndodh dhe fatmirësisht kemi një numër të madh të vajzave të vaksinuara në Republikën e Kosovës janë organizuar konferenca kur e kemi shënuar edhe lindjen e qytetarit të tetë miliardët, së bashku me UNFPA në Kosovë.

Ajo që është më e rëndësishme, dua të theksoj zotimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kur Kryeministri i Republikës së Kosovës është zotuar për katër objektivat kryesore në agjendën

transformuese. Dua të theksoj që kjo agjendë transformuese, që është transformimi i arsimit në Kosovë, përshpejtimi i tranzicionit të energjisë ripërtëritëse, transformimi digjital, si dhe ajo që është kryesorja, askush të mos lihet prapa. Kjo është pjesë e agjendës transformuese, që kemi pasur zotim nga kryeministri i Republikës së Kosovës.

Prandaj, ky është rasti, pse ne kemi ftuar Kryeministrin e Republikës së Kosovës. në këtë rast, falënderoj zv.kryeministrin prezent, i cili në emër të Kryeministrit sot do të raportojë lidhur me agjendën transformuese. Ajo çfarë dua të theksoj nga ana e Kuvendit, ne jemi zotuar që fillimisht përmes komisioneve dhe në komunikim direkt me ministrinë, do të mbikëqyrim të gjitha ligjet që pritet të jenë konform jo vetëm agjendës evropiane, por edhe agjendës 2030, sepse ka shumë suksese që ne presim të realizuara nga ministrinë, fillimisht të evidentohen.

Pra, sepse, përveç që kemi shtatëmbëdhjetë objektiva, kemi mbi 160 targete, të cilat duhet të evidentohen si progres, sepse ka shumë progres, po ne presim që nga mbikëqyrja e komisioneve, ajo të evidentohet dhe eventualisht ngecje nëse kemi si të tilla.

Deri tani janë përzgjedhur dy komisione: Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Komisioni për Bujqësi, tani për Ekologji, është një emërtim i gjatë. I kemi përzgjedhur dy ligje që direkt do t'i monitorojmë nën ombrellën e agjendës 2030 dhe do të pasojë me komisione të tjera.

Prandaj, besoj që legjislatura e ardhshme do të jemi shumë më të gatshëm që ne si Kuvend ta forcojmë mekanizmin mbikëqyrës në raport me ministrinë përkatëse.

Prandaj,

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Fillimisht ju falënderoj për mundësinë që të paraqesim disa arritje të Këshillit. Por, unë mendoj që ky koordinim ndërinstucional duhet të fuqizohet. Besoj që në legjislaturën e ardhshme, çdo ligj i cili përcillet nga Qeveria, përveç që do të harmonizohet me agjendën evropiane, pra me legjislacionin e BE-së, do të jetë shumë me kujdes i vështuar edhe në aspektin e përmbushjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Unë ju falënderoj për mundësinë. Tani besoj që do të dëgjojmë nga Qeveria.

**KRYETARI:** Kjo ishte sa i përket prezantimit të punës nga ana e kryetares së Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm që e kemi këtu në Kuvend.

Tash fjalën po ia jep zv.kryeministrit Bislimi për të na shpjeguar se si i qaset Qeveria agjendës transformuese të Kosovës.

ZV.KRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar anëtarë apo deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në vitin 2018, Kosova vullnetarisht iu bashkua përpjekjeve globale drejt arritjes së objektivave për zhvillim të qëndrueshëm 2030.

Duke iu përgjigjur thirrjes për veprim të ripërtërirë global, Qeveria e Republikës së Kosovës rikonfirmoi përkushtimin e palëkundur për veprim të përshpejtuar dhe transformues për të përmbushur premtimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Zotimet janë në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit 2030 dhe Planin kombëtar të zhvillimit, të miratuar në mars të vitit 2023, që përshkruan vizionin e Qeverisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe realizim të agjendës 2030.

Me këtë qëllim, Qeveria është e përkushtuar të ndërmarrë veprime të fuqishme dhe transformuese në kuadër të katër fushave kryesore të politikave. Fusha e parë - ulja e varfërisë, e dyta - energjia e ripërtitshme, e treta - transformimi digjital dhe e katërta - transformimi i sistemit të arsimit.

Te ulja e varfërisë, Kosova zotohet për zvogëlimin e shkallës së varfërisë për gjashtë për qind deri në vitin 2027, duke përmirësuar shërbimet shëndetësore si në kohë ashtu edhe në cilësi, duke reformuar skemën e ndihmës sociale dhe duke siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe mundësi, veçanërisht për grupet e lëndueshme të shoqërisë. Në grupin e dytë apo përshpejtimi i tranzicionit drejt energjisë së ripërtitshme, Kosova angazhohet për të përmirësuar qëndrueshmërinë e sistemit të energjisë, të rritë pjesëmarrjen e burimeve të ripërtitshme, të mbrojë grupet e lëndueshme dhe të integrohet në tregjet rajonale dhe pan-evropiane.

Te transformimi digjital, Kosova zotohet për përshpejtimin e transformimit digjital të ekonomisë dhe shoqërisë dhe ndikimi i teknologjive inovative dhe tendencave digjitale globale.

Te transformimi i arsimit, ne zotohemi për të vendosur të harmonizojmë sistemit e arsimit me agjendën e transformimit të arsimit.

Tani më lejoni që për secilën nga këto fusha të tregoj se cilat suksese janë arritur deri më tani nga Qeveria.

Te qëllimi i parë apo ulja e varfërisë kemi siguruar pakon më të madhe si përqindje të bruto-produktit vendor në gjithë Ballkanin Perëndimor, si pako përballë sfidave të inflacionit dhe të krizës energjetike të vitit 2022.

Kemi masa të ndryshme për punësim që kanë çuar në dyfishimin e numrit të të rinjve të punësuar dhe kemi mbështetje direkte në punësimin e mbi 12 mijë grave. Të gjitha këto masa bashkë me formalizimin e tregut të punës kanë çuar numrin e vendeve të punës në mbi 420 mijë sosh. Kjo përbën një rritje prej 20% krahasuar me vitin 2021.

Kemi aprovuar shtesa për mbi 55 mijë nëna lehona dhe për mbi 400 mijë fëmijë nën moshën 16-vjeçare. Kemi ofrimin e shtesave të njehershme për pensionistë, studentë, punonjës të sektorit publik, si dhe kemi subvencionuar rritjen e pagave për punonjësit në sektorin privat. Kemi subvencionuar faturat e energjisë për mbi 208 mijë amvisëri, të cilat gjatë sezonit të dimri 2022-2023 kishin arritur të kursejnë energjinë elektrike.

Kemi dyfishuar asistencën sociale për familjet përfituese për muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2021. Për muajin prill dhe shtator 2022, si dhe kemi ofruar ndihmë për blerjen e lëndëve djegëse për ngrohje në muajin dhjetor të vitit 2023.

Kemi nënshkruar në kredi ndërkombëtare me Bankën Botërore në vlerë 247 milionë eurove për reformën e skemave sociale dhe atyre pensionale. Kemi lansuar programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike në Kosovë, nga i cili deri më tani janë kualifikuar mbi 62 familje, të cilave do t'u subvencionet fatura e energjisë elektrike.

Kosova në këtë grup apo në këtë fushë, po ashtu është angazhuar për të përmirësuar shërbimet shëndetësore kohë pas kohe, dhe për të përmirësuar cilësinë e tyre. Në këtë drejtim kemi alokuar 100 milionë euro shtesë në shëndetësi. Kemi 63 milionë euro për listën e re të barnave esenciale dhe 6.5 milionë euro më shumë për barna për sëmundje të rralla.

Kemi 3 rezonanca të reja magnetike për Spitalin e Pejës, Klinikën e Pediatriisë dhe Spitalin e Prizrenit, ku deri më tani kanë qenë vetëm dy. Kemi trefishim të kapaciteteve inspektuese. Kemi transformuar dhe rinovuar Klinikën e Onkologjisë, Gjinekologjisë, Urologjisë, Kardiokirurgjisë, Oftalmologjisë, atë Emergjente, Bllokun Operativ në Neurokirurgji, Kirurgji Vaskulare, Bllokun Operativ në Kirurgjinë Torakale dhe Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adolleshentëve.

Kemi përfunduar Klinikën e re të Ortopedisë, e cila ka kushtet më moderne dhe ka katër salla operative. Kemi përfunduar riparimin e objektit të Pediatriisë në Mitrovicë dhe dy reparte në Institutin Special në Shtime, si dhe kemi rinovuar në përgjithësi objektin ekzistues të Transfuzionit të Gjakut, njësinë regjionale në Gjilan.

Po ashtu kemi investuar në Spitalin e Pejës dhe në qendrën rajonale të shëndeti publik në Prizren.



Me Ligjin e ri për paga specialistët në shëndetësi kanë pagat më larta në rajon. Kemi miratuar Ligjin për çmimin e produkteve medicinale që ulë shpenzimet e qytetareve dhe institucioneve në blerjen e barnave.

Te qëllimi i dytë apo përshpejtimi i tranzicionit drejt energjisë së ripërtëritshme kemi pakon e investimeve për burime të ripërtëritshme të energjisë në total prej 950 mgw apo në vlerë monetare prej 1,2 miliard eurove.

Kemi marrëveshje 56,2 milionë euro mes KEK-ut dhe kompanisë amerikane General Electrics për modernizimin e teknologjisë së Termocentralit Kosova B, me çka rrisim kapacitetet dhe për 30 mgw shtesë.

Kemi marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar me vlerë prej 160 milionë euro për investime në kapacitete të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme. Kemi përfunduar me sukses procesin e ofertimit për ankandin e parë solar me kapacitet 100 mgw.

Kemi përgatitur ankandin e parë për prodhimin e energjisë elektrike nga era me kapacitet prej 150 mgw. Kemi filluar punimet në centralin solar me kapacitet 150 mgw në Gjakovë.

Kemi marrëveshjen 236,7 milionë dollarë me MCC-në për bateritë. Kemi funksionalizimin e tregut të përbashkët energjetik me Shqipërinë apo bursën ALPEX.

Kemi subvencionuar mbi 30 familje e biznese për blerjen e pajisjeve efikente energjetike. Kemi përkrahur mbi 3 mijë familje në izolimin e shtëpive dhe kemi investime në efikasitet energjetike në mbi 125 ndërtesa publike me 60 mijë përfitues deri më tani.

Te grupi i tretë apo transformimi digjital kemi lansuar 195 shërbime elektronike në platformën e-Kosova. Kemi lansuar edhe platformën e-Komuna. Shërbimet elektronike që janë me pagesë mund t'i paguajnë drejtpërdrejt në e-Kosova, duke e reduktuar koston e transaksionit.

Kemi miratuar Strategjinë për e-qeverisje me investim 5-vjeçar prej 48 milionë euro, si nga Qeveria ashtu edhe donatorët. Kemi miratuar Strategjinë e sigurisë kibernetike me investim 3-vjeçar prej 9.8 milionë euro nga Qeveria dhe partnerët tanë.

Kemi avancuar në indeksin GTMI të Bankës Botërore nga grup c në grupin b të vendeve që kanë fokus të konsiderueshëm në qeverisje digjitale. Kemi miratuar Ligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike.

Kemi miratuar Ligjin për sigurinë kibernetike. Kemi përfshirë krimet kibernetike në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Kemi zhvilluar dhe funksionalizuar sistemin elektronik për

hartimin e legjislacionit. Kemi shtrirë në rrjete të Telekomit në katër komunat në veri të Kosovës.

Kemi mbulueshmëri 100% me internet të shpejtë të zonave të banuara. Kemi përrurimin e Parkut Teknologjik Digjital TEK PARK në Prishtinë, e shumë të arritura të tjera.

Te fusha e katërt apo transformimi i arsimit kemi mundësuar arsimin e lartë publik falas. Kemi ndarë mbi 10 mijë e 200 bursa për studentë. Kemi mundësuar arsimin dual me 12 profile, 23 shkolla profesionale në 14 komuna të vendit me gjithsej 1588 nxënës.

Kemi mbi 4 880 bursa për studentë në fushat STEM, shumica dërmuese prej tyre janë vajza të reja. Kemi 339 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, ndërkaq buxhetin e kemi ndarë për gjithsej 500 asistentë të tillë. Dhe, për herë të parë ka filluar ishikimi i teksteve mësimore të klasës 1-9 për lëndët e Gjuhës dhe të Matematikës.

Po ashtu kemi rikthimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim si anëtare e asociuar. Kemi rifunksionalizuar pas një dekade Këshillin Kombëtar për Shkencë. Kemi anëtarësuar Kosovën në Programin Horizon Europe. Kemi filluar procesin e verifikimit të diplomave të Universitetit të Mitrovicës së Veriut. Kemi finalizuar katër projektligje të rëndësishme; Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Akreditim, Projektligjin për fëmijërinë e hershme, Projektligjin për arsimin e lartë dhe Projektligjin për tekstet shkollore.

Në përmbyllje dua të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë një progres të konsiderueshëm në të gjitha këto katër fusha për të përmbushur synimet dhe objektivat e përbashkëta.

Është e vërtetë që kemi arritur shumë në këtë drejtim drejt sigurimit të një jete më të mirë për qytetarët, duke përparuar në uljen e varfërisë, rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme, transformimin digjital dhe përmirësimin e arsimit.

Megjithatë, është me rëndësi të pranojmë se ende ka shumë punë për të bërë, në mënyrë që këto qëllime përfundimtare t'i arrijmë bashkërisht. Ne si Qeveri jemi të vendosur që të vazhdojmë të punojmë edhe me më shumë përkushtim, e edhe me më shumë energji që t'i përmbushim zotimet tona dhe të sigurojmë një të ardhme më prosperuese për secilin qytetar të Republikë së Kosovës. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Kjo ishte paraqitja nga e Qeverisë e punëve sa i përket agjendës transformuese. Tash i ftojme të gjithë deputetët që të kthehen që ta votojmë këtë raport. Ky ishte vetëm raport. Të tjerë nuk janë paraqitur, kështu që po kalojmë te pika tjetër:

**28. Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb**

Por, nuk i kemi grupet parlamentare këtu. E kemi vetëm Vetëvendosjen. A po doni t'i jepni emrat? Mirë. Atëherë, i marrim emrat nga Vetëvendosja dhe nga Grupi Multietnik.

Sa i përket Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, ju e keni zëvendëskryetarin e parë dhe 4 anëtarë në këtë komision. Na i thoni emrat, zonja Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, si nënkryetar i parë ose nënkryetare e parë e këtij komisioni është deputetja Adelina Grainca. Pastaj anëtarë të komisionit janë deputetët: Valon Ramadani, Besim Muzaqi, Nijazi Isaku dhe Fitim Haziri.

KRYETARI: Grupi Multietnik e ka zëvendëskryetarin e dytë. Kush e paraqet këtë? Kryetari i grupit, Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar! Deputetja Fidan Jilta.

KRYETARI: Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë. Grupet parlamentare i presim kut t'i vije radha një seance tjetër, sepse duhet t'i kemi të gjithë, e pastaj votojmë.

Kurdi që kemi kohë i trajtojmë këto pika të cilat mbeten pa u votuar në këtë seancë. E organizojmë një tjetër kur të kemi mundësi t'i vazhdojmë këto. Mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*